

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

UBT News

Media & Events

4-4-2015

UBT News - Mars 2015

University for Business and Technology

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/newspaper>

Recommended Citation

University for Business and Technology, "UBT News - Mars 2015" (2015). *UBT News*. 6.
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/newspaper/6>

This Book is brought to you for free and open access by the Media & Events at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in UBT News by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



**EDMOND HAJRIZI:
UBT LA PRAPA NJË
VIT SHUMË TË MIRË,
PO HYN NË VITIN E
PROJEKTEVE TË MËDHA**



Faqe 3

**ARDIAN EMINI: UBT
E VË STUDENTIN NË
PLAN TË PARË**



Faqe 4



**U PUBLIKUA HULUMTIMI
"PAVARËSIA DHE
BESUESHMËRIA E
MEDIAVE NË KOSOVË"**

Faqe 7

**NË UBT U PROMOVUAN
LIBRI "SHKRIMI DHE
KOMUNIKIMI" DHE
REVISTA "POLITIKOLOGU"**

Faqe 12

**"A ËNDËRROJNË
ANDROIDËT PËR
DELE ELEKTRIKE?"**

Faqe 21

STUDENTËT E UBT-së ME IDE GJENIALE PËR BIZNESETË TË REJA



KUNDËR IKJES, ME PROJEKTE PËR ZHVILLIMIN E VENDIT

Florian Piraj, Perparim Salihu, Mimoza Braha, Njazi Shehu, Uran Çabra, Pajtim Shala, Shpend Zhuja, Leutrim Sopjani, Daut Ibrahim, Faton Latifi, Teuta Dervishi, Armira Fetoshi, Palush Doda, Kaltrina Mehmeti, Erza Mehmeti, Marigona Xhemajli, Dina Demiri, Fatbardha Pacolli, Donika Ismaili, Anesa Hoxha. Këta emra, nga mbi 200 studentë sa morën pjesë në hartimin e biznes-planeve në garën e UBT-së, JANË SHPRESA. Janë 200 emra, dhjetëra ide dhe plane për biznese të reja. Për një jetë më të mirë për të gjithë.

Faqe 8-11

Editorial



Edmond Hajrizi
President i UBT-së

VEPRO! E ARDHMJA NUK PRET

Në vitin që kaluam patëm një sukses të madh. Pas vlerësimit që na u bë nga tre ekspertë të njohur ndërkombëtarë për një javë rresht, u konfirmua se UBT ka arritur nivelin e zhvillimit në shkallë të ekselencës. Me këtë ne tani jemi dëshmuar se jemi ekselencë. Kemi hyrë në grupin e organizatave evropiane dhe botërore më të zhvilluara, ku ekselencia është e akceptuar si kriteri kryesor i vlerës.

Natyrisht, vlerësimi i UBT-së për ekselencë na jep një respekt në nivelin vendor e ndërkombëtar. Por, jo vetëm neve - edhe Kosovës. Sepse, deri tani, sipas EFQM (organizata që bën vlerësimin në Evropë për Ekselencë. Është certifikimi i parë dhe i vetmi në tërë Ballkanin.

Kjo jep një konkluzion të rëndësishëm, duke e mbështetur hipotezën se është mundur dizajnimi dhe menaxhimi i sistemeve moderne në vendet në tranzicion, duke i respektuar të gjitha standardet dhe praktikën më të mira për cilësi, teknologji menaxhim dhe lidhshmëri.

U plotësua një pjesë e Vizionit dhe Misionit që kisha nisur në vitin 2001. Një ëndërr për një Universitet modern në vendin tim. Atëherë isha vetëm në këtë rrugëtim, me pak përkrahje, por tani kemi rreth 400 personel të angazhuar, vendorë e ndërkombëtarë, mbi 100 universitete partnere, me më shumë programe dhe natyrisht me më shumë infrastrukturë.

Për këtë dëshiroj t'i falënderoj të gjithë për përkrahjen dhe angazhimin për të mbërritur deri këtu.

Megjithatë, më e rëndësishmja është që edhe në të ardhmen ekselencia në UBT të mirëmbahet dhe të rritet, që UBT ta ruajë dhe ta rrisë këtë dinamizëm, lidhshmëri dhe inovacion që e ka që nga fillimi.

Lidhshmëria i UBT-së po punon çdo ditë e më shumë në aspektin dhe aktivitetet që tregojnë çdo ditë më shumë lidhshmëri, cilësi dhe inovacion: kënaqësi më të madhe tek studentët, rezultate më të mira në provime, programe të reja, procese më efikase dhe eficientë, më shumë qendra profesionale, resurse dhe infrastrukturë më moderne, laboratorë, literaturë, metoda të reja të menaxhimit dhe të inovacionit, staf më shumë dhe më të kualifikuar, strategji afatgjatë dhe shumëdimensionale, më shumë punë shkencore, publikime, më shumë ndërkombëtarizim, partneritete, më shumë mobilitet dhe internship, etj.

Këto ditë pritet të hapet edhe objekti tjetër i ri në kampusin inovativ. Kjo po mundëson që studentët tanë të kenë qasje edhe më të mëdha në laboratorë, në hapësira për punë kreative, modelim, projekte, si dhe për inkubimin e ideve të tyre drejt zhvillimit të produkteve dhe bizneseve të reja, të cilat natyrisht gjenerojnë më shumë inovacion, më shumë punësim dhe zhvillim ekonomik.

Parku tani më është i njohur ndërkombëtarisht për aktivitetin dhe rezultatet e tij. Si i tillë është parku i parë shkencor dhe inovativ i njohur në Kosovë dhe në Shqipëri.

Ne edhe më tutje do të investojmë në këtë drejtim. Së bashku me partnerët ndërkombëtarë dhe në përkrahje edhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe të Bashkimit Evropian, kemi arritur të zhvillojmë programe dhe institucione moderne, për çka UBT ka një falënderim të veçantë.

Përkrahja e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara ka bërë të mundur që ne në mars të kemi gati Inkubatorin e parë Virtual në Kosovë, Zhurnalin e parë të ndërmarrësisë, këndin e librave për ndërmarrësi, si dhe Forumin e Kosovës për ndërmarrësi dhe inovacion.

Në anën tjetër, Komisioni Evropian përmes projektit Tempus ka krijuar mundësinë e zhvillimit të programit të studimeve dhe ndërtimit të Qendrës për Inxhinieri dhe Eficiencë të Energjisë.

Të gjitha këto aktivitete dhe aktivitete të tjera kanë qëllim që ne si UBT (studentë, staf) por edhe si Kosovë t'u përgjigjemi sfidave dhe mundësive të reja.

Fokusimi në Cilësi dhe Inovacion e vendos UBT-në në presion, mirëpo nga kjo ne arrijmë të krijojmë mundësi të reja, përmirësime të vazhdueshme, punësim, respekt, ndërkombëtarizim, shkencë, etj.

Për këtë kërkohet një angazhim edhe më i madh i të gjithëve, edhe stafit dhe studentëve.

Dhe në këtë rast është për t'u përhëndetur dhe përgëzuar angazhimi gjithnjë më i madh i studentëve në procesin e zhvillimit të UBT-së. Përfaqësuesit e studentëve kanë marrë një rol proaktiv dhe po ndihmojnë në cilësinë e informacioneve dhe vendimmarrjeve në UBT.

"Ask not what your country can do for you - ask what you can do for your country".

John F. Kennedy



14 YEARS

LEADERSHIP and INNOVATION

Education • Research • Training • Consulting
2001/2015

IMPRESUM

UBT News - Gazetë e studentëve të UBT-së,

Botues: Edmond Hajrizi

Gazetën e përgatitën studentët e Fakultetit për Media dhe Komunikim në UBT.

Adresa: www.ubt-uni.net | **Tel:** 038 541 400, 044 541 400

Thyerja Grafike: ELV Studio

Shtypet në Shtypshkronjën «Roto Print»



UNIVERSITY EDUCATION
FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY

AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY

INTERVISTA ME REKTORIN E UBT-SË, EDMOND HAJRIZIN

UBT LA PRAPA NJË VIT SHUMË TË MIRË, PO HYN NË VITIN E PROJEKTEVE TË MËDHA

Cilat ishin të arriturat e UBT-së në vitin 2014 dhe cilat janë planet dhe projektet për vitin 2015. Për këto dhe çështje të tjera, flet rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi

Intervistoi: Besart Troshupa

- I nderuar rektor. Ky është numri i parë i "UBT News" në këtë vit dhe intervista juaj e parë në 2015. Themi për fillim të bëjmë në pika të shkurtra një rekapitulim të vitit 2014. Çfarë ishte ai për UBT-në?

E. Hajrizi: Edhe vitin 2014 mund ta konsiderojmë si vit të suksesshëm, për arsye se kemi pasur shumë indikatorë. Kemi pasur rritje të numrit të studentëve në vazhdimësi edhe në vitin 2014, kemi rritje të stafit, rritje të infrastrukturës. Ju e dini që kemi punuar mjaft shumë në ndërtesën tjetër të kampusit inovativ, kemi krijuar partneritete me universitete të ndryshme, me institucione të ndryshme, kemi zhvilluar projekte të ndryshme zhvillimore hulumtuuese, gjithashtu kemi fituar projekte nga Komisioni Evropian dhe donator të tjerë. Kështu që, këta janë disa indikatorë që tregojnë se UBT është në rritje e sipër dhe në zhvillim.

- UBT e ka shtuar numrin e programeve, numrin e studentëve, numrin e profesorëve, po zgjerohet edhe në infrastrukturë. A ishte e mundimshme rruga e mbërritjes deri këtu?

E. Hajrizi: Po kur kam filluar me UBT-në kam qenë vetëm një person, tashmë jemi 400 që punojmë, është një rritje e vazhdueshme dhe një punë e gjatë, sepse ne kemi filluar aktivitetet në 2001, ndërsa sot jemi në 2015, që janë 14 vite punë. Gjatë gjithë këtyre viteve jemi shumë aktivë, të involvuar, të angazhuar. Natyrisht që ka pasur sfida të ndryshme, sfida të jashtme, sfida të brendshme. Faktikisht, mund të themi se ka qenë e mundimshme, por të njëjtën kohë ka qenë edhe një motiv i lartë i yni për ta rritur suksesin e arsimit të lartë në Kosovë, duke pasur parasysh se Kosova është në vend në tranzicion dhe kemi dashur të tregojmë se edhe në tranzicion siç është Kosova mund të ndërtojmë sisteme të arsimit të lartë konform standardeve dhe praktikave ndërkombëtare. Ne po shkojmë në atë drejtim nga vet fakti që kemi marrë një vlerësim për plotësimin e standardeve, njëkohësisht dhe vlershmin për ekselencë që kemi marrë vitin e kaluar. Kjo tregon që UBT ka treguar një stad të zhvillimit mjaft mirë.

- UBT njihet dhe vlerësohet shumë për bashkëpunimet ndërkombëtare. A mund të na flisni për zhvillimet në këtë fushë në vitin 2014?

E. Hajrizi: Në rrugëtimin tonë drejt suksesit nuk mund të anashkalohet faktori që quhet partneritet ndërkombëtar. Ne prej fillimit



"Ky vit do të jetë mjaft interesant. Ne jemi duke e dizajnuar strategjinë 2025 të UBT-së, strategji 10 vjeçare, në bashkëpunim me partnerë universitarë shumë prestigjiozë nga vende të ndryshme. Po ashtu, jemi në themelimin të qendrave të ndryshme siç është ajo për Inkubatori Virtual, Qendra të ndryshme të Ekselencës për sektorë të ndryshëm dhe jemi në fazën e kompletimit të laboratorëve shumë modernë në fushat përkatëse që i ofron UBT-ja". Dr. Edmond Hajrizi

kemi pasur një bashkëpunim të ngushtë me universitetet dhe institucionet ndërkombëtare, të cilat kanë një reputacion të madh në nivel të vendit të tyre dhe ndërkombëtare. Ne edhe vitin e kaluar kemi punuar ngushtë me shumë universitete, kemi rritur numrin e partneriteteve, kemi pasur projekte të përbashkëta nga Komisioni Evropian që është "Erasmus Mundus" dhe "Tempus"-i, projekte të ndryshme me Norvegjinë, me Hungarinë, Austrinë. Faktikisht, kjo ka bërë të mundur që ne të gjenerojmë disa rezultate, siç janë programet e reja. Vitin e kaluar kemi marrë programe të reja për energji ose programin e ri për sistemet e informacionit e shumë specializime të cilat nuk kanë qenë mundshme në Kosovë më përpara.

-Përmes këtyre bashkëpunimeve, shumë studentë dhe mësues të UBT-së kanë shkruar për studime në të gjitha nivelet në universitetet ndërkombëtare. A mund të na flisni më shumë për këtë?

E. Hajrizi: Mobiliteti është njëri nga faktorët e rëndësishëm të vlerësimit të cilësive në arsimin e lart, mobiliteti i stafit dhe i studentëve. Ne e kemi pasur këtë parasysh dhe prej fillimit jemi munduar që, përmes këtyre partneriteteve me universitete të ndryshme, të krijojmë mundësi të mobilitetit të stafit dhe studentëve, shumë pjesëtarë të stafit të tyre kanë ardhur në Kosovë për

edhe shumë nga stafi ynë kanë shkruar jashtë. Kur themi që kanë shkruar jashtë, themi që ka qenë mundësia që të kryejnë studimet e baçelor ose kanë përfunduar studimet në master, kanë shkruar në doktoratë. Ne kemi mbi 20 kandidatë që i kemi dërguar për ta kryer doktoratën, të cilët janë kthyer mbrrapa për të punuar ose për të bashkëpunuar me UBT-në.

E njëjta vlen edhe për studentët. Kemi vizita të shkurtra, vizita njësemestrale, por edhe vjetore, falë bashkëpunimeve, por edhe nëpërmjet bursave që janë ofruar nga Komisioni Evropian. UBT ka qenë përfitues i tyre. Gjithashtu, kemi katër projekte "Erasmus Mundus", ku studentët e UBT-së kanë pasur mundësi të aplikojnë dhe të përfitojnë në këtë mobilitet.

- UBT është e njohur edhe për organizimin e një varg konferencash ndërkombëtare me rëndësi. Cilat ishin ato në vitin e kaluar dhe cili është efekti i tyre?

E. Hajrizi: Qëllimi i konferencave është që të bëhet shkëmbimi i përvojave dhe të krijohen mundësi të publikimit. Ne si UBT kemi konferencën tonë vjetore që tashme quhet Konferenca Ndërkombëtare për Biznes Teknologji edhe Inovacion, që mbahet në çdo nëntor, ku secili fakultet ka pjesën e vet të publikimeve dhe qëllimi kryesor i saj është që të krijohen mundësi për studentet e rinj që ata të publikojnë, të paraqesin tema hulumtuuese akademike të nivelit ndërkombëtar.

Kemi edhe aktivitete të tjera, konferenca të tjera të organizuara në bashkëpunim me institucione dhe organizata ndërkombëtare, siç është IFAC, EuroSim, IPM, organizata të cilat kanë një kulturë në organizimin e konferencave profesionale shkencore dhe ne kemi qenë bashkorganizatorë dhe kemi qenë pjesë e organizimeve, ose kemi organizuar ne dhe ata na kanë mbështetur. Ka edhe ngjarje, konferenca të tjera, siç është shkolla verore, universiteti veror i UBT-së, akademia verore, mundësia për ndihmesë në ngritjen e kapaciteteve akademike edhe shkencore në vend.

- Gjithashtu, UBT ka një bashkëpunim shumë të mirë me institucionet e vendit, qoftë në nivelin qendror, qoftë në nivelin lokal. Cila është ekspertiza dhe ndihma që u ofron atyre UBT?

E. Hajrizi: UBT, përveç që ofron studime dhe hulumtime, mundohet t'i ndihmojë edhe shoqërisë përmes projekteve të ndryshme hulumtuuese zhvillimore inovative në të gjitha nivelet, edhe në nivelin qendror edhe në atë lokal, po ashtu edhe regional, tek bizneset, tek individët. Vitin e kaluar kemi punuar mjaft shumë projekte për zhvillim të Kosovës, aspektin e zhvillimit të strategjive për zhvillim ekonomik në disa komuna, studime të fizibilitetit për zona të lira ekonomike në Gjakovë dhe në Gjiilan, ngritjen e kapaciteteve në nivelin regjional, po ashtu kemi bërë hulumtime të ndryshme të

opinionit për tema të caktuara. Këto janë disa nga projektet me të cilat UBT mundohet të japë kontributin e vet. Natyrisht, jemi të involvuar edhe në shumë komitete apo grupe punuese që organizohen në nivel qendror, që kanë të bëjnë me krijimin e strategjive të ndryshme me ligje, projekte Kosovë- Komision Evropian. Kemi qenë të involvuar edhe në Procesin e Bolonjës, mandej në "Horizont 2020" e shumë të tjera.

- UBT ka publikuar një varg librash të profesorëve, ajo publikon gazetën e studentëve, gazetën e alumnit, ku prezantohen të arriturat e UBT-së, por edhe të ish-studentëve. Cilat janë planet për zgjerim në fushën e medias dhe komunikimit?

E. Hajrizi: Sa i përket publikimeve, duke marrë parasysh numrin e madh të stafit dhe studentëve, mendojmë që ka mjaft informacione të cilat duhet të përpunohen dhe duhet të botohen, qoftë në nivel Gazete, apo Portali, në gazeta profesionale shkencore siç është tani «Politologu» apo «Ndërmarrësia», por edhe në nivel të librave me autorë të ndryshme, me profesorë të UBT-së që janë duke punuar që të gjenerojnë edhe informacione në gjuhën shqipe, sepse si të tilla mungojnë. Në anën tjetër, Fakulteti i Medias dhe Komunikimit tash do ta luajë edhe një rol më të madh sa i përket informimit të opinionit, bartjes së këtyre dijeve, informacioneve nga UBT-ja jashtë por edhe anasjelltas. Mendoj që do të ketë shumë e më shumë potencial, qoftë në nivelin e gjenerimit të këtyre publikimeve në mediat e shkruara, në media digjitale apo në radio apo televizion.

- I nderuar rektor. Jemi në fillim të vitit 2015. A mund të na shpalosni një pjesë të planeve të UBT-së për këtë vit?

E. Hajrizi: Ky vit do të jetë mjaft interesant. Ne jemi duke e dizajnuar strategjinë 2025 të UBT-së, strategji 10 vjeçare, në bashkëpunim me partnerë universitarë shumë prestigjiozë nga vende të ndryshme. Po ashtu, jemi në themelimin të qendrave të ndryshme siç është ajo për Inkubatori Virtual, Qendra të ndryshme të Ekselencës për sektorë të ndryshëm dhe jemi në fazën e kompletimit të laboratorëve shumë modernë në fushat përkatëse që i ofron UBT-ja. Kështu që do të jetë një vit shumë dinamik dhe besoj që do të kemi edhe rezultate të mira. Ne kemi punuar mjaft shumë edhe në aplikim edhe në projekte evropiane dhe shpresojmë që edhe aty do të kemi projekte shtesë me interes për neve edhe për Kosovën.

“UBT-ja është fleksibile, ka një dinamikë të zhvillimit profesional, raport njerëzor-shoqëror me stafin, është një shpejtësi shumë më e zhvilluar, informacioni depërton më shpejt”, thotë për “UBT News” z. Emini

Intervistoi: Albina Zeneli

UBT News: I nderuar profesor, së fundi jeni zgjedhur drejtor për çështje akademike në UBT. A mund të na thoni çfarë sfide paraqet kjo detyrë për ju?

Emini: Së pari faleminderit për këtë intervistë. Është intervista e parë që po e zhvilloj si drejtor për çështje akademike në UBT. Pika e parë, kjo është sfida në vete. Vetë detyra e ka një kompleksitet të veçantë, e cila është e pazbërthueshme. UBT-ja ngërthen në vete rreth gjashtë mijë studentë apo pjesëtarë të familjes. Në kuadër të saj kemi nëntë departamente ku secili e ka karakteristikën e vet, çdo drejtim i ka specifikat e veta. Juristi, ekonomisti, gazetari etj. Është një sfida e madhe, e cila po tejkalohet me kohë, për momentin është mirë, në avancim e sipër.

UBT News: A mund të na flisni për rrugëtimin tuaj, ndërlidhur me UBT-në, angazhimin në këtë institucion dhe përgatitjen profesionale që e keni arritur në UBT dhe në institucione të tjera akademike?

BISEDË ME ARDIAN EMININ, DREJTOR PËR ÇËSHTJE AKADEMIKE NË UBT

UBT E VË STUDENTIN NË PLAN TË PARË



“Ne te studenti dëshirojmë ta shohim një zëvendësues në kuptimin pozitiv. Nëse ne kemi arritur në këtë stad, atëherë tendenca jonë është që studentët tanë të jenë më kualitativë se ne”. Ardiان Emini

Emini: Me UBT-në jam prej 2010. Fillimisht kam qenë ligjërues në drejtimin e Juridikut. Këtu ishte edhe rrugëtimi im i parë. Lëndët që i kam mbajtur ka qenë Historia e shtetit dhe e së drejtës dhe Filozofia e së drejtës. Pas dy viteve të ligjërimit e kam marrë pozicionin e koordinatorit të drejtimit të Juridikut, pastaj jam bërë prodekan i fakultetit të këtij drejtimi. Në vitin 2014 i kam mbaruar studimet e doktoratës në Universitetin e Tiranës dhe prej asaj kohe kam qenë dekan i Juridikut, ndërsa prej tetorit jam drejtor për çështje akademike.

UBT News: Ju keni përcjellë punën edhe në institucione të tjera akademike. Ku është UBT në këtë plan?

Emini: Në këtë plan, nëse e marrim krahasueshmërinë me institucionet e tjera, UBT-ja është fleksibile, ka një dinamikë të zhvillimit profesional, raport njerëzor-shoqëror me stafin, është një shpejtësi shumë më e zhvilluar, informacioni depërton më shpejt në UBT.

UBT News: Çfarë hapash ndërmerren në UBT në drejtimin e ngritjes së nivelit akademik, por edhe në fushën e hulumtimeve?

Emini: Ka shumë etapa për ndërmarrjen e hapave. Është një strategji zhvillimore. Hapat e parë

që ndërmerren që e kemi në stad të lartë, janë se organizohen punëtori, seminare, trajnime të ndryshme për zhvillimin e stafit respektivisht edhe nxitjen për hulumtim. Përveç kësaj studentëve u japim edhe hapësirë të marrin pjesë nëpër projekte, ose formojmë grupe të veçanta për hulumtime. Në UBT janë të pranishme edhe shumë projekte ndërkombëtare. Këtu përmendim pjesëmarrjen e UBT-së në “ErasmusMundus”, “Tempus”, “Horizont 2020”, ku ka mundësi stafi të inkorporohet në këto organizma për veprimtari.

UBT News: A e ka të rregulluar UBT çështjen e thirrjeve akademike për profesorë dhe kur mendoni se mund të ndërmerren hapa konkretë në këtë drejtim?

Emini: UBT-ja qysh herët e ka pasur këtë rregullorë, edhe para se të ekzistojë ligji për thirrje akademike. Tash është lehtësim sepse është një bazë ligjore. Jemi në procesim të një organizimit ndërkombëtar që thirrja e profesorit të ketë një bazament ndërkombëtar dhe të jetë më me peshë.

UBT News: UBT ka përmbyllur vitin 2014 me një varg arritjesh të rëndësishme. Cilat janë sfidat që e presin UBT-në në vitin 2015?

Emini: E para është inkorporimi i stafit akademik, studentët të inkorporohen paralelisht me profesorët në hulumtime, në projekte. Tash është një bashkëpunim profesorë-studentë dhe të avancohet kjo çështje. Plan tjetër është edhe rritja e kapacitetit të studentëve, avancimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies.

UBT News: Sa i ndihmon studentit marrëdhënia me stafin akademik dhe konkretisht me juve si një zyrë shumë e rëndësishme?

Emini: Në këtë trinom studentidekani-profesori, nëse i shkrijmë këto personalitete do të ishte një efektivitet shumë i madh. Do të ishte një liri në komunikim, heqja e tabuve ose paragjyqimeve mes dy palëve. Deri sot në institucione të tjera këtë qasje të lirë nuk e kam parë. Ne te studenti dëshirojmë ta shohim një zëvendësues në kuptimin pozitiv. Nëse ne kemi arritur në këtë stad, atëherë tendenca jonë është që studentët tanë të jenë më kualitativë se ne.

UBT News: Cila është porosia juaj për studentët?

Emini: Porosia ime për studentët është mësim, mësim dhe vetëm punë.

PROFESORI NGA UNIVERSITETI I SALSBURGUT NË PRISHTINË

PROFESORI JOERG ZUMBASH LIGJËROI PARA STUDENTËVE TË UBT-SË

Ndër temat kryesore në këtë ligjëratë ishin: Memoria e njeriut, memoria afatshkurtër, memoria afatgjatë, mësimet me logjikë, mësimi përmendësh, kapaciteti dhe matjet e trurit e të tjera



“Teknologjia nuk e ka shkatërruar mendjen tonë, por e ka bërë më të lehtë e më të kapshme mënyrën e mësimin dhe përdorimit të metodave të efektshme”, tha profesori Joerg Zumbash

“Teknologjia nuk e ka shkatërruar mendjen tonë, por e ka bërë më të lehtë e më të kapshme mënyrën e mësimin dhe përdorimit të metodave të efektshme”, tha profesori nga Universiteti i Salsburgut, Joerg Zumbash gjatë një ligjërate para studentëve të UBT-së.

Profesori Joerg Zumbash ka vizituar dje UBT-në, ku është njohur me punën e këtij institucioni dhe aktivitetet e ndryshme që zhvillohen në të. Mësimdhënësja në UBT, Fatbardha Qehaja dhe koordinatoreja e drejtimit Media dhe Komunikim, Lirigzona Morina e pritën profesorin Zumbach dhe diskutuan me të për një varg çështjesh me interes.

Gjatë qëndrimit në UBT, profesori Joerg Zumbach mbajti një ligjëratë para studentëve të UBT-

së në temën , e cila zgjoi interesimin e një numri të madh të studentëve.

Ai ishte i ftuar të fliste për temën: “Afërsia Hapësinore dhe Efekti i Modalitetit”.

Përgjatë ligjëratës, profesori Zumbach paraqiti gjetjet e tij të fundit rreth hulumtimit të kësaj fushe, duke i detajuar ato dhe duke dhënë sqarime shtesë. Ndër temat kryesore në këtë ligjëratë ishin: Memoria e njeriut, memoria afatshkurtër, memoria afatgjatë, mësimet me logjikë, mësimi përmendësh, kapaciteti dhe matjet e trurit e të tjera.

Ligjëratë u përcoll me interesim nga studentët, të cilët shtruan një varg çështjesh për bashkëbisedim me ligjëruesin.

KONTRIBUTI I UBT-SË PËR ZHVILLIMIN E KOMUNAVE TË KOSOVËS

Kuvendi i Ferizajt miratoi strategjinë e zhvillimit 2014-2017, të hartuar nga UBT

UBT, me ekipet e tij të ekspertëve, ka hartuar strategjitë e zhvillimit edhe për disa komuna të tjera të Kosovës

Kuvendi Komunal i Ferizajt, në një mbledhje të mbajtur më 27 nëntor, miratoi Draftstrategjinë e zhvillimit afatmesëm të Komunës së Ferizajt për vitet 2014-2017, e cila u hartua nga ekspertët e UBT-së.

I pranishëm në seancën e Kuvendit Komunal, rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi tha se kjo strategji është komplete dhe e hartuar në mënyrë profesionale.

Ai shtoi se për hartimin e kësaj strategjie janë shfrytëzuar përvojat nga shtete të tjera, si dhe janë konsultuar edhe ekspert të huaj.

«Strategjia analizon gjendjen, paraqet pengesat dhe dobësitë, ndërsa edhe jep kahet zhvillimore të komunës. Në këtë strategji jemi munduar të strukturojmë gjashtë objektiva strategjike që ngërthejnë në vete zhvillimin ekonomik, infrastrukturën dhe ambientin, turizmin, kulturën dhe sportin, administratën publike, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale si dhe arsimin dhe edukimin», tha dr. Hajrizi.

Dr. Hajrizi tha se, pas hartimit dhe miratimit të dokumentit, i mbetet ekzekutivit të komunës që gjatë këtyre tri viteve ta zbatojë këtë strategji.

Ai theksoi nevojën e fillimit të menjëhershëm të jetësimit të projekteve që parasheh strategjia.

UBT, me ekipet e tij të ekspertëve, ka hartuar strategjitë e zhvillimit edhe për disa komuna të tjera të Kosovës.



«Strategjia analizon gjendjen, paraqet pengesat dhe dobësitë, ndërsa edhe jep kahet zhvillimore të komunës», tha dr.Hajrizi gjatë prezantimit të strategjisë

PËRVOJAT DHE BASHKËPUNIMET NDËRKOMBËTARE

STUDENTËT E ARKITEKTURËS DHE TË NDËRTIMTARISË NË VIZITË STUDIMORE NË DISA VENDE TË EVROPËS

Të udhëhequr nga profesorët Dr. Muhamet Ahmeti dhe Dr. Ajhan Bajmaku, 77 studentë qëndruan për vizitë në Kroaci, Itali, Çeki, Austri dhe Slloveni

Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe të Ndërtimtarisë në UBT zhvilluan një vizitë studimore në disa shtete të Evropës.

Të udhëhequr nga profesorët Dr. Muhamet Ahmeti dhe Dr. Ajhan Bajmaku, 77 studentë qëndruan për vizitë në Kroaci, Itali, Çeki, Austri dhe Slloveni.

Në nismë të vizitës, studentët qëndruan në qytetin e Dubrovnikut në Kroaci, ku vizituan qytetin e vjetër dhe disa galeri, për të vazhduar vizitën në qytetin Rijekës.

Gjatë qëndrimit në Itali, studentët fillimisht vizituan Bienalen e Arkitekturës në Venedik të Italisë.



Nga vizita e studentëve të UBT-së

Ata vizituan shumë pavijone të shteteve të ndryshme, në veçanti atë të Kosovës dhe të Shqipërisë.

Pastaj studentët qëndruan edhe në qytetin e vjetër të Venedikut, ku vizituar objektet me rëndësi historike dhe arkitektonike, si

dhe një kohë të caktuar e kaluan në sheshin e njohur "San Marko".

Vizita vazhdoi në objektet e ndryshme në Romë, ku studentët qëndruan në Fakultetin e Arkitekturës. Ata gjithashtu vizituan muzeun që gjendet afër këtij fakul-

teti dhe ku janë të ekspozuara vepra me vlera shumë të madhe artistike, piktura, skulptura e vepra të tjera artistike të periudhës së hershme të viteve 1800. Po ashtu, ata vizituan edhe Panteonin, një vepër shumë me vlerë artistike, po ashtu është vizituar edhe fontanën e dëshirave (Fontana di Trevi Roma).

Studentët vizituan edhe Kolo-seumin, qytetin e vjetër romak, Panteonin, si dhe një numër të madh të objekteve të tjera me rëndësi arkitektonike, bibliotekën në Romë, një nga projektet shumë me rëndësi dhe me vlerë, të projektuar nga arkitektja e njohur Zaha Hadid, muzeun Maxxi, gjithashtu edhe ekspozitën e interierit dhe dizajnit modern të interierit.

Ata vizituan edhe shumë objekte me rëndësi në Vatikan, si dhe realizua një vizitë në shumë objekte të rëndësishme në qytetin e Firencës.

Gjatë qëndrimit në Çeki, studentët vizituan një varg objektesh në qytetin e Pragës, si dhe realizuan një varg takimesh të rëndësishme.

Në Vjenë të Austrisë, vizita filloi me ligjëratat në Fakultetin Teknik, me profesorët Tomas Dilinger dhe Skender Kosumi. Më pas ata vizituan muzeun Mak, ku janë prezantuar punime të ndryshme si dhe pjesë të enterierit të periudhave të ndryshme historike, si dhe skulptura të artit kinez. Ata vizituan sheshin e rrugës "Marie Hilfe Strase" ku u trajtua çështja e përdorimit të materialeve për rregullimin e këtij sheshi.

Një ditë më vonë, studentët vizituan pallatin mbretëror Shenbrun, pastaj disa objekte në të cilat është kryer rivitalizimi, pastaj kampusi i Fakultetit Ekonomik të Vjenës, garazhet moderne nëntokësore, si dhe objektin Hunderwaser.

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË

STUDENTËT E NDËRTIMTARISË NË UBT VIZITUAN FABRIKËN E PËRPUNIMIT TË UJIT NË BADOVC

Studentët e Fakultetit të Ndërtimtarisë në UBT vizituan sot fabrikën e përpunimit të ujit në Badovc.

Studentët, së bashku me përgjegjës për programin e Ndërtimtarisë, dr. Muhamet Ahmeti dhe profesorin e lëndës së Hidraulikës, Ilir Avdullahu u njoftuan me punën që kryhet në këtë objekt me rëndësi tepër të veçantë.

Gjatë kësaj vizite, ata gjithashtu vizituan edhe tubacionin e pendës së liqenit, ku sot kanë filluar testimet hidraulike në tunelin e pendës.

Ata përcollën punimet në tubacionin në drejtim të stacionit të pompave, pjesën e vjetër të objektit ku bëhet përpunimi i ujit të pijes me të cilin furnizohen banorët e Prishtinës dhe të disa vendbanimeve të tjera. Gjithashtu, ata shikuan nga afër punimet që po bëhen në fabrikën e re të përpunimit të ujit, si dhe rezervuarët e trajtimit të ujit.



Studentët shikuan nga afër punimet që po bëhen në fabrikën e re të përpunimit të ujit, si dhe rezervuarët e trajtimit të ujit

SYRI



NË UBT

U MBAJT LIGJËRATA TEMATIKE PËR KULMET E RRAFSHËTA

Prezantimi u bë nga përfaqësuesi i kompanisë gjermane "WOLFIN" dhe përfaqësues të disa kompanive të tjera që merren me prodhimin e materialeve për hidroizolime

Studentë, profesorë dhe të interesuar të tjerë kanë qenë të pranishëm në ligjëratën tematike për kulmet e rrafshëta, që është organizuar më 19 dhjetor 2014 në Fakultetin e Ndërtimtarisë në UBT.

Prezantimi u bë nga përfaqësuesi i kompanisë gjermane "WOLFIN" dhe përfaqësues të disa kompanive të tjera që mer-

ren me prodhimin e materialeve për hidroizolime.

Në prezantim ishte i pranishëm përgjegjësi i Fakultetit të Ndërtimtarisë në UBT, njëkohësisht ligjërues i lëndës Konstruksionet Arkitektonike në Fakultetin e Arkitekturës, Dr. Muhamet Ahmeti.

Gjithashtu ishin të pranishëm edhe përfaqësues të biznesit

vendor, mes të cilëve edhe drejtori i kompanisë "Hidroizolimi Shala", që merret me ekzekutimin e punimeve në kulmet e rrafshëta dhe hidroizolime, z. Selim Shala.

Gjatë këtij prezantimi, studentët janë njoftuar me materialet më të reja që përdoren për punimin e kulmeve të rrafshëta, si dhe janë dhënë sqarime detaje lidhur me karakteristikat e këtyre materialeve edhe për mënyrën e punimit me këto materiale.

NË KUADËR TË VIZITAVE NËPËR REDAKSITË E MEDIAVE

STUDENTËT E MEDIAS NË UBT VIZITUAN TV KLAN-in



Studentët e vitit të parë të medias dhe komunikimit pranë UBT-së të mërkurën kanë vizituar objektin e ri të TV KLAN. Drejtuesit e këtij televizion Gazmend Syla drejtor dhe Shkodran Gajraku redaktor kanë njohur studentët me punën që bëjnë gazetarët, kronikat e realizuara, vështirësitë që hasin ata gjatë punës, por edhe për kushtet moderne që posedon aktualisht ky medium.

Studentët e UBT-së në drejtimin media dhe komunikim kanë vizituar zyrat, hapësirat dhe të gjitha studiot e TV KLAN. Gazmend Syla dhe Shkodran Gajraku drejtues të këtij mediumi shumë atraktiv dhe profesional në Kosovë kanë njohur studentët me kushtet moderne që aktualisht ka ky medium. Studiot e reja, kushtet maksimale për punë, atmosfera brenda zyrave të gazetarëve, teknika dhe teknologjia moderne që zotëron ky medium dhe guximin që kanë për të zhvilluar ga-

zetari hulumtuës ishin një nga pikat kryesore që ka referuar Gazmend Syla. Studentët të shoqëruar nga profesori Musa Sabedini janë mahnitur me kushtet tejet moderne që ka TV KLAN.

Studentët kanë bërë pyetje të shumta dhe janë interesuar për raportimet që bëhen, për kronikat, regjinë brenda TV, emisionet që zhvillohen nga fushat e ndryshme, intervistat e ndryshme, rubrikat e specializuara etj. Studentja Marigona Kqiku tha se është ndier tepër e befusuar me kushtet që ka parë në TV KLAN. "Pashë një televizion modern me shumë studio, me shumë ekstra kushte dhe me një organizim të mrekullueshëm redaksional".

Studentët gjithashtu kanë bashkëbiseduar me gazetarët e këtij mediumi Kushtrim Sadiku, Avdyll Pajaziti, Zija Miftari, Valentina Ahmetaj nga të cilët kanë mësuar për përvojën dhe sfidat që ka gazetaria televizive.

KRYETARI I KOMISIONIT TË PAVARUR PËR MEDIA NË UBT



Kryetari i KPM-së, z.Merovci paraqiti gjithashtu para studentëve të dhëna rreth funksionimit të Komisionit të Pavarur për Mediave

ADNAN MEROVCI FOLI PËR "DIGJITALIZIMIN NË KOSOVË"

Në bashkëbisedim me studentët, z.Merovci ka folur lidhur me "Strategjinë për kalim në transmetim digjital tokësor në Republikën e Kosovës", duke e elaboruar në detaje këtë proces të rëndësishëm, rreth të cilit është punuar një kohë të gjatë, ndërsa i tërë procesi është paraparë të përmbyllet deri më 17 qershor 2015

Adnan Merovci, kryetar i Komisionit të Pavarur për Media (KPM), ka mbajtur sot një ligjëratë tematike para studentëve dhe mësimdhënësve të UBT-së në temën "Digjitalizimi në Kosovë".

Në bashkëbisedim me studentët, z.Merovci ka folur lidhur me "Strategjinë për kalim në transmetim digjital tokësor në Republikën e Kosovës", duke e elaboruar në detaje këtë proces të rëndësishëm, rreth të cilit është punuar një kohë të gjatë, ndërsa i tërë procesi është paraparë të përmbyllet deri më 17 qershor 2015.

Ky afat, i cili duket shumë i afërt, është përcaktuar nga Konferenca e Gjenevës, e cila për rajonin e Ballkanit e ka përcaktuar këtë afat, ndërkohë që ky proces në shtetet kryesore të Evropës është kryer në vitin 2012, ndërsa edhe disa shtete të rajonit kanë bërë hapa të rëndësishëm drejt përmbylljes së procesit të digjitalizimit.

Tash për tash, "Strategjia për kalim në transmetim digjital tokësor në Republikën e Kosovës" është në fazën e diskutimit publik, ku të gjithë të interesuarit mund të japin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre.

Z.Merovci theksoi se, megjithëse krijohet ideja se në këtë proces në Kosovë janë krijuar vonesa, hapat në vazhdim, që varen nga Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës, mund të ndërmerren shumë shpejt dhe procesi mund të përmbyllet me kohë.

Kryetari i KPM-së, z.Merovci ka paraqitur gjithashtu para studentëve të dhëna rreth funksionimit të Komisionit, dhënies së licencave, lidhur me numrin e mediave që funksionojnë në Kosovë, për format e ndryshme të transmetimit e të dhëna të tjera me interes.

Gjithashtu, z.Merovci foli edhe për një varg procesesh që duhet të kryejnë vetë mediat, siç është, për shembull, digjita-

lizimi i brendshëm e procese të tjera që ndikohen nga zhvillimet teknologjike, të cilat gjithsesi se ecin dhe zhvillohen gjithnjë më shpejt sesa legjislacioni përkatës që e rregullon fushën e funksionimit të mediave digjitale.

Ai gjithashtu numëroi edhe një varg përparësish që ofron digjitalizimi, përfshirë shtimin e kanaleve, rritjen e kualitetit, shërbime dhe informata shtesë e përparësi të tjera.

I themeluar në vitin 2005, Komisioni i Pavarur i Mediave është organ kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës. Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, KPM-ja licencon transmetuesit publikë e privatë, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit, si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë, të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

KRYETARI I ODËS EKONOMIKE TË KOSOVËS MBAJTI NJË LIGJËRATË TEMATIKE PARA STUDENTËVE TË UBT-SË

GËRXXHALIU: PO E PAGUAJMË ME ÇMIM SHUMË TË LARTË PERIUDHËN E TRANZICIONIT

"Në të gjitha periudhat kohore, por edhe sot, është zhvillimi, është bashkëpunimi ekonomik ai që i heq barrierat midis shteteve dhe siguron integrim e prosperim të shteteve dhe të qytetarëve", tha z. Gërxhaliu

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu mbajti sot një ligjëratë tematike para studentëve të UBT në temën "Rëndësia e zhvillimit ekonomik në Kosovë dhe proceset integruese".

Z.Gërxhaliu në ligjëratën e tij tërhoqi vëmendjen se zhvillimi i mirëfillt ekonomik, në një ekonomi të shëndoshë, në një shtet ku sundon rendi dhe ligji, është rruga më e mirë dhe më e sigurt për proceset integruese. Ai theksoi faktin se në të gjitha periudhat kohore, por edhe sot, është zhvillimi, është bashkëpunimi ekonomik ai që i heq barrierat midis shteteve dhe siguron integrim e prosperim të shteteve dhe të qytetarëve.

Duke i bërë një vështrim gjendjes në të cilën ndodhet sot Kosova, z.Gërxhaliu theksoi se ne po e paguajmë me çmim shumë të lartë periudhën e tranzicionit. Ai gjithashtu tërhoqi vëmendjen në mungesën e një planifikim të mirëfillt, i cili do të hapte rrugët e një zhvillimi me plan dhe strategji afatgjatë. Ai e theksoi si një hap shumë të rëndësishëm drejt integritimit edhe internacionalizimin e ndërmarrësisë, një proces të vështirë të përmbushjes së një varg kriteresh për funksionimin dhe zhvillimin ekonomik të një shteti.

Z.Gërxhaliu gjithashtu theksoi se e ardhmja e zhvillimit të shtetit tonë duhet të matet me shkallën e zhvillimit të sektorit privat, që është edhe shtylla e zhvillimit të një shteti. Ndërlidhur me këtë, ai tërhoqi vëmendjen se një shtet që investon dhe kujdeset vetëm për administratën publike, ai ndjell vetëm varfëri e jo me zhvillim.

Mes të tjerash, gjatë debatit me studentët e UBT-së, kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, z.Safet Gërxhaliu theksoi se vetëm zhvillimi ekonomik është ai që do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në një varg procesesh që po ndodhin aktualisht në vendin tonë, përfshirë ndaljen e emigrimit ilegal të qytetarëve, një proces që ka marrë shumë hov kohëve të fundit, përsheptimin e proceseve integruese, por edhe rritjen e imazhit të Republikës së Kosovës.



"Zhvillimi ekonomik është ai që do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në një varg procesesh që po ndodhin aktualisht në vendin tonë, përfshirë ndaljen e emigrimit ilegal të qytetarëve"

Rektori i UBT-së Edmond Hajrizi ka qëndruar në fund të dhjetorit disa javë nëpër Evropë duke përfshirë vendet si Salzburgu dhe Vjena në Austri, Louven në Belgjikë si dhe Frankfurtin dhe Wiesbaden në Gjermani.

Rektori i UBT-së, dr. Edmond Hajrizi ka qëndruar në fund të dhjetorit disa javë nëpër Evropë duke përfshirë vendet si Salzburgu dhe Vje-

REKTORI I UBT-SË NË VIZITË NË DISA SHTETE TË EVROPËS

UBT SHTON RESPEKTIN NË EVROPË, MERRET SI MODEL SUKSESI

na në Austri, Louven në Belgjikë si dhe Frankfurtin dhe Wiesbaden në Gjermani.

Edmond Hajrizi tha se gjatë qëndrimit nëpër këto vende ka pasur mundësi të takohet me personalitete të ndryshme të universiteteve të këtyre vendeve, të Unionit Evropian, shoqatës evropiane për cilësi si dhe përfaqësues të bizneseve nga Evropa.

Nga këto takime ka pasur një rezultat tepër frytd-

hënës meqë është diskutuar dhe është vendosur që UBT të ketë me këto universitete më shumë partner strategjik për projektet evropiane.

Nga këto takime është dakorduar edhe në aplikimin e përbashkët në projektet "Erasmus Plus" si dhe u dakordua që në vitin e ardhshëm Kosova të jetë mikpritëse e mbledhjes e radhës së kryesisë së orga-

nizatës Evropiane për cilësi dhe e disa shkollave verore të përbashkëta.

Rektori Hajrizi tha se marrja e certifikimit për excellence ka shtuar edhe më shumë respektin e UBT-së në Evropë.

Tanimë shumë organizata të ndryshme kanë ftuar rektorin Hajrizi në vitin 2015 që të prezantoi modelin e suksesit të UBT-së në relacion me eksellencën.



BASHKËPUNIMI MIDIS QENDRËS PËR HULUMTIM TË OPINIONIT NË UBT DHE INSTITUTIT TË MEDIAS TË KOSOVËS

U PUBLIKUA HULUMTIMI "PAVARËSIA DHE BESUESHMËRIA E MEDIAVE NË KOSOVË"

Rezultatet e prezantuara të hulumtimit "Pavarësia dhe besueshmëria e mediave në Kosovë" janë vetëm pjesa e parë e një projekti më të gjerë, i cili parasheh realizimin edhe të dy hulumtimeve të tjera deri në fund të vitit, për të pasur një publikimit të pasqyrimin të plotë të mendimit të qytetarëve rreth kësaj pavarësisë dhe besueshmërisë së mediave në vendin tonë.

Hulumtimi "Pavarësia dhe besueshmëria e mediave në Kosovë", i realizuar nga Qendra për Hulumtim të Opinioneve në UBT dhe Instituti i Medias të Kosovës, është prezantuar sot në Prishtinë, me pjesëmarrje të editorëve, gazetarëve e përfaqësuesve të mediave dhe të institucioneve të ndryshme.

Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi, në hapje të prezantimit, theksoi se ky hulumtim ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit mes UBT-së dhe Institutit të Medias të Kosovës, institucione këto që kanë ndërtuar një strategji bashkëpunimi edhe në projekte të tjera.

Rezultatet e prezantuara të hulumtimit "Pavarësia dhe besueshmëria e mediave në Kosovë" janë vetëm pjesa e parë



e një projekti më të gjerë, i cili parasheh realizimin edhe të dy hulumtimeve të tjera deri në fund të vitit, për të pasur një publikimit të pasqyrimin të plotë të mendimit

të qytetarëve rreth kësaj pavarësisë dhe besueshmërisë së mediave në vendin tonë.

Fazli Veliu, kryetar i Bordit të Institutit të Medias të Kosovës,

theksoi se hulumtimi e ka peshën e tij më të theksuar sidomos në hulumtimin e besueshmërisë së mediave, një fushë e cila nuk është edhe aq e hulumtuar në vendin tonë.

Hulumtimi është realizuar në formë të anketimit, e përzgjedhur si e tillë pasi UBT dhe IMK dëshirojnë të ofrojnë raport me të dhëna parësore. Të anketuarit janë zgjedhur rastësisht. Moshja e tyre është nga 18 deri në 78 vjeç, ndërsa në hulumtim janë mbuluar regjionet kryesore të Kosovës. Nga 1200 të anketuar, 54.43 për qind kanë qenë meshkuj, ndërsa 45.57 për qind femra.

Disa nga pyetjet e të anketuarve në pyetjet e shtruar në hulumtim ishin këto:

Të pyetur cili është burimi prej nga informohen, 60.66 për qind e të anketuarve kanë thënë se burim informatash për ta është interneti, 30.95 për qind televizioni, 4.75 për qind gazetatat, ndërsa 1.64 për qind radiot.

Në pyetjen cilat informacione i preferojnë, përgjigjet janë këto: lajmet vendore (60.33 për qind), lajmet ndërkombëtare (13.44 për qind), lajmet nga sporti (21.15 për qind), lajme të tjera (5.08 për qind).

Të anketuarit i janë përgjigjur edhe pyetjet lidhur me pavarësinë e mediave. 69.84 për qind janë shprehur se në Kosovë ka media të pavarura, ndërsa 30.16 për qind thonë se nuk ka.


Të anketuarit janë pyetur edhe: A janë të politizuara mediat në Kosovë? 17.21 për qind thonë se shkalla e politizimit është 20-30 për qind, 61.31 për qind thonë se kjo shkallë është 50-60 për qind, ndërsa 21.48 për qind mendojnë se shkalla e politizimit të mediave është 80-90 për qind.

Ndërsa, ndërlidhur me besueshmërinë e mediave, mendimet e të anketuarve janë këto: 13.77 për qind e të anketuarve thonë se mediat janë të besueshme, e quajnë pozitiv këtë element, 69.02 për qind flasin e trajtojnë si mesatare besueshmërinë, ndërsa si negative 17.21 për qind.


Qytetarët kanë dhënë përgjigjet e tyre edhe lidhur me besueshmërinë e informatave/lajmeve në internet. Përgjigjet e tyre janë: Shumë mirë 5.90 për qind, mesatarisht mirë 58.69 për qind dhe jo në nivelin e duhur 35.41 për qind.

Tema e hulumtimit ka zgjuar interesim të madh të të pranishmëve, të cilët në një debat të gjerë kanë paraqitur mendimet dhe qëndrimet e tyre rreth temës së pavarësisë dhe besueshmërisë së mediave në Kosovë.

Shpërndarja e anketave



Informatat sigurohen nga:



REKTORI I UBT-SË NË KONFERENCËN "STRATEGJIA E EVROPËS JUGLINDORE 2020, VENDET E PUNËS DHE PROSPERITETI NË PERSPEKTIVËN EVROPIANE"

Një nga sfidat kryesore për të cilat foli z.Hajrizi është ndërlidhja e arsimit me ekonominë, fushë në të cilën ka edhe më shumë për të bërë, me qëllim të sigurimit të një ndërlidhjeje më të mirë mes arsimit dhe ekonomisë, një parakusht ky për zhvillimin më të mirë të të dy fushave.

Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi mori pjesë sot në konferencën "Strategjia e Evropës Juglindore 2020, vendet e punës dhe prosperiteti në perspektivën evropiane", organizuar nga Regional Cooperation Council (RCC) në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe OECD.

Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Hykmete Bajrami theksoi se Strategjia për Evropën Juglindore 2020 është aprovuar nga Qeveria e Kosovës në mandatin e kaluar, duke shprehur zotimin serioz në emër të Qeverisë së sapokrijuar, për zbatimin

e kësaj strategjie, duke qenë të vetëdijshëm që zbatimi i plotë dhe i suksesshëm i saj do të sjellë vende të reja pune, prosperitet dhe zhvillim ekonomik në Kosovë.

"Me aprovimin e Strategjisë, Kosova ka konfirmuar gatishmërinë për të angazhuar kapacitetet e administratës së vet, përkrahjen institucionale dhe burimet e nevojshme financiare për zbatimin e suksesshëm të saj", tha Ministrja Bajrami.

Ndërsa, rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi, foli mes të tjerash për arsimin e lartë në Kosovë dhe zhvillimin e saj pasluftës.

Hajrizi theksoi se në Kosovë aktualisht ka rreth 110 mijë studentë dhe e quajti këtë një mesatare të mirë të pjesëmarrjes së të rinjve në arsimin e lartë në aspektin statistikor.

Dr.Hajrizi theksoi se përkundër arritjeve që ka arritur Kosova si vend në tranzicion dhe me një ekonomi jo mirë të zhvilluar dhe me shkallë të lartë të papunësisë, arsimit i lartë në vend i ka sfidat e veta të shumta.

Një nga sfidat kryesore për të cilat foli z.Hajrizi është ndërlidhja e arsimit me ekonominë, fushë në të cilën ka edhe më shumë për të bërë, me qëllim të sigurimit të një ndërlidhjeje më



Nga konferenca e organizuar nga Regional Cooperation Council (RCC) në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe OECD

të mirë mes arsimit dhe ekonomisë, një parakusht ky për zhvillimin më të mirë të të dy fushave.

Në konferencë, e cila ka mbledhur zyrtarë të shumta

dhe përfaqësues të fushës së arsimit dhe të ekonomisë, janë trajtuar një varg çështjesh me rëndësi rreth temës së shtruar për trajtim.

NË KUADËR TË PROJEKTIT PËR NDËRMARRËSI TË PËRKRAHUR NGA AMBASADA E SHBA NË PRISHTINË

NË UBT U ZHVILLUA CEREMONIA E PËRZGJEDHJES SË BIZNES-PLANEVE MË TË MIRA

Nga rreth 40 biznes-plane, të realizuara nga rreth 200 studentë, me përkrahjen e profesorëve të tyre, sot u përzgjedhën biznes-planet e realizuara më mirë dhe hartuesit e tyre u nderuan me diploma

Në kampusin e UBT-së u zhvillua ceremonia e përzgjedhjes së biznes-planeve, të realizuara në kuadër të Projektit për Ndërmarrësi të përkrahur nga Ambasada e SHBA në Prishtinë.

Nga rreth 40 biznes-plane, të realizuara nga rreth 200 studentë, me përkrahjen e profesorëve të tyre, sot u përzgjedhën biznes-planet e realizuara më mirë dhe hartuesit e tyre u nderuan me diploma.

Në ceremoni ishte i pranishëm edhe Udhëheqësi i Projektit për Ndërmarrësi nga Ambasada e SHBA, z. Kanishka Gangopadhyay, mysafirë të tjerë, mësimitdhënës, studentë dhe përfaqësues të mediave.

Rektori i UBT-së, dr. Edmond Hajrizi, në një fjalë rasti në hapje të ceremonisë, theksoi përkushtimin e vazhdueshëm të UBT-së për përkrahjen e studentëve në realizimin e projekteve në fushën e ndërmarrësisë dhe në fusha të tjera, si dhe falënderoi Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë për përkrahjen e Projektit për Ndërmarrësi dhe projektet e tjera të UBT-së.

"Ne kemi marrë përkrahje nga Ambasada e SHBA për promovimin e ndërmarrësisë në UBT dhe në Kosovë. Qëllimi i projektit është promovimi sa më i madh i ndërmarrësisë, që konsiderohet si një nga potencialet më të mëdha që mund të ndikojë në zhvillim dhe në punësim. Për rritjen e punësimit ka dy rrugë: e para, t'i zhvillojmë ndërmarrjet tona ekzistuese, që të gjenero-



Në ceremoni ishte i pranishëm edhe Udhëheqësi i Projektit për Ndërmarrësi nga Ambasada e SHBA, z. Kanishka Gangopadhyay, mysafirë të tjerë, mësimitdhënës, studentë dhe përfaqësues të mediave

jnë zhvillim dhe punësim më të madh dhe, e dyta, që të krijojmë ndërmarrje të reja", theksoi z. Hajrizi.

Nga aspekti i analizës së tregut, ndërmarrësia në Kosovë ka mundësi shumë të mëdha dhe të zhvillimit, duke pasur parasysh edhe faktin se kosovarët kanë një shpirt për ndërmarrësi, vijoi ai.

"Ne dëshirojmë që studentët tanë, para se t'i përfundojnë studimet, të përfitojnë dije dhe kompetencë për ndërmarrësi. Ju e dini se ndërmarrësia dhe inovacioni janë termet që përdoren më së shumti në shkolla dhe në të gjitha zhvillimet që konsiderohen të suksesshme. Ndërmarrësia nuk nënkupton vetëm të hapni biznese të reja, por të keni një kompetencë ndërmarrësie edhe brenda organizatës dhe të krijoni qasje proaktive, ide të reja, modele të reja, të plotësoni nevojat dhe kërkesat e tregut dhe të klientit, sa më mirë dhe sa më shpejt", theksoi Hajrizi.

Projekti për Ndërmarrësi përfshin një varg aktivitete, që nga debati, nga ideja e deri te biznes-planet. Ideja është që debati për këtë fushë të dalë edhe jashtë UBT-së dhe të përfshijë gjithë shoqërinë. Po në kuadër të projektit do të jetë edhe një publikim, një revistë profesionale shkencore në fushën e ndërmarrësisë, që do të përfshijë analiza dhe rastet e suksesit

në ndërmarrësi, në mënyrë që edhe të tjerët të kenë qasje dhe të shohin zhvillimet në këtë fushë, shpjegoi Hajrizi.

Gjithashtu, në kuadër të projektit, do të krijohet edhe Biblioteka për ndërmarrësi, ku të gjithë të interesuarit do të kenë qasje në informacionet nga kjo fushë.

Pjesë e projektit do të jetë edhe një inkubator virtual. Ideja është që qytetarët dhe studentët të mos kenë nevojë të qëndrojnë gjithnjë në një tavolinë, por të mund të marrin edhe shërbime, të komunikojnë dhe ta udhëheqin fazën e inkubimit edhe në forma virtuale. Do të krijohet një platformë shumë moderne, që do të jetë mbështetje e fuqishme për ndërmarrësit e rinj, tha Hajrizi.

Duke falënderuar edhe një herë Ambasadën e SHBA, z. Hajrizi theksoi se i gjithë projekti do të përmbillet deri në fund të muajit mars.

Z. Hajrizi theksoi se UBT është duke përfunduar objektin e ri të Kampusit Inovativ të UBT-së, që do të jetë përkrahje e madhe për idetë e reja e deri në realizimin e tyre. Ky kampus është pjesë e Organizatës Ndërkombëtare Shkencore Teknologjike, gjë që mundëson rrjetëzimin me të gjitha parqet teknologjike në botë dhe shkëmbimin e përvojave dhe njohurive.

"Viti 2015 do të jetë vit i krijimit të një ambienti shumë



Rektori Hajrizi flet për Projektin për Ndërmarrësi

mbështetës për ndërmarrësit e rinj, me një vëllim më të madh sesa që jemi mësuar në Kosovë. Për këtë, unë i falënderoj të gjithë ata që na kanë ndihmuar, sidomos Ambasadën e SHBA-ve, jo vetëm për mbështetjen financiare, por edhe për promovimin e ndërmarrësisë në regjionin e Ballkanit Perëndimor dhe të Kosovës. Ju e dini se kultura e ndërmarrësisë vjen nga SHBA dhe ne jemi të interesuar të mësojmë nga kjo përvojë", tha rektori i UBT-së, z. Edmond Hajrizi.

Udhëheqësi i Projektit për Ndërmarrësi nga Ambasada e SHBA, z. Kanishka Gangopadhyay theksoi se qëllim kryesor i Ambasadës Amerikane në Kosovë është zhvillimi i ekonomisë private dhe ndërmarrësia është rruga kryesore për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës dhe ekonomisë së Ballkanit.

"Ne jemi shumë të kënaqur me bashkëpunimin midis UBT-së dhe Ambasadës së SHBA-ve dhe shpresoj se do të bashkëpunojmë edhe disa herë të tjera. Dua të falënderoj studentët për interesin e treguar në fushën e ndërmarrësisë, rektorin dhe ekipin e projektit. Unë kam qenë në Kosovë për më shumë se një vit e gjysmë dhe kam parë se kosovarët janë shumë të talentuar në fushën e biznesit. Mendoj që ne mund të bashkëpunojmë për zhvillimin e konceptit. Ju

keni nevojë për të modernizuar qasjen për ndërmarrësi dhe ne mund të ndihmojmë në këtë drejtim", theksoi z. Gangopadhyay.

Në vijim të ceremonisë u prezantuan biznes-planet e përzgjedhura si më të realizuarat nga më shumë se 40 projekte të realizuara.

Vendi i parë, për projektin e realizuar, i takoi projektit të emërtuar "GlassRecycling", një ide për një kompani për riciklimin e qelqit. Autorë të këtij projekti ishin studentët: Florian Piraj, Perparim Salihu, Mimoza Braha, Njazi Shehu e Uran Cabra.

Me vendin e dytë u nderuar dy biznes-plane: "Fish'n'Chips", projekt për dyqan peshku e pomfriti, ide e realizuar nga studentët Pajtim Shala, Shpend Zhuja, Leutrim Sopjani, Daut Ibrahim, Faton Latifi, si dhe biznes-planin i emërtuar "ProBike", një ide për krijimin e një kompanie që ofron dhe promovon përdorimin e biçikletave nga qytetarët e Prishtinës, realizuar nga studentët Teuta Dervishi, Armira Fetoshi, Palush Doda, Kaltrina Mehmeti e Erza Mehmeti.

Me vendin e tretë u nderua biznes-planin "BioShop", një ide për një dyqan prodhimesh bio, realizuar nga studentët Marigona Xhemajli, Dina Demiri, Fatbardha Pacolli, Donika Ismaili e Anesa Hoxha.

ME SHKAS

PËR IKJEN DHE BIZNES-PLANET E STUDENTËVE

Ditën kur studentët e UBT-së po prezantonin biznes-planet, një zyrtar nga një komunë jona po bënte çmos të gjente dikë që të intervenojë tek autoritetet në Hungari për t'ia lëshuar nga burgu vëllain me grua dhe fëmijë. I thashë se këtu s'mund të ndërhyjë askush. Kanë hyrë ilegalisht dhe do t'i lëshojnë ose do t'i mbajnë sipas ligjeve të tyre. Shfryu nga mllefi dhe pafuqia. Një natë më herët nga Kosova ishin nisur dhjetë autobusë me shqiptarë që mësynë udhën me plot të papritura, drejt një

jete më të mirë. Edhe mbrëmjen e ditës së paraqitjes së biznes-planeve, ndodhi po e njëjta gjë. E thënë shkurt – tmerr!

Çka t'u thuhet atyre që kanë marrë e po marrin ende atë rrugë. Rrini këtu! Po. Por, pasi t'u thuhet të rrinë, duhet t'u thuhet edhe diçka më shumë. Dhe të punohet shumë më shumë, që atyre t'u hapet perspektivë në këtë vend. E për këtë duhen hapa konkretë. Plana konkrete. Qytetari ta ndjejë dorën e pushtetit që i siguron jetë më të mirë. I gjen një vend pune. I ofron një sistem

të mirë shëndetësor. I thotë se në këtë shtet më askush nuk do të guxojë ta vjedhë paranë e qytetarit. Aty atij i dhemb më së shumti – pse dikush pasuri pa fund e dikush asgjë.

Mbi të gjitha – ia hap horizontin e shpresës, derën e besimit që atij i është lëkundur.

E shpresa është te të rinjtë, te idetë e tyre për të siguruar të ardhmen e tyre KËTU dhe për ta ndërtuar shtetin e mirë që e duam të gjithë.

Florian Piraj, Perparim Salihu, Mimoza Braha, Njazi

Shehu, Uran Çabra, Pajtim Shala, Shpend Zhuja, Leutrim Sopjani, Daut Ibrahim, Faton Latifi, Teuta Dervishi, Armira Fetoshi, Palush Doda, Kaltrina Mehmeti, Erza Mehmeti, Marigona Xhemajli, Dina Demiri, Fatbardha Pacolli, Donika Ismaili, Anesa Hoxha. Këta emra, nga mbi 200 studentë sa morën pjesë në hartimin e biznes-planeve në garën e UBT-së, JANË SHPRESA. Janë 200 emra, dhjetëra ide dhe plane për biznese të reja. Për një jetë më të mirë për të gjithë. Për një shtet të më mirë, siç e duam të gjithë.

Këta vetëm në UBT. E të tillë ka edhe në institucione të tjera.

Ata janë heronjtë tanë sot. Të rinjtë që, në vend të një bilete për udhën e panjohur, zgjedhin të studiojnë, të hulumtojnë e të gjejnë ide e rrugë për të jetuar KËTU, me gjithë vështirësitë që sot i ka JETA KËTU.

Veçse, këta të rinj duan ndihmën e dorës sonë për të bërë realitet idetë e tyre të pafunda. T'ua japim atë. Për të mirën e të gjithë neve.

Është e qartë që rruga që kanë zgjedhur ata për të punuar këtu, për të vënë në jetë idetë e tyre është shumë e rëndë dhe kërkon shumë mund e sakrificë. Por, gjithsesi, jep rezultatet e veta. E rruga e ikjes? Çka sjell ajo...?

BIZNES-PLANI "GLASSRECYCLING" U SHPALL MË I MIRI MË GARËN E 40 BIZNES-PLANEVE NË UBT

RICIKLIMI I QELQIT, NJË INVESTIM SHUMËPROFITABIL NË KOSOVË

Studentët e UBT-së, Florian Piraj, Njazi Shehu, Përparim Salihu e Uran Çabra, të gjithë në vitin e tretë në drejtimin Menaxhimi i Mekatronikës, si dhe Mimoza Braha, në vitin e tretë në Menaxhiment, Biznes dhe Ekonomi, zunë vendin e parë në garën e organizuar në kuadër të Projektit për Ndërmarrësi të përkrahur nga Ambasada e SHBA në Prishtinë. Biznes-plani i emërtuar "GlassRecycling" shpall idenë për krijimin e një kompanie prodhuese dhe ricikluesetë ambalazheve të pijeve, ushqimit, farmaceutike dhe kozmetike.

Florian Piraj, në emër të anëtarëve të grupit, flet për projektin.

UBT News: Ju keni zënë vendin e parë me biznes-planin e emërtuar "GlassRecycling". Si lindi ideja për këtë temë dhe kush ishin anëtarët e tjerë të grupit?

Piraj: Ne jemi zgjedhur si biznes-plani më i miri në mesin e më se 40 punimeve, një konkurrencë e denjë nga të gjithë studentët, që nuk e bëri të lehtë fitoren tonë. Kompania "GlassRecycling" është kompani prodhuese dhe ricikluese e ambalazheve të pijeve, ushqimit, farmaceutike dhe kozmetike. Ideja e këtij biznes-plani na lindi duke i parë rrethanat në të cilat po jetojmë në Kosovë dhe sfidat ekologjike dhe shëndetësore që po kalon bota si pasojë e papastërtisë, rrezikimit të shëndetit, dhe një jete me një ambient jo të pastër. Prandaj, duke e marrë qelqin si bazë, i cili është 100% ekologjik dhe nuk e dëmton ambientin, ruan shëndetin e njerëzve në krahasim me dëmet që shkakton plastika dhe riciklohet 100 për qind.

Biznes plani "GlassRecycling" paraqet krijimin e një biznesi me karakter prodhues dhe riciklues dhe kjo paraqet dy nga pikat kryesore për të cilën jemi fokusuar. Kosova ka nevojë për një rritje ekonomike, për shkak të papunësisë së madhe, kështu që Kompania "GlassRecycling" paraqet një mundësi për punësimin e njerëzve brenda Kosovës, ndërsa mundëson ruajtjen e ambientit dhe krijimin e kushteve për një jetë sa më të shëndetshme, gjë që është një prej gjërave primare në botën perëndimore, që po lufton me gjërat negative të cilat po e dëmtojnë ambientin dhe shëndetin e njerëzve.

UBT News: Cilët faktorë ndikuan në përzgjedhjen e temës?

Piraj: Faktorët që kanë ndikuar që të orientohemi në një biznes të tillë prodhues dhe riciklues përfshijnë dy pika kryesore: Në pikën e parë jemi fokusuar me



Projekti i ndërtimit dhe funksionimit të Fabrikës për prodhimin dhe riciklimin e ambalazheve të qelqit "GlassRecycling", sipas rezultateve preliminare të cilin e kemi përlogaritur, del të jetë 2,500,000 €, që në vete përfshin ndërtimin e fabrikës me 6000m2 sipërfaqe, me 22 të punësuar dhe me një kapacitet prodhues vjetor me më shumë se 10 milionë produkte

ndërmarrje për të cilat ka nevojë Kosova, d.m.th. ndërmarrje prodhuese e më pak ndërmarrje shërbyese për arsye të gjendjes ekonomike dhe papunësisë së madhe në të cilën gjendet Kosova. Andaj kemi për detyrë që me këto projekte të gjenerojmë vende të reja të punës. Pika e dytë në të cilën jemi orientuar është ruajtja e ambientit dhe ruajtja e shëndetit të njerëzve, gjë që po synohet në maksimum të arrihet në vendet perëndimore të zhvilluara. Gjithashtu sfidën e bizneseve kosovare dhe në përgjithësi të vendeve të Ballkanit për eksportimin e produkteve të tyre jashtë Ballkanit, për arsye të mosplotësisë të standardeve të produkteve të tyre për ruajtjen e cilësisë së produkteve, ruajtjen e ushqimit, ruajtjen e shëndetit të popullatës dhe ruajtjen e ambientit.

UBT News: A mund të na jepni sa më shumë detaje rreth përmbajtjes së biznes-planit dhe si ekeniplanifikuar ju realizimin në praktikë të idesë suaj?

Piraj: Prodhimtaria kosovare po e kalon një periudhë të rëndësishme recesioni apo ngritje nga një fazë dëmtuese dhe kjo fazë po parashihet të jetë e ndritur. Andaj, duke parë këtë simulim të prodhimit në Kosovë dhe nevojën që ka Kosova për produkte vendore dhe në përputhje me kërkesat vendore, lindi ideja për krijimin e kompanisë "Recycleglass" e cila bën riciklimin e mbetjeve të qelqit, zakonisht ambalazheve (shisheve) të pijes, ushqimit, farmaceutike dhe kozmetike, si dhe prodhimin e tyre.

Kompania "GlassRecycling" është kompani prodhuese e produkteve të qelqit (shishe të formave dhe madhësive të ndryshme për pije, farmaceutike dhe kozmetike ashtu edhe e kava-

nozave me forma edhe madhësi të ndryshme) dhe ricikluese e mbetjeve të qelqit (ambalazheve të pijeve, ushqimit, farmaceutike dhe kozmetike).

Qëllimi afatgjatë i kompanisë "GlassRecycling", si kompani e vetme e këtij lloji në vend dhe në rajon, është që të mbulojë kërkesën gjithnjë e më të shtuar të ambalazheve nga qelqi, eliminimi në maksimum i importit dhe ofrimi i produkteve adekuate, të nevojshme dhe specifike, në varësi nga dëshirat e konsumatorëve.

Krijimi i vetëdijes qytetare për ruajtjen e shëndetit dhe të ambientit nga përdorimi i këtyre produkteve, si dhe riciklimi i këtyre produkteve gjithashtu nga ana qytetare duke iu kthyer me përfitime materiale është një nga qëllimet kryesore të kompanisë "GlassRecycling".

Kompania "GlassRecycling" është kompani start-up dhe ideja e krijimit të kompanisë në vetvete përfshin tri arsye kryesore:

1. Arsyeja ekonomike: Nëse nisemi nga aspekti ekonomik, atëherë marrim parasysh faktin se në Kosovë nuk ka kompani as ricikluese e as prodhuese të këtyre produkteve, dhe se të gjitha ato kompani të cilat i përdorin këto ambalazhe nga qelqi i importojnë kryesisht nga Greqia dhe Bullgaria, duke hasur në vështirësi (barriera) të shumta si politike ashtu edhe ekonomike gjatë importit të tyre dhe kostove të shtuara të këtyre produkteve kur ato importohen nga këto shtete. Gjithashtu edhe shtetet e rajonit si Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Kroacia e Bosnja e Hercegovina nuk kanë kompani prodhuese të këtyre llojeve të produkteve dhe gjithashtu i kanë probleme pothuajse të tilla gjatë

importit të këtyre produkteve dhe numrin në rritje të përdorimit të këtyre produkteve.

Këto janë vetëm disa nga arsyet ekonomike pse duhet të krijohet kompania "GlassRecycling", duke e mbuluar një treg me një popullsi rreth 25 milionë banorë.

2. Arsyeja shëndetësore: Qelqi është material 100 për qind i ricikluar dhe të mirat që konsumatorët i kanë nga konsumimi i produkteve që si ambalazh përdorin qelqin janë të shumta. Nëse e bëjmë një krahasim të drejtpërdrejtë me produktet e plastikës, nga ana shëndetësore, qelqi ka këto përparësi:

a. Qelqi minimalisht toksik, kurse plastika kap një përqindje të madhe të helmimit të produkteve në të cilat përdoret si ambalazh.

b. Shija e produkteve në të cilat përdoret si ambalazh qelqi e ruan shijen origjinale të atyre produkteve për një kohë shumë më të gjatë sesa ambalazhi i plastikës.

c. Ruajtja dhe mbyllja e ambalazheve nga qelqi është më shumë më e mirë dhe më e sigurt sesa ambalazhet e plastikës.

3. Arsyeja ambientale: Një ndër brengat kryesore të dy shekujve të fundit është çështja ambientale dhe veprimet që po ndërmerren për eliminimin e produkteve të padegradueshme dhe futjen në përdorime produkteve bio, të cilat mund të riciklohen dhe të mos e dëmtojnë ambientin është primare, prandaj qelqi është material 100 për qind i riciklueshëm dhe tërësisht i padëmshëm për ambientin dhe degradimin e tij në ambient.

UBT News: Sa do të kushtojë zbatimi në praktikë i këtij plani

dhe a jeni optimistë se kjo mund të bëhet?

Piraj: Projekti i ndërtimit dhe funksionimit të Fabrikës për prodhimin dhe riciklimin e ambalazheve të qelqit "GlassRecycling", sipas rezultateve preliminare të cilin e kemi përlogaritur, del të jetë 2,500,000 €, që në vete përfshin ndërtimin e fabrikës me 6000m2 sipërfaqe, me 22 të punësuar dhe me një kapacitet prodhues vjetor me më shumë se 10 milionë produkte.

Pasi që kostoja e implementimit të projektit është shumë e konsiderueshme e të hollave, duhet të shqyrtohet ndërmjet ekspertëve të ekonomisë, atyre të inxhinierisë dhe kimistëve, të cilët e njohin fushën e prodhimit të qelqit, për të arritur deri në konstatimin përfundimtar se a ia vlen dhe se në çfarë momenti kohor duhet të investohet për realizimin e kësaj fabrike.

Pasi që ne kemi menduar që këtë kompani ta hapim me investime të marra nga investitorë, atëherë jam shumë optimist se në Kosovë ka investitorë apo biznesmenë që mund të investojnë në këtë projekt afatgjatë.

UBT News: Cila është arsyeshmëria e zbatimit të këtij projekti?

Piraj: Arsyeshmëria e zbatimit të këtij projekti është primare për bizneset kosovare dhe të rajonit, të cilat i përdorin ambalazhet e qelqit për të i ruajtur produktet e tyre. Duhet cekur se në Ballkan (Evropën Jugore) ekzistojnë vetëm dy fabrika të cilat bëjnë këto lloje të prodhimeve, njëra është në Greqi dhe tjetra në Bullgari. Me funksionimin e kësaj fabrike, tregu në të cilin do të operojë është me një popullsi me mbi 25 milionë banorë, dhe duke marrë parasysh numrin e produkteve që një njeri përdor brenda një viti, atëherë del se kompania "GlassRecycling", nëse synon 15-20% të tregut të përgjithshëm të Evropës Jugore, atëherë do t'i përmbushë pritjet e parapara për afatin 3 vjeçar të funksionimit.

UBT News: A mund të shtoni ndonjë detaj që është i rëndësishëm për projektin apo procesin e hartimit të tij.

Piraj: Hartimi i një biznes plani është shumë i rëndësishëm dhe duhet të bëhet në mënyrë të veçantë, në mënyrë që kur t'i ofrohet investitorëve t'i bindë ata për investime të mundshme në atë biznes-plan. Prandaj, edhe ne biznes-planin tonë kemi synuar që ta ndërtojmë me një gjuhë sa më të thjeshtë dhe me të kuptueshme, por duke ofruar sa më shumë fakte reale për biznesin në fjalë dhe mundësitë që do të na ofronte realizimi i këtij projekti.

BIZNES-PLANI "PROBIKE" ZURI VENDIN E DYTË NË GARËN E BIZNES-PLANEVE NË TË MIRA

NJË KOMPANI BIÇIKLETASH PËR PRISHTINËN - IDE E STUDENTËVE TË UBT-së

"Për realizimin e këtij plan biznesi jemi bazuar në planin urbanistik të komunës së Prishtinës. Mendojmë se do të kemi mbështetje të plotë nga ana e tyre, sepse një ndër qëllimet tona për krijimin e këtij biznesi është mbrojtja e ambientit. Gjithashtu, qëllim tjetër është edhe krijimi i një kulture „sportive“ përmes ngasjes së biçikletave nga të gjitha grup-moshat mbi 16 vjet (qofshin ata të rritur apo të moshuar)", thotë Teuta Dervishi

Biznes-planin "ProBike", i punuar nga studentët Teuta Dervishi, Armira Fetoshi, Palush-Doda, Kaltrina Mehmeti dhe Erza Mehmeti, në garën e organizuar në kuadër të Projektit për Ndërmarrësi të përkrahur nga Ambasada e SHBA në Prishtinë, u vlerësua me vendin e dytë.

Të gjithë anëtarët e grupit janë në përfundim të studimeve, pra në fund të vitit të tretë në MBE.

Teuta Dervishi, pjesë e grupit që realizoi biznes-planin shpjegon për "UBT News" rrjedhën e përgatitjes së këtij biznes-planin nga ideja deri në realizimin final.

UBT News: Ju keni zënë vendin e dytë me biznes-planin e emërtuar "ProBike". Si lindi ideja për këtë temë dhe kush ishin anëtarët e tjerë të grupit?

Dervishi: Së pari motoja e biznesit është "Ride and be HEALTHY". Ideja ka lindur si rrjedhojë e mungesës së këtij lloji shërbimi në kryeqytet dhe pritjet që të plotësojë kërkesat dhe nevojat e tregut dhe të shoqërisë për lehtësim në komunikacion dhe për një lëvizje më eficiente. Me një plan të detajizuar dhe me hulumtimin e bërë deri tani, e shohim se qëllimi ynë është më se i realizueshëm në Prishtinë.

Për realizimin e këtij plan biznesi jemi bazuar në planin urbanistik të komunës së Prishtinës. Mendojmë se do të kemi mbështetje të plotë nga ana e tyre, sepse një ndër qëllimet tona për krijimin e këtij biznesi është mbrojtja e ambientit. Gjithashtu, qëllim tjetër është edhe krijimi i një kulture „sportive“ përmes ngasjes së biçikle-



Autorët e biznesit planit që u nderuan me vendin e dytë

tave nga të gjitha grup-moshat mbi 16 vjet (qofshin ata të rritur apo të moshuar).

UBT News: Cilët faktorë ndikuan në përzgjedhjen e temës?

Dervishi: Deri tek ideja e këtij biznesi kemi ardhur duke u bazuar në përvojat tona të përditshme jo të mira në komunikacionin e dendur. Kjo ide bazohet edhe në planin urbanistik të komunës për ndërtimin e shtigjeve për biçikleta. Ky biznes është start-up, i cili parashihet të jetë biznes funksional dhe i vetmi i këtij lloji në Kosovë. Veprimtaria e tillë parashikohet të jetë profitabile dhe me impakt pozitiv në shoqëri pasi që konsiderohet si një aktivitet atraktiv.

UBT News: A mund të na jepni sa më shumë detaje rreth përmbajtjes së biznes-planit dhe si e keni planifikuar ju realizimin në praktikë të idesë suaj?

Dervishi: Ideja e projektit është zhvillimi i një start-up, i cili është i destinuar të jetë biznes shërbyes. Ky lloji shërbimi ekziston në tregun global, mirëpo në Kosovë është shërbim inovativ dhe i përcaktuar deri më tani. Karakteristika e këtij shërbimi qëndron tek pajisja e biçikletave me GPS, në mënyrë që të parandalohet keqpërdorimi i mundshëm i tyre, dhe tek dizajni i biçikletave (ngjyra) që i dallon ato sipas lokacioneve të caktuara. Biçikletat karakteri-

zohen me tipare unike të dizajnit. Mënyra e shfrytëzimit të këtij shërbimi është shumë e thjeshtë. Biçikleta merret me qira nga konsumatori në lokacionin më të afërt të tij dhe shfrytëzohet nga ai varësisht sipas nevojës, dhe në fund biçikleta dorëzohet në lokacionin më të afërt të tij (nuk është e domosdoshme të kthehet në lokacionin që është marrë). Konsumatori i cili e merr për shfrytëzim biçikletën, duhet të regjistrohet (skenojë dokumentin identifikues të tij) në aparatit e identifikimit, sa herë që e merr dhe e dorëzon biçikletën.

Lokacioni për zhvillimin e këtij biznesi do të përfshijë disa pika të kryeqytetit: Bregu i Diellit II (Banesat e Bardha), Lagjja e Spitalit (Rruga e re), Dardani (Bill Kintoni), Pallati i Rinisë dhe Komuna e Prishtinës.

Pasi që intensiteti i rivalitetit të konkurrencës është i ulët, kjo bën që mundësia për fitim të jetë e lartë. Trendi potencial i rritjes është i lartë dhe pritjet që kërkesa për këtë shërbim të jetë e madhe sepse popullsia e Kosovës karakterizohet kryesisht me moshë të re (rreth 65 për qind). Trendet e rritjes ekonomike që do të ndiqen nga treguesit më të lartë të punësimit dhe ndryshimet shoqërore ekonomike, do të rrisin kërkesën për shërbime të tilla. Si rezultat kërkesa për përdorimin e biçikletave do të jetë më e lartë. Kjo rritje konsiston edhe me faktin e vetëdijesimit të njerëzve për shfrytëzimin e biçikletave, duke marrë parasysh

ndikimet pozitive në ambient, shëndet dhe buxhet individual.

Shërbimi jonë është i përshatshëm për shkak të vlerës së diferencuar që ofron në treg, për tri arsye kryesore: Shmangia e trafikut të mbingarkuar urban; Mbrojtja e ambientit; Eficiencë në kryerjen e punëve.

Mosha 16-65 vjeç është mosha e cila përfshin pjesën më të madhe të tregut të synuar. Arsyja e përdorimit: Individët më së shumti mund të përdorin biçikletën për punë, për sport dhe për argëtim. Për ofrimin e këtij shërbimi ekzistojnë disa kushte që duhet plotësuar për të arritur shërbimin përfundimtar. Si inpute llogariten furnizimi (blerja) me biçikleta, GPS, aparatura për pagesë dhe skanimin e dokumenteve identifikuese, hapësira për raftin e biçikletave dhe për zyrën kryesore, rrjeti i sigurisë, pajisje dhe produkte për mirëmbajtje dhe fuqia punëtore. Në secilin lokacion do të ketë nga 50 biçikleta, ku gjithsej do të jenë 250 biçikleta në 5 lokacione.

UBT News: Sa do të kushtojë zbatimi në praktikë i këtij plani dhe a jeni optimistë se kjo mund të bëhet?

Dervishi: Investimet fillestare për realizimin e këtij biznesi plani në praktikë arrijnë në vlerë 26,500 euro, ndërsa ProCreditBank do të jetë sponsor për blerjen e biçikletave në vlerë prej 62,500 Euro, dhe çdo lokacion do të ketë biçikletat me një ngjyrë nga logoja e ProCredit Bankës.

UBT News: Cila është arsyeshmëria e zbatimit të këtij projekti?

Dervishi: Duke marrë parasysh mungesën e këtij lloji të shërbimit në Prishtinë, arsyeshmëria e zbatimit të këtij projekti është lehtësimi i komunikacionit dhe qarkullimi më i lehtë i qytetarëve nëpër destinacione të ndryshme të Prishtinës. Rezultat më i madh i kësaj është zvogëlimi i numrit të automjeteve në komunikacion dhe ndikon drejtpërdrejtë në mbrojtjen e ambientit dhe krijimin e një kulture "sportive" për qytetarët. Prandaj ne jemi shumë optimistë në lidhje me realizimin e këtij biznes-planit dhe besojmë fuqishëm se do të kemi sukses në zhvillimin e këtij shërbimi në kryeqytet.



BIZNES-PLANI "BIOSHOP" I TRETË NË GARËN PËR BIZNES-PLANE NË UBT

USHQIMET ORGANIKE - E ARDHMJA E INDUSTRIISË USHQIMORE NË KOSOVË

Biznes-plani "BioShop", i punuar nga studentët e vitit të tretë në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Dina Demiri, Marigona Xhemajli, Donika Ismaili, Fatbardha Pacolli dhe Anesa Hoxha, zuri vendin e tretë në garën e organizuar në kuadër të Projektit për Ndërmarrësi të përkrahur nga Ambasada e SHBA në Prishtinë.

Marigona Xhemajli, në emër të anëtarëve të grupit, flet për "UBT News" për rrjedhën e përgatitjes së këtij biznes-plani, të vlerësuar në mesin e mbi 40 planeve, në të cilat ishin të angazhuar rreth 200 studentë të UBT-së.

UBT News: Ju kenizënë vendin e tretë me biznes-planin e emërtuar "BioShop". Si lindi ideja për këtë temë dhe kush ishin anëtarët e tjerë të grupit?

Xhemajli: "BioShop" synon të jetë një kompani që do të merret me shitjen e ushqimeve organike. Ideja për këtë biznes-plan është e bazuar në një ngjarje të pikëllueshme. Familjarja e njëjës prej anëtarëve të grupit, vite më parë, është prekur nga sëmundja e kancerit, dhe, në mënyrë që sot të mos rrezikohet përsëri nga kjo sëmundje, ushqehet me produktet që kjo kompani synon t'i shesë.

UBT News: Cilët faktorë ndikuan në përzgjedhjen e temës?

Xhemajli: Arsyeja kryesore se pse pikërisht kjo temë është zgjedhur përball alternativave të tjera është për shkak seçdo ditë e më shumë ne përballlemi me sfida dhe sëmundje të ndryshme që na ofron jeta, për të cilat ende nuk është gjetur shërim. Mirëpo, fatmirësisht ekzistojnë disa mënyra për t'i parandaluar apo luftuar ato me anë të ushqimit organik. Gjithashtu, shumë individë kanë pasion jetën e shëndetshme, mirëpo e kanë të pamundur që t'i gjejnë këto produkte në Kosovë, andaj detyrohen të vizitojnë vendet fqinje si Maqedonia apo Serbia për t'u pajisur me këto produkte. Arsye tjetër është se ndoshta edhe bujqit kosovarë do të motivohen dhe do të fillojnë të mbjellin ushqime organike vendore. Në këtë mënyrë, përveç që njerëzit do të kishin shëndet të mirë, gjithashtu edhe toka e planeti do të mbroheshin nga kemikale, pesticidet dhe gjërat artificiale që po e shkatërrojnë.

UBT News: A mund të na jepni sa më shumë detaje rreth përmbajtjes së biznes-planit dhe si e keni planifikuar ju realizimin në praktikë të idesë suaj?

Xhemajli: Gjatë hulumtimit të bërë kemi vërejtur se tregu i Kosovës ballafaqohet me mungesë të ushqimit organik, ku kërkesa për këto produkte është shumë e lartë. Andaj biznesi "BioShop" do të jetë biznes i llojit ndërmarrje tregtare, që do të ofrojë për klientët e saj ushqime të llojllojshme organike, të cilat janë të shëndetshme. Këto produkte do të importohen nga vende e rajonit. Biznesi do të jetë biznes i vogël, me një pronar, i cili do të gjendet në Prishtinë.



"BioShop" synon të jetë një kompani që do të merret me shitjen e ushqimeve organike. Ideja për këtë biznes-plan është e bazuar në një ngjarje të pikëllueshme. Familjarja e njëjës prej anëtarëve të grupit, vite më parë, është prekur nga sëmundja e kancerit, dhe, në mënyrë që sot të mos rrezikohet përsëri nga kjo sëmundje, ushqehet me produktet që kjo kompani synon t'i shesë.

Vizioni i kompanisë është: Të jetë lider në mbështetjen e jetesës së shëndetshme përmes sigurimit të cilësisë së lartë të produkteve organike dhe eko-miqësore. Produktet e kompanisë përfshijnë ushqime të shumëllojshme organike, duke filluar nga erëza të ndryshme për ushqime e deri tek gjellërat. Fillimisht biznesi planifikon të startojë me një numër të limituar produktesh ku përfshihen: Meli, Lente, Orizi integral, Fasulet e zeza, Fasulet e kuqe, Fasulet Mungo, Helda, Kuinoa, Makarona të thekrës, Makarona nga soja dhe hithra dhe Kurkumi.

Megjithëse mund të duken abstrakte në emër, benefitet që përcillen në trupin tonë falë këtyre ushqimeve janë të panumërta, për arsye se: rrisin energjinë, ndihmojnë në dobësim, janë antibiotik natyralë, ndihmojnë të pamurit, sistemin e tretjes dhe funksionimin e trurit, janë të pasur me minerale e vitamina, janë ilaç natyror kundër plakjes dhe depresionit dhe, çka është më e rëndësishmja ndihmojnë në parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve prej atyre të pashërueshme si: kanceri, HIV, Alzheimeri, diabeti, sëmundjet kardiace etj. Natyrisht për t'u parë se a kemi shanse për të operuar në tregun kosovar, ne kemi realizuar disa analiza të tregut ku përfshihen analiza e industrisë, analiza e konkurrencës dhe analiza e konsumatorëve.

Sa i përket analizës së industrisë, modeli që kemi përdorur për të bërë hulumtimin është PEST analiza (analiza e faktorëve politikë, ekonomikë, socialë dhe teknologjikë), ku edhe kemi ardhur në këto konkludime:

P(Politike) - Vendi ynë karakterizohet me një politikë jostabile dhe nuk ka mundësi që të ndihmojë biznesin tonë në minimizimin e tatimit mbi vlerën e shtuar apo

atij në fitim. Sa i përket tregimit të produkteve organike, kemi përparësi pasi që jemi pjesë e marrëveshjes CEFTA-së dhe bëjmë tregti të lirë me vendet anëtare, pra nuk ngarkohemi me taksa doganore. E(Ekonomike) - Niveli i papunësisë i lartë në Kosovë, mund të ndikojë që konsumatorët të blejnë produkte më të lira, apo edhe në fazat e inflacionit ndodh e njëjta. Normat e larta të interesit në marrjen e kredive ndikojnë negativisht dhe gjithashtu edhe politikat ekonomike ndikojnë tek furnitorët që të mbajnë çmimet e larta gjatë furnizimit të biznesit me produkte organike.

S (Sociale) - Vite më parë popullsia e Kosovës ishte e koncentruar në zona rurale, kurse tani pothuajse çdo qytet është i urbanizuar në mënyrë të vet dhe ka më shumë popullsi. Me rritjen e popullsisë së bashku rriten edhe kërkesat e tyre. Kultura shqiptare sa i përket ushqimit është shumë e hapur dhe e pasionuar pas ushqimeve tradicionale siç janë: fasulet dhe gjellërat e ndryshme. Përveç kësaj, Kosova kategorizohet me popullatë më të madhe të moshës së re, ku trendi i të qenit "fit" ka depërtuar edhe në mendjet e tyre.

T (Teknologjike) - Teknologjia është duke ndryshuar çdo minutë dhe po na bënë jetën më të lehtë në

çdo aspekt. Shkalla e inovacionit është shumë e lartë. Falë këtij zhvillimi teknologjik, me anë të marketingut, shitjeve online apo rrjeteve sociale ne mundemi shumë shpejt dhe lehtë të depërtojmë në nivel kombëtar dhe global.

Sa i përket konkurrencës në tregun nacional nuk do të ballafaqohemi me konkurrentë pasi që "BioShop" do të jetë i pari në Kosovë sa i përket shitjes të ushqimeve organike. Rreziku i vetëm i konkurrencës që kemi vjen nga vendet e tjera të Ballkanit, siç janë Serbia, Maqedonia, Shqipëria, ku konsumatorët prej Kosovës shkojnë enkas për të blerë këto produkte në këto shtete. Anët e forta të konkurrentëve janë se kanë llojllojshmëri të produkteve, ofrojnë çmime të volitshme dhe janë veç biznese ekzistuese. Ndërsa anët e dobëta janë se gjenden jashtë shtetit, udhëtimi për të arritur deri aty krijon kosto të lartë dhe jo të gjithë të interesuarit mund të kenë qasje në këto produkte.

Andaj, si rezultat i kësaj, ne i kemi ndarë konsumatorët në tre targete grupe, ku targeti i parë janë konsumatorët me probleme shëndetësore, targeti i dytë konsumatorët e thjeshtë, dhe i treti, konsumatorët vegjetarianë.

Pra, si konkluzion, të ushqyerit me ushqim organik është një prej

prioriteteve që secili person duhet ta ketë në jetë për shkak se me anë të tyre individët do të jenë në gjendje të jetojnë një jetë pozitive dhe të shëndetshme. Gjithashtu, një kontribut i madh do të ishte edhe për planetin Tokë, për shkak se do të bëhet mbrojtja e tij duke mos përdorur gjëra artificiale për t'i mbjellë këto produkte.

UBT News: Sa do të kushtojë zbatimi në praktikë i këtij plani dhe a jeni optimistë se kjo mund të bëhet?

Xhemajli: Në bazë të analizave që i kemi bërë gjatë përpilimit të biznes-planit, ne kemi ardhur në përfundim se kostoja fillestare për fillim të biznesit përfshin shumën rreth 15,000.00 euro. Jemishumë optimistë se një ditë kjo mund të realizohet për shkak se kosovarët tashmë kanë filluar të adaptohen me stilet përëndimore të jetuarit dhe nevoja për këtë lloj të ushqimit do të jetë në rritje çdo ditë e më shumë.

UBT News: Cila është arsyeshmëria e zbatimit të këtij projekti?

Xhemajli: Industria e ushqimeve organike tek ne nuk është aspak e zhvilluar. Me këtë nënkuptojmë që nuk ekzistojnë kompani të cilat ofrojnë këtë lloj të produkteve. Edhe pse hipermarketet tek ne tentojnë që në stoqet e tyre të kenë ushqime organike/integrale të importuara, kryesisht makaronat, buka, drithërat, qumështi i sojës, ato nuk i afrohen standardeve të vërteta të ushqimeve BIO organike dhe janë shumë të pakta në numër. Si rezultat i kësaj ndikimi i tyre në qarkullimin vjetor financiar pothuajse nuk vërehet. Megjithatë, kjo lloj industrie ka shumë potencial të rritet, për shkak se çdo vit kemi shtim të popullsisë, dhe çdo ditë e më shumë jemi duke luftuar me sëmundje të shumta, andaj kërkesa për këto produkte do të fillojë të rritet shumë në një të ardhme të afërme.

UBT News: A mund të shtoni ndonjë detaj që është i rëndësishëm për projektin apo procesin e hartimit të tij?

Xhemajli: Plani i kompanisë është të fillojë biznesin me strategjinë e diferencimit, duke sjellë produkte unike në treg që nuk janë sjellë nga kompanitë ekzistuese. Ky fakt na bën të jemi liderë dhe të parët sa i përket importimit dhe shitjes së ushqimeve organike.

Me anë të kësaj strategjie neve na mundësohet që të synojmë disa grupe në treg, në mënyrë të njëkohshme. Falë kësaj ne arrijmë të krijojmë konsumatorë lojalë, të cilët, edhe nëse në treg hyjnë konkurrentët me produkte të njëjta apo të ngjashme, nuk do të na ndërrojnë për ta.



NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

UBT NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN PËR TEKNOLOGJI DHE EKONOMI TË BUDAPESTIT

Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi ka qëndruar në Budapest të Hungarisë. Me këtë rast ai ka vizituar Universitetin për Teknologji dhe Ekonomi. Ai ka diskutuar me Rektorin e këtij universiteti, Prof. Dr. GáborPéceli, për një varg çështjesh me interes për të dyja palët. Gjithashtu, ai ka prezantuar punën që bëhet në UBT, ndërsa ka folur me theks të veçantë për bashkëpunimet ndërkombëtare, fushë në të cilën UBT është institucion prijatar jo vetëm në Republikën e Kosovës, por edhe në rajon dhe më gjerë.

Me këtë rast, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit mes UBT-së dhe Universitetit për Teknologji dhe Ekonomi të Budapestit, që përfshin një varg fushash me interes si për studentët ashtu edhe për stafin pedagogjik të të dy universiteteve.

Universiteti për Teknologji dhe Ekonomi i Budapestit është i themeluar në vitin 1782 dhe është një ndër universitetet më të mëdha e më të njohura në Hungari.



NË UNIVERSITETIN E VJENËS


REKTORI HAJRIZI NË PUNËTORINË PËR KRIJIMIN E NJË RRJETI STRATEGJIK NË KUADËR ERASMUS PLUS

Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi mori pjesë në punëtorinë për krijimin e një rrjeti strategjik në kuadër të projektit evropian Erasmus Plus, që u mbajt në Universitetin e Vjenës.

Erasmus është një nga shumë programet të cilat UBT i ofron në Kosovë dhe në rajon dhe nga të cilat përfitojnë një numër i madh studentësh të UBT-së.

Në këtë takim ishin përfaqësuesit nga Universitetet nga Konstanca, Antwerpi, Lyoni, Pavia, Vjena dhe Salzburgu, ndërsa rektori i UBT-së, Hajrizi ishte përfaqësuesi i vetëm nga rajoni i Ballkanit.

SYRI



KALENDARI I VIZITAVE STUDIMORE TË STUDENTËVE TË UBT-SË

STUDENTËT E DREJTËSISË DHE TË SHKENCAVE POLITIKE VIZITUAN ZYRAT E FES

UBT së bashku me Friedrich Ebert Stiftung kanë organizuar këtë vit dhe akademinë rajonale verore, bashkëpunim i cili ka rezultuar i suksesshëm dhe pritet të shoqërohet dhe nga aktivitete të tjera të karakterit kombëtar dhe ndërkombëtar

Kalendari i vizitave studimore të studentëve të UBT-së, konsiston në vizita studimore në institucione, organizata të ndryshme ndërkombëtare, fondacione etj, veprimtaria e të cilave lidhet drejtpërdrejt me fushën e tyre të studimeve.

Në kuadër të eventeve të planifikuara, më 23 dhjetor studentët e Fakultetit të Drejtësisë dhe Fakultetit të Shkencave Politike në UBT vizituan zyrat e Friedrich Ebert Stiftung në Prishtinë.

Studentët e UBT u njohën nga afër me aktivitetin e FES në Gjermani dhe specifikisht aktivitetin e FES në Kosovë.

Stafi i FES prezantuan specifikisht fushat e veprimtarisë që mbulojnë në kuadër të FES si dhe mundësitë për angazhime për studentët e UBT-së duke qenë se një ndër fushat e veprimtarisë së tyre është dhe edukimi politik. Në kuadër të edukimit politik, FES në Prishtinë organizon çdo vit dhe akademinë politike e cila është kombinim i edukimit politik dhe trajnimit praktik.

UBT së bashku me Friedrich Ebert Stiftung kanë organizuar këtë vit dhe akademinë rajonale verore, bashkëpunim i cili ka rezultuar i suksesshëm dhe pritet të shoqërohet dhe nga aktivitete të tjera të karakterit kombëtar dhe ndërkombëtar.

SYRI



GARA E BIZNES-PLANEVE E STUDENTËVE

NJË "FAST-FOOD" ME PESHKUN SI USHQIM KRYESOR - IDE E STUDENTËVE TË UBT-SË

Biznes-plani "Fish n' Chips", i punuar nga studentët e vitit të tretë në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Pajtim Shala, FatonLatifi, LeutrimSopjani, Daut Ibrahim dhe Shpend Zhuja zuri vendin e dytë në garën e organizuar në kuadër të Projektit për Ndërmarrësi të përkrahur nga Ambasada e SHBA në Prishtinë.

Në emër të anëtarëve të grupit, Pajtim Shala flet për rrjedhën e përgatitjes së këtij biznes-plani. Ai thotë se ideja ka nisur nga fakti se ai ka punuar në një "Fish n' Chips" në Irland, ndërsa është realizuar duke u nisur nga fakti se në Kosovë mungon një "fastfood" me përbërës kryesor të peshkut.

"Biznes-plani ynë është biznes familjar, nuk kush-ton shumë, si dhe në Prishtinë lehtë mund të gjen-

den punëtorë me përvojë pune si në tigan për zierje, skarë, ashtu edhe picamen. Ne kemi menduar që realizimin e idesë sonë ta praktikojmë duke ftuar miq të shumë të pronarëve. Lokacioni nuk do të jetë në shesh, për shkak se çmimet e qirasë janë shumë të larta, por në rrugën Agim Ramadani", diku nga Teatri Kombëtar e deri te Fakulteti Ekonomik. Në këtë lokacion kemi katër ndërtesa qeveritare, disa kolegje private, si dhe shumë banorë që jetojnë për-reth", thotë Shala.

Zbatimi i këtij plani nuk do të kushtojë më shumë se 15.000 euro dhe ne jemi shumë optimistë se kjo mund të bëhet, pasi që një ushqim i tillë mungon në tregun tonë. Po ashtu çmimet nuk janë të larta, mirëpo janë të arsyeshme për biznesin tonë.



Studentët që punuan biznes-planin "Fish n' Chips"

PUBLIKIME TË REJA TË UBT-SË

NË UBT U PROMOVUAN LIBRI “SHKRIMI DHE KOMUNIKIMI” DHE REVISTA “POLITIKOLOGU”



Një libër dhe një revistë, nismë e mbarë e vitit në UBT

Libri i profesorit Safet Zejnullahu “Shkrimi dhe komunikimi” dhe revista “Politikologu”, dy botime të UBT-së, janë promovuar sot në një ceremoni organizuar në këtë institucion.

Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi ka theksuar synimin e UBT-së në mbështetje dhe promovim të librit universitar për nevojat e studentëve, por edhe për lexuesit e tjerë. Ai e vlerësoi librin e profesorit Zejnullahu si

mjaft të dobishëm dhe të një fushe specifike, që ka njohur zhvillime të bujshme krahas ndryshimeve që ka sjellë zhvillimi i teknologjisë.

Ndërsa revista “Politikologu”, tha ai, është një publikim i veçantë, me autorë dhe tema e analiza të përzgjedhura për fusha e fenomene të ndryshme, prezente në shoqërinë tonë.

Dr.Hajrizi ka përmendur edhe publikimet e shumta që UBT ka

nxjerrë deri tash dhe planin për libra, revista dhe publikime të tjera, që do të shohin dritën së shpejti. Ai gjithashtu theksoi se UBT, krahas librave të autorëve që janë pjesë e UBT-së, do të përkthejë e do të publikojë edhe libra shkencorë profesionalë të autorëve të njohur botërorë.

Autori i librit “Shkrimi dhe komunikimi”, Safet Zejnullahu, në fjalën e tij, ka theksuar një varg çështjesh që ndërlihen me

kulturën e leximit dhe rrezikun real që librit i vjen nga zhvillimi i teknologjisë. Ai tërhoqi vërejtjen se, sado pozitive të jenë përparësitë që ofron interneti në kuptimin e ofrimit të informacionit, të krijimit të idesë së ofrimit të informacionit të plotë, asgjë dhe asnjëherë nuk do ta zëvendësojë librin, qoftë atë të printuar apo atë në formë elektronike. Ai theksoi nevojën për vlerësim real të peshës së librit si burim informacioni, që duhet të rrënjohet me zhvillimin e kul-

turës së leximit, në institucionet shkollore e në familje.

Ndërsa, kryeredaktori i revistës “Politikologu”, Alban Lauka theksoi se revista përmbledh një numër të madh artikujsh të autorëve profesionistë dhe synon të japë kontribut të çmueshëm në zhvillimin e mendimit politik në vend dhe në hapësirat ku flitet shqip.



REKTORI HAJRIZI I FTUAR NË KONFERENCËN “PRIVATËSIA NË EPOKËN DIGJITALE”

Gjithashtu, UBT dhe 6 bursa për “Ambasadorët e Privatësisë”, të cilët janë nxënës nga shkollat e mesme të Kosovës



Në qershor të vitit 2014 UBT ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke i mundësuar kësaj agjencie ofrimin e kadrove të specializuara, projekte hulumtuese dhe zhvilluese në fushën e mbrojtjes të të dhënave personale.

Në kuadër të këtij projekti, është organizuar në datën 27 janar 2015 konferenca “Privatësia në epokën digjitale”, ku rektori i UBT-së, dr. Edmond Hajrizi ka qenë ftuar krahas emrave të shquar nga Google, Facebook, HP etj., ku ka ligjëruar lidhur me “Ngritjen e Kapaciteteve, Dizajnimin dhe Menaxhimin e Sistemeve për Privatësinë dhe Sigurinë”.

Përveç stafit drejtues dhe akademik në këtë konferencë kanë qenë prezentë dhe studentë të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të UBT të cilët kanë marrë pjesë në sesionin “EthicalHacking”.

Në Kosovë, UBT është i vetmi institucion i arsimit të lartë i akredituar në Fushën e Sistemeve të Informacionit në Sigurinë e Informacionit dhe Privatësinë.

Nehat Islami gazetar me një përvojë të gjatë në raportimet e Lindjes së Mesme dhe tani i angazhuar edhe në Këshillin e Mediave të Shkruara ka rrëfyer për përvojën e tij personale si gazetarë dhe ka folur edhe rreth angazhimeve të tija në KMSHK dhe etikës

Nehat Islami, drejtor në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) ka bashkëbiseduar të mërkurën me studentët e medias dhe komunikimit në UBT rreth rolit dhe funksionimit të KMSH me theks të veçantë zbatimi i udhëzuesit dhe kodit të etikës në Kosovë.

Studentët e medias dhe komunikimit në UBT të mërkurën kanë pasur rastin të bashkëbisedojnë dhe njihen me udhëzuesin e Kodit të Këshillit të Mediave të Shkruara dhe zbatimit të këtij udhëzuesi në praktikë nga ana e medieve kosovare.

Nehat Islami gazetar me një përvojë të gjatë në raportimet e Lindjes së Mesme dhe tani i angazhuar edhe në Këshillin e Mediave të Shkruara ka rrëfyer për përvojën e tij personale si gazetarë dhe ka folur edhe rreth angazhimeve të tija në KMSHK dhe etikës.

Islami tha se Kodi i etikës është libër i shenjtë për mediet sepse nëse respektohet ky kod dhe ky udhëzues atëherë gazetarët nuk

FAKULTETI I MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT

NEHAT ISLAMI BASHKËBISEDON ME STUDENTËT E MEDIAS NË UBT



do të kenë probleme në praktikë, as sa i përket raportimeve të tyre gazetareske, dhe as sa i përket problemeve gjyqësore.

Islami tha se KMSHK po luan një rol të madh në vetëdijësimin e medieve për të respektuar etikën dhe për të avancuar gazetarinë profesionale.

“Etika na largon nga problemet juridike, ngatërresat sepse etika na mundëson ta zbulojmë të vërtetën. Mësojeni etikën sepse do ta keni shpirtin rehat gjithmonë në jetën tuaj profesionale” ishte porosia e Islamit.

Edhe, Edmond Hajrizi rektor i UBT-së tha se ndihet i relaksuar kur sheh se në Kosovë megjithatë ka mekanizma që mbrojnë punën e medieve, sikurse ka mekanizma që edhe “sanksionojnë”

mediet kur ato gabojnë në punën e tyre profesionale. “UBT çdo ditë po tregohet më e avancuar sepse para studentëve po ofron gazetarë me përvojë dhe quadro që tërë jetën e tyre ia kanë kushtuar këtij profesioni. UBT po rritet çdo ditë dhe po pranohemi nga ndërkombëtarët në të gjitha sferat. Vlera, cilësia dhe përkushtimi i stafit dhe i vet studentëve janë arma kryesore e UBT-së dhe e suksesit të saj” tha Hajrizi.

Ligjëruesi i lëndës “Etika e medias dhe ligji”, Musa Sabedini tha se udhëzuesi i kodit të etikës është baza e gazetarisë ashtu sikurse është etika dhe zbatimi i saj në praktikë. “Nëse etika zbatohet me korrektësi dhe përgjegjësi profesionale nga të gjitha mediet, gabimet në këtë profesion mund të jenë minimale”.



Departamenti për Trajnime dhe Certifikime në UBT është shumë i angazhuar për të kontribuar në avancimin e shoqërisë kosovare në një shoqëri konkurrense, nëpërmjet trajnimeve tona profesionale, të cekura më poshtë:

Menaxhim

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarrjes së re
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës
- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznisplan
- Menaxhimi i Sistemeve Informativ
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme (MRP)
- Shkathësi negocimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Doganat
- Analiza e Kostove
- Kontabilitet dhe Menaxhim i Financave
- Vendimarrja Financiare
- Institucionet Financiare dhe Tregjet

Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing

- Menaxhimi i Lojalitetit
- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

Shkathësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punët e suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientë
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceseve Këshilluese

Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse

Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konfliktit
- Aqvi Comunnitëre e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathësi Diplomatie
- State Protocol

Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë (Pneumatikë, Elektro-Pneumatikë, E-Teknika / Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAx - Teknologjitë (CAD/CAM, CAQ, CAP dhe CA të tjera)
- CNC-Teknikat
- Robotikë
- Teknika të Punës/ Organizim i Punës
- Mbrojtja e Mjedisit

- Teknika të Sigurisë për mbrojtjen së punëtorëve
- Dokumentimi Teknik
- Saldimi
- Inovimi

Teknologji Informativ

- CISCO
- IT Essencial
- CCNA Discovery 1.2.3.4
- CCNA Exploration 1.2.3.4
- ECDL
- Hardware
- Inxhiniering i Software (Gjuhët programuese dhe Bazat e të Dhënave)
- Rrjetizim
- Simulim i Kompjuterit
- Disenj Kompjuterik dhe Animacion
- Sisteme Aplikative të Ndërmarrjes
- Aplikime të Internetit
- Paketat CAD/CAM
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë (CRM)
- Modelimi, Optimizimi dhe simulimi

Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektim me AUTO CAD, ARCHI CAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontrolli Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Trajnimet profesionale në disiplinat e lartcekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendorë dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superiore dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar një vistër të gjerë trajnimesh për një karrierë personale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

Vërejtje e rëndësishme: Ju lutemi, mos hezitoni të kontaktoni zyrtarin përgjegjës për Trajnime profesionale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, përmes numrit të telefonit 038 541 400.

Kredi për studentë



**Raiffeisen
BANK**

...JETO MË MIRË

Financoni studimet tuaja

- Norma të volitshme interesi
 - 10,000 Euro deri në 5 vjet
 - 0% - shpenzime administrative

www.raiffeisen-kosovo.com
Raiffeisen Direct: 038 222 222

ME NDIHMËN E QENDRËS SË KARRIERËS NË UBT

STUDENTI AGON AHMETI, PJESË E KOMPANISË GJERMANE "BEOSOFTWARE - KOSOVO"

Kjokompani punëson rreth 150 punëtorë, prej të cilëve 15 momentalisht janë të punësuar në Kosovë

Studentët të UBT-së vazhdojnë nga dita në ditë të jenë pjesë e institucioneve dhe kompanive të rëndësishme në vend dhe jashtë saj apo e kompanive ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Njëri prej tyre, studenti Agon Ahmeti është bërë pjesë e kompanisë gjermane "BeoSoftware - Kosovo", me seli në Ferizaj. Kontaktin me këtë kompani ai e ka bërë përmes Qendrës së Karrierës së UBT-së, e cila shërben si mundësi shumë e mirë e prezantimit të UBT-së dhe sidomos e kontakteve të studentëve me kompani të rëndësishme në vendin tonë, si edhe kompanitë ndërkombëtare.

Agoni thotë se në kontakt me kompaninë "BeoSoftware" ka rënë në kontakt, pasi ka marrë

informacionin nga Qendra e Karrierës e UBT-së.

"Pas interesimit tim rreth kompanisë "BeoSoftware", ata më ftuan që të takoj themeluesin e saj, z.Clemens Sexauer. Ai më njoftoi rreth planeve të kompanisë në Kosovë për të hapur fillimisht një degë për testim të softuerit dhe pastaj edhe të asaj për testim të sigurisë (Penetration Testing)", thekson Agoni.

Sipas tij, kjo kompani punëson rreth 150 punëtorë, prej të cilëve 15 momentalisht janë të punësuar në Kosovë.

"Pata rastin edhe t'i vizitohet zyrat qendrore të kompanisë në Endingen në Kaiserstuhl që ishte një mundësi e mirë për t'u njohur me afër me punën që "Beo" kryen", thotë ai.

I pyetur lidhur me rolin e Qendrës së Karrierës në UBT në punësimin e tij, z.Ahmeti shpreh: "Roli i Qendrës së Karrierës ka qenë crucial, pasi që ishin ata që më informuan se një mundësi e tillë ekziston".

Studenti Ahmeti çmon shumë ndihmesën që i ka krijuar dija e krijuar gjatë studimeve në UBT dhe ky institucion përgjithësisht, në mënyrë që ai sot të mund të kryejë punën e tij.

"Fatmirësisht udhëheqësit e kësaj kompanie kishin pasur mundësinë të takohen para-prakisht edhe me rektorin e Universitetit UBT, z.Edmond Hajrizi. Në momentin kur unë u prezantova si student i UBT-së, ata tashmë kishin edhe informacionet e nevojshme rreth programeve akademike që UBT ofron. Para ca muajsh kemi punësuar edhe një tjetër student të UBT-së në Departamentin për Testim të Sigurisë dhe jemi të kënaqur maksimalisht me njohuritë e tij, formimin akademik dhe profesional që ka", thekson studenti Agon Ahmeti.

Në fund, studenti Agon Ahmeti ka një porosi për studentët e UBT-së: "Unë shpesh përcjell njoftimet e UBT-së, përmes të



Agon Ahmeti

cilave studentët njoftohen për mundësi shumë të mira për studime të mëtejshme, programet për exchange dhe punësime. Kam përshtypjen se z.Edmond Hajrizi është një person që në

vazhdimësi punon që sa më shumë të ofrohen mundësi të tilla për studentët e UBT-së. Mjafton që ata t'i ndjekin ato dhe të aplikojnë, tek e fundit nuk humbasin asgjë".

STUDENTET E UBT-së, DRENUSHE THAÇI DHE DODONA BLAKAJ, PJESË E PROJEKTEVE TË RËNDËSISHME PËR PRISHTINËN

Studentet e UBT-së, Drenushe Thaçi dhe Dodona Blakaj, gjatë një internshipi në Komunën e Prishtinës, gjatë muajve të verës 2014, kanë marrë pjesë në një projekt për matjen e klasave të shkollave të ciklit të ulët në Komunën e Prishtinës. Ato gjithashtu janë pjesë e projektit "Urave të Gjellbërimit".

Në një bisedë për "UBT News" ato shpjegojnë angazhimin e tyre në projekte të rëndësishme të realizuara gjatë kësaj kohe.

"Grupi ynë ka qenë i angazhuar në matjen e klasave të shkollave të ciklit të ulët në Komunën e Prishtinës, brenda një periudhe kohore prej dy javësh. Puna jonë gjatë angazhimit në Komunë ka kaluar nëpër tri faza kyçe. Fillimisht kemi bërë incizimin e klasave në shkollat e qytetit, duke vijuar pastaj me shkollat në fshatrat përreth. Shkollat, në të cilat kemi bërë incizimin e klasave, kanë qenë: Shkolla fillore "Gjergj Fishta" (Prishtinë), Shkolla fillore "Elena Gjika" (Prishtinë), Shkolla fillore "PjetërBogdani" (Prishtinë), Shkolla fillore "Iliria" (Prishtinë), Shkolla fillore "Nexhmi Mustafa" (Prugoc), Shkolla fillore "Nexhmi Mustafa" (Rimanishtë) dhe Shkolla fillore "Anton Zako Çajupi" (Besli), thonë ato.

"Në fazën e dytë kemi vazhduar me dokumentimin dhe paraqitjen teknike të matjeve në terren, si dhe dorëzimin e dokumentacionit në departamentin e Urbanizmit, gjegjësisht të zyrarja kompetente e internshipit, Nazmije Torë.

Pas dorëzimit të gjendjes aktuale, kemi vazhduar me konsultimin e ideve tona rreth projektit,

konkretisht në modelimin e dollapëve, të cilët do të dizajnohen.

Në fazën e fundit, pas shqyrtimit të ideve tona me zyrarët kompetentë, arritëm në një përfundim rreth dizajnit të dollapëve, ku hasëm në një mirëkuptim të dyanshëm dhe në një zgjidhje adekuate.

Një nga sfidat më të mëdha për ne ka qenë pamundësia e incizimit të shkollave nëpër fshatrat e lartpërmendura. Edhe pse kemi pasur këtu problem, zgjidhja jonë ka qenë përdorimi i modulit të njëjtë të dollapëve në të gjitha shkollat në komunën e Prishtinës.


Si përfundim, përkundër sfidave që kemi hasur gjatë kësaj kohë, ky internship ka qenë një përvojë shumë e mirë për ne, ku një falënderim të madh marrin zyrarët për qasje profesionale dhe korrekte dhe një bashkëpunim cilësor", shpjegojnë më tej Drenusha dhe Dodona.

Gjithashtu, ato kanë qenë të angazhuara edhe në realizimin e një projekti për Prishtinën. Për çfarë projekti është fjala? Çka përmban ai? Si është vlerësuar ky projekt dhe cilat janë mundësitë e zbatimit të tij në praktikë?

Drenusha dhe Dodona shpjegojnë se fjala është për projektin e Urave të Gjellbërimit (Eko), punuar nga Grupi i Arkitektëve të Rinj.

Ky projekt është zhvilluar për konkursin e Javës Arkitekturale të Prishtinës – Ide për qytetin e Prishtinës.

Duke qenë se zonat urbane të Prishtinës vazhdimisht rriten, ne e



Drenushe Thaçi dhe Dodona Blakaj

pamë një mundësi për të përmirësuar qytetin tonë duke shtuar gjellbërimit në hapësirat e betonit, duke mos ndërhyrë në funksionet e ambientit përreth. Gjellbërimit do të sjellë shumë ndikime pozitive dhe do të veprojë si oazë në mes të kësaj "parajsë" të betonit.

Për të bërë këtë, ne kemi zgjedhur blloqet e banimit të betonit në lagjen "Ulpiana". Hyrjet e këtyre ndërtesave kanë ura të cilat i lidhin ato me rrugën, duke krijuar kështu një hapësirë të zbrazët në mes, nën të cilën është një rrugë. Kjo rrugë përdoret kryesisht për rekreacion nga qytetarët që jetojnë aty, edhe pse nuk ka kushtet e duhura për këtë gjë.

Prandaj ne kemi menduar një zgjedhje ekonomike për nevojat e qytetarëve, thjesht duke rindryshuar hapësirën dhe duke shtuar shufra metalike e duke mbjellë gjellbërimit për t'u rritur rreth tyre.

Hapësira e rindryshuar është menduar që të ndajë nivelin e rrugës në dy zona, një për rekreacion të duhur, duke ofruar ulëse e duke shijuar hijet e krijuara nga gjellbërimit i sipërm dhe tjetrin

për automjetet që kalojnë, edhe pse nuk është rrugë qarkullimi e as parking, thjesht është një rrugë që duhet të shkojë rreth e përqark objektit.

Afër hyrjeve në nivelin e rrugës, ne kemi dizajnuar edhe kosha të basketbollit dhe kemi përshtatur hapësira të lojërave përballë ulëseve që janë nën rehatinë e hijeve.

Më tutje ne mund të themi se gjellbërimit në këtë zonë do të ndikonte në rritjen e kënaqësisë për qytetarët që e përdorin këtë hapësirë si zonë rekreative, do të ketë ndikim pozitiv në eko-sistemin dhe sigurisht do të shërbejë edhe si strehim për zogjtë.

Gjëja më pozitive për projektin është se është ekonomik – i arsyeshëm për t'u realizuar, dhe kërkon jo ndonjë nivel të lartë të mirëmbajtjes, madje as shpenzime të tjera.

Dhe po, mbani në mend, ashtu siç ka thënë J.Burroughs: "Unë shkoj në natyrë për t'u zbutur e shëruar, e për të vendosur shqisat e mia në vendin e vet. Prandaj le ta sjellim natyrën tek ne!"

Ky projekt ka konkurruar në mesin e shumë projekteve të

mëdha, përkrah arkitektëve ndërkombëtarë me famë botërore. Ne kemi konkurruar si studentë të vitit të dytë kundrejt arkitektëve me përvojë. Ne kemi arritur të hyjmë në mesin e "top 10" dhe projektet janë prezantuar në hollin e Komunës së Prishtinës për një javë rresht.

Ajo çka neve na ka bërë krenare është përkrahja që kemi marrë nga qytetarët, kolegët, rreth idesë së thjeshtë por shumë praktike dhe të nevojshme. Ndoshta mund të themi se ky ka qenë vlerësimi më i rëndësishëm dhe më me vlerë për ne.

Drenushe Thaçi dhe Dodona Blakaj janë studente të vitit të tretë në Fakultetin e Arkitekturës në UBT.

"Duke qenë pjesë e UBT-së dhe në përkrahje të vazhdueshme të stafit akademik, ne kemi gjetur mbështetje të pakufizuar duke na dhënë mundësinë e shprehjes tonë, dhe po ashtu kanë qenë po këta që na kanë frymëzuar për të marrë pjesë në konkurse të ndryshme si vendore ashtu edhe ndërkombëtare. Duke qenë pjesë e bursistëve për dy vite radhazi ne jemi të kënaqura me rezultatin që kemi arritur në UBT", thonë ato.

Ato shprehen se përvoja në internshipe të ndryshme ka qenë një ndihmesë shumë e madhe për to, u ka ndihmuar të njihen dhe të afirmohen në rrethe të ndryshme. Këto internshipe kanë qenë edhe një ndihmesë në aspektin profesional arkitekturor. Andaj pjesëmarrja e vazhdueshme në internshipe nuk na pengon në punë, por vetëm na formon si profesioniste, shprehen Drenushe Thaçi dhe Dodona Blakaj.

DILEMA E MADHE

PSE PO IKIN KOSOVARËT?

Shpresoj që Kosova nuk do të jetë një vend nga i cili njerëzit do të kërkohen të largohen, por një vend në të cilin do të ketë perspektivë për gjeneratat e reja

Nëse ia bëjmë vetes pyetjen se a ka krizë në Kosovë, përgjigja normalisht që do të jetë PO!

Mirëpo, nëse e shikojmë gjendjen reale, kriza ekonomike nuk është aq e madhe sa mungesa e edukatës sociale e ekonomike.

Pse kemi mungesë të edukatës sociale-ekonomike?

Një familje 4-5-anëtarëshe, e cila jeton me një rroge mesatare në Kosovë, arrin të ushqehet, të vishet e të mbathet e madje të ketë edhe luks!

Çfarë quaj luks unë?

4-5 "smartphone" (ka raste kur nga këta 4-5 anëtarë të familjes 1-2 janë

fëmijë nën moshën 15vjeçare), ndeja të ndryshme, udhëtime, stile flokësh e thonj të rregulluar!

Për mua, është absurde kjo situatë në Kosovë. Është absurde të ankohe mi, është absurde të nisemi për perëndim me Iphone e me telefona të tjerë që ndoshta në shqiptarët edhe i kompleksojmë banorët e shteteve evropiane me ta!

Prefekti i fshatit kufitar hungarez Asotthal, Laszlo Torockai, në një intervistë në lidhje me emigrantët të cilët kalojnë nëpër Hungari, për rrjetin e madh televiziv BBC tha: "Kemi simpati për ata që ikin nga zonat e luftës, si sirianët apo iranianët, por kemi më pak simpati për

ata që ikin nga varfëria. Shumica e tyre kanë telefona të mençur dhe e ndjekin përparimin e tyre në udhëtim me GPS. Të paktë janë zgjedhësit e mi, në dyert e të cilëve ata trokasin në mes të natës, që mund t'ia lejojnë vetes luksin që të kenë telefona si të atyre. Nuk mund të kuptoj se pse në mes të dimrit ata vendosin të ecin në këmbë me dhjetëra kilometra në klimë të akullt".

Është absurde që me gardërobë të shtrenjtë, me "dukat" e me gjëra të tjera të kërkojmë azil diku!

Kosova është në krizë edukative, krizë sociale e pa dyshim që kriza ekonomike nuk i lë këto dy të tjerat të vërehen nga njerëzit!

Shume faktorë kanë ndikuar që banorët e Kosovës të largohen nga vendi duke kërkuar një jetë më të mirë! Gjer-

mania është destinacioni më i kërkuar prej tyre.

Sipas shumë analistëve, kjo ishte mundësia e fundit që njerëzit të largohen para liberalizimit të vizave. Gënjeshtra e trafikantëve se Gjermania do të japë azil bëri që njerëzit të shesin shtëpitë, tokat e dyqanet, bëri që të hyjnë në borxhe vetëm që të paguajnë shpenzimet e rrugës!

Shpresoj që njerëzit që do të kthehen nuk do të mbesin rrugëve, nuk do t'u duhet të kërkojnë ndihmë nga qeveria, që i largoi (gjithmonë duke u nisur nga fjalët e tyre).

Shpresoj që Kosova nuk do të jetë një vend nga i cili njerëzit do të kërkohen të largohen, por një vend në të cilin do të ketë perspektivë për gjeneratat e reja.

Drin Jakurti

UBT OBJEKTIV I TË RINJVE

STUDENTËT: UBT AFIRMON PARIMET PËR EDUKIM DHE MËSIMNXËNIE

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), shërben si hapësirë për të gjithë studentët të cilët pretendojnë të kenë mësimnxënie dhe zhvillim të vazhdueshëm profesional. Aktivitetet brenda UBT-së janë pjesë e pandashme e studentëve të tij dhe shërbejnë për aspektet zhvillimore dhe efektive. Kështu shprehen studentët e këtij universiteti për UBT News.

Egzon Hyseni, Albina Zeneli dhe Ilaz Luzha, të gjithë studentë të vitit të dytë në drejtimin Media dhe Komunikim në UBT, theksojnë se ky universitet vazhdon të mbetet një institucion inovativ i arsimit të lartë në Kosovë dhe në rajon, i cili ofron studime sipas standardeve ndërkombëtare, mundësi për përvoja të jashtme (studime profesionale e praktika), infrastrukturë moderne, organizim dhe menaxhim modern, etj.

"Them që misioni i UBT-së është që të ketë zhvillim të arsimit të lartë në Evropë, gjithashtu krijimi i kuadrove sa më profesionale për tregun, që studentët do të dalin pas përfundimit të studimeve dhe që të japin kontributin e tyre në fusha të caktuara që ata do të udhëheqin apo do jenë pjesë e tyre", është shprehur Hyseni.

"Të veçantë këtë institucion e bën stafi i cili punon me përkushtim të madh, kryesisht meritën më të madhe e gëzojnë profesorët që janë të një niveli të lartë. Mundësitë që i ofron ky institucion janë mjaft të mira për çdo student, sepse është mundësia që secili student të studiojë në universitete të ndryshme të Evropës, të bëjë praktikë në fusha të ndryshme, prandaj është edhe objektiv i të rinjve", është shprehur Luzha.

"Ky universitet është një pikë e fortë e çdo studenti që pretendon të arrijë diçka në jetë, kuptohet duke mësuar dhe duke punuar. Dallon nga kualiteti i nivelit të dijes, që ofron kushte të posaçme për zhvillimin e njohurive dhe ngritjen intelektuale të personalitetit tonë si studentë", është shprehur Zeneli.

Përderisa Gjylje Rexha, ligjëruese në UBT, pohon se ky i fundit përgatit kuadro konkurrenca dhe në përputhje me kërkesat e profileve përkatëse të studimeve që ofron.

"Ndërthurja ndërmjet dijes teorike dhe përgatitjes praktike për zbatimin e teknologjive të reja, janë parakushte për profilin e njerëzve të sferës publike dhe mediale, që është gjithnjë e më e ndërlikuar. UBT, me standardet e studimeve, ofron cilësinë e lartë, që është garanci për sukses në karrierë afatgjatë", është shprehur Rexha.

Ndërkohë Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) konsiderohet si hapësirë e suksesshme në të gjitha fushat, falë përkushtimit të punonjësve të Universitetit, si stafit akademik, po ashtu edhe stafit administrativ. Falë punës të vazhdueshme është krijuar një bindje gjithëpërfshirëse e qytetarëve dhe institucioneve akademike, se në këtë Universitet ka pasur punë dhe rezultate që janë për t'u vlerësuar. Rezultate konkrete janë arritur duke përfshirë këtu të gjitha fushat. Duhet pohuar fakti se misioni parësor i këtij Universiteti është edukimi dhe arsimimi i studentëve. Ndërkaq UBT, sipas zyrtarëve të saj, është i angazhuar të ofrojë të gjitha pajisjet për të përkrahur studentët në mësimnxënie, avancim të karrierës, etj.

Edona JERLIU

INTERVISTË ME EDI KASTRATI, AKTOR

PERSONAZHI GJAKOVARI I "O SA MIRË" TREGON RRETH JETËS DHE PUNËS



"Nëse nuk do kisha qenë aktor nuk do të kisha ekzistuar fare. Jam tepër i lidhur me teatrin dhe skenën në përgjithësi sa që nuk do ta kisha paramenduar jetën pa ART", thotë Edi për UBT News.

UBT News: Për ata që nuk ju njohin, një informacion të shkurtër: Kush është Edi Kastrati?

Kastrati: Unë jam Edi Kastrati, jam i lindur në Gjakovë, jam aktor. Kam diplomuar në vitin 2006 në Prishtinë, aktualisht jam drejtor i Teatrit të Gjakovës. Punoj edhe në Prishtinë në Teatër dhe në serialin "O Sa Mirë". Jam djalë i mirë... ha ha ha.

UBT News: Nostalgjitë tua gjatë studimeve?

Kastrati: Nostalgjia gjatë studimeve... Hmmm nostalgji ka çdo herë, ndoshta mund të theksohet më tepër kur takohemi me shokët e shoqet e klasës, ose kur na rastis ndonjë vepër që kemi punuar gjatë studimeve.

UBT News: Ju kemi parë në serialin "O sa mirë: në rolin e Arbnorit, sa dallon Edi nga ky personazh?

Kastrati: Edi nga Arbnori dallon shumë, na bashkon vetëm vendlindja, asgjë më tepër.

UBT News: Nëse nuk do kishit qenë aktor çfarë profesioni do zgjidhni?

Kastrati: Nëse nuk do kisha qenë aktor nuk do të kisha ekzistuar fare. Jam tepër i lidhur me teatrin dhe skenën në përgjithësi sa që nuk do ta kisha paramenduar jetën pa ART.

UBT News: Duke marrë parasysh që seriali është me sezone dhe provat zhvillohen

me të gjithë protagonistët e tjerë, na tregoni pak se si është puna në ekip?

Kastrati: Puna në ekip është punë për t'u lakmuar, sepse sado që të zgjasë orët shkon pa e vërejtur fare. Sidomos me ekipin e "O sa mirë" ku të gjithë pa përjashtim janë aktorë jashtëzakonisht të mirë, të shoqëruar dhe shumë profesionalë.

UBT News: Po kalojmë pak nga jeta private. Si e kalon Edi një ditë të zakonshme?

Kastrati: Një ditë e imja e zakonshme është plot dinamike. Kam detyra të shumta të cilat ia planifikoj vetes, duke filluar nga Teatri i Gjakovës, përgatitja e detyrave zyrtare, planifikimi, organizimi etj. Obligimet familjare kuptohet. Për momentin jemi në përgatitje të një shfaqjeje "Pjata prej Druri", pra angazhimi rreth projektit, duke vazhduar mandej me përgatitjen dhe provat për "O sa mirë" dhe ndonjë javë kur kemi dhe reprizë të shfaqjes "Policët", e cila është në repertor të Teatrit Kombëtar të Kosovës, etj etj.

UBT News: Planet tuaja për të ardhmen?

Kastrati: Planet e mia për të ardhmen janë aq të shumta sa që do të më nevojitet një intervistë tjetër enkas për plane. Ju falënderoj që më përzgjidhët mua për të diskutuar së bashku për këtë numër të gazetës suaj.

Intervistoi: Albina Zeneli

SKICË

Qyteti i Prizrenit është i njohur si një vend unik në Ballkan, për nga trashëgimia kulturore, nga religjione të ndryshme, nga pozita e favorshme gjeografike si dhe nga bukuria e saj mahnitëse.

Prizreni ka një bukuri të veçantë në dimër. Qyteti pothuajse e vesh një fustan të bardhë. Lumbardhi, i cili zbrret nga malet e Sharrit, mu në mes të qytetit, është më i rrjedhshëm në këtë periudhë të dimrit. Në të dy anët e lumit gjenden kafenetë, restorantet, lokalet si dhe shtëpitë e vjetra karakteristike prizrenase nga kulmi i të cilëve del tymi i oxhaqeve.

Dimri në Prizren nuk është shumë i ashpër, ka reshje bore, mirëpo jo në sasi të mëdha.

Qytetarët prizrenas stinën e dimrit e shfrytëzojnë edhe



duke dalë në sheshin e Shatërvanit, ku kalojnë momente të bukura.

Përveç bukurive të natyrës, dimri sjell edhe vështirësitë në infrastrukturë. Reshjet e dëborës

në kohët e fundit të fundit në Prizren nuk kanë shkaktuar rrezik në lëvizjen e mjeteve. Pavarësisht

dëborës së rënë, nuk ka asnjë shqetësim edhe në fshatrat përreth. Mirëpo, herë pas here shkaktohen aksidente të vogla.

Kemi nisur t'i harrojmë dimrat e dikurshëm, dimra kur temperatura zbriste në minus 20 gradë, dhe ku sasia e borës ishte shumë më e madhe sesa në ditët e sotme. Ditët e para të dimrit u ngjajnë ditëve pranverore. Edhe pse kah fundi i dhjetorit dëborë nisi ta mbulojë peizazhin e qytetit.

Nën këtë panoramë joshëse edhe festat priten me një atmosferë festive që duket gjithandej.

Anisa Rada

TEUTA DERVISHI, STUDENTJA, PUNËTORJA & KËNGËTARJA E UBT-SË

TEUTA: "PJESËMARRJA NË TOP FEST 11 NDODHI SHUMË SHPEJT DHE SPONTANISHT"

Teuta Dervishi është njëvjeçare nga Prishtina, 21 vjeçare. Ajo është studente në vitin e dytë në UBT në degën MBE. Punon në UBT në departamentin e statistikave (UBT STATS) dhe merret me mbledhjen, organizimin dhe publikimin e të dhënave statistikore. UBT STATS lindi si nevojë e pasjes së një baze të të dhënave konsistente me praktikën statistikore ndërkombëtare, lehtësisht të konvertueshme për analiza kuantitative, ekonomike dhe për parashikime, si dhe modelime të ndryshme që do të ndihmojnë vendimmarrjen në nivel makroekonomik. Qëllimi i UBT STATS është të krijojë një bazë të të dhënave statistikore të Kosovës dhe të ofrojë informata statistikore të strukturuar dhe të krahasueshme në kohë për të gjithë të interesuarit. Po ashtu studentët e UBT-së për punimet dhe projektet e tyre do të mund t'i referohen këtyre të të dhënave si burime të referencës, të organizuara në formë të qartë dhe lehtë të kuptueshme. Duke marrë parasysh se edhe

punon edhe studion në të njëjtën kohë, është pak e vështirë të planifikojë kohën, mirëpo Teuta nuk e ka pasur problem sepse e ka arritur notën mesatare 9.94, dhe është e kënaqur me sukseset që ka arritur deri tash.

Hobi i saj është muzika. Përveç punës dhe mësimi Teuta e ka në qejf edhe muzikën. Me muzikë është marrë që nga fëmijëria, duke qenë pjesë e aktiviteteve të ndryshme shkollore, në koncerte me profesorin e kitarës etj.

Mirëpo, si erdhi deri te vendimi për të marrë pjesë në "Top Fest 11"?

"Pjesëmarrja në "Top Fest 11" ndodhi shumë shpejt dhe spontanisht. Këngën pothuajse e kisha gati, pasi që kishte kohë që tekstin dhe muzikën e saj ma kishte dhënë një shok i im i (Labinot Avdiu). Aranzhimin e këngës e bëri Sezgin Curi, anëtar i grupit Offchestra bashkë me disa kolegë të tij", shprehet Teuta.

Kështu që hymë në studio, e incizova këngën dhe e dorëzoja. Për mua ishte hera e parë që mora pjesë

në një. Kënga u pritshëm mirësi nga familja, shoqëria ashtu edhe nga juria e këtij festivali. Përkundër faktit që ishte hera e parë, mendoj se arrita të kem shumë sukses dhe të jem në finale si dhe e nominuar në Best New Artist.

Për këngën ajo falënderon Labinot Avdiun, Sezgin Curin, Dukagjin Muhaxherin, Faruk Banjskën, Fatjon Miftarajn dhe gjithashtu Samer Agollin për mundin që e kanë dhënë që kënga të ketë sukses.

"Me muzikë jam rritur dhe mendoj që do vazhdoj të merrem me muzikë. Është diçka që më bën të ndihem mirë, ndoshta edhe në ato momente kur nuk jam në gjendje për asgjë. Është ndjenjë e mirë të jesh në mesin e shumë artistëve të mëdhenj të cilët të komplimentojnë dhe të urojnë për këngën. Krijoni një karrierë të suksesshme në UBT, zgjedhni UBT-në sepse ju jep mundësi për t'u ngritur në nivele më të larta akademike", thekson Teuta.

A.Zeneli

TË RINJTË DHE INTERNETI

Interneti është mjeti më i përdorur nga të rinjtë, i cili i informon ata në lidhje me gjithçka, me tema të ndryshme.

Interneti është një mjet, i cili është duke u përdorur me të madhe nga ana e popullatës sidomos nga të rinjtë, të cilët kalojnë kohë shumë të madhe në rrjetet sociale. Sigurisht se me faktin se interneti na njofton me gjithçka, do të thotë se i ka anët pozitive. Mirëpo, nga këndvështrimi tjetër mund t'i vërejmë edhe anët negative të cilat pasqyrojnë vese të këqija të të rinjve.

Deri te krijimi i internetit është dashur një kohë e gjatë dhe mjaft e vështirë, kurse tani cilësohet si mjet më i shpejtë dhe më i rëndësishëm në ditët e sotme. Interneti përpos që argëton me gjëra të ndryshme, si muzikë madje video lojëra, të rinjtë e përdorin edhe për gjëra të rëndësishme jetësore, duke e shfrytëzuar për aplikim rreth ndonjë pune ose për ndonjë intervistë të llojeve të ndryshme.

Pas një dite të lodhshme pune, mund të argëtoheni me llojet e muzikave të preferuara, njëkohësisht mund të hapni faqen e juaj dhe të shfrytëzoni mesazhin për të biseduar me ndonjë shok ose shoqe për t'u informuar me ndonjë të re. Pra, ka ndikim mjaft të madh në komunikimin shoqëror. Madje të rinjtë e shfrytëzojnë internetin edhe për t'u infor-

muar me tema të cilat kanë të bëjnë me jetën e tyre private. Kjo është mjaft e dobishme, sepse mësojnë mënyra të ndryshme të mbrojtjes nga rreziqet e shumta që po shfaqen dhe po ndodhin nga mosinformimi i duhur. Pra, është mjet nga i cili mund të informohemi për aspekte të ndryshme, për ndodhi të ndryshme, të cilat janë aktuale në botë, po ashtu edhe për botën e show-bizit, e cila parapëlqehet më shumë nga të rinjtë.

Pavarësisht këtyre të mirave, ekzistojnë edhe gjërat negative të cilat pothuajse ekzistojnë gjithkund. Shfrytëzimi i tepërt i internetit nga të rinjtë po ndikon që të rinjtë të mos dalin shumë, pra të mos i vizitojnë të afërmit, pastaj brengosja më e madhe është që të rinjtë po e humbasin kontaktin me libra duke mos lexuar aq shumë libra, madje edhe libraritë ankohen nga mosshfrytëzimi i tyre nga ana e të rinjve.

Interneti është mjeti i cili ka pushtuar madje edhe mjetet e tjera të informimit, si televizionin, gazetën etj. Sidomos gazetën të cilat nuk po blihen, sepse pothuajse secila gazeta e ka versionin online, pra faqet e tyre në rrjetet sociale ku madje të rinjtë e shfrytëzojnë edhe për të dhënë komente të ndryshme ndonëse në shumicën e rasteve duke ofenduar persona të ndryshëm. Pavarësisht të mirave apo të metave, kontakti i të rinjve me internetin po bëhet mjaft shumë, madje interneti është bërë pjesë e jetës së tyre.

Sherife Sokoli

BREZI QË PO SHKON DËM!

Në ditët e sotme, të rinjtë kanë ndryshuar shumë në krahasim me adoleshentët në të kaluarën, duke marrë në konsideratë mënyrën e jetesës, ushqimet që hanë, si e shpenzojnë kohën e lirë, si dhe sa të fiksuar janë pas gjërave jo shumë të rëndësishme për të ardhmen e tyre. Tani të gjithë mund t'i quajmë gjenerata e "teknologjisë"

Për adoleshentët e sotëm bota e telefonave të mençur "smartphones", interneti, muzika, filmat, televizioni dhe video lojërat janë më të rëndësishmet. Atyre nuk u pëlqen që të lexojnë libra, sepse të shikojnë televizion është më e lehtë pasi që nuk ju duhet ta përdorin imagjinatën e tyre. Adoleshentët preferojnë më shumë që ta kalojnë kohën e lirë para kompjuterit sesa që të dalin për të ecur, për të luajtur futboll apo të merren me ndonjë aktivitet fizikë që është shumë më i shëndetshëm për ta, e për më shumë lojërat e kompjuterit i transferojnë ata në një botë e cila nuk ekziston fare mirëpo që ju duket shumë më emocionuese.

Të rinjtë tanë hanë më shumë ushqime të shpejta. Çdo adoleshent ka nevojë për një dietë të balancuar, përshtatur së bashku me aktivitete fizike në ajër të pastër, për shembull, vrapim, not, të luajnë tenis, futboll apo vetëm të ecin. Kjo për ta duhet të jetë më interesante sesa të rrinë ulur para kompjuterit apo televizionit për orë të tyre, sepse kjo mund të ndikojë negativisht në shëndetin dhe fizikun e tyre. Ushqimi i shpejtë, i cili është shumë i yndyrshëm, si dhe pijet me sheqer, i qojnë ata deri te trashja dhe dëmtimi i shëndetit.

Aktiviteti fizik ka një ndikim të madh në mënyrën e jetesës së rinisë tonë. Aktiviteti fizik përmirëson gjendjen shëndetësore në mënyra të ndryshme. Megjithatë, aktivitetet fizike janë një problem shumë i madh në jetët e tyre. Të rinjtë duhet të jenë të vetëdijshëm për ndikimin pozitiv që ka ajri në jetë, si në shëndet dhe humor të tyre. Kjo do t'u jap atyre rezultate të mira në studime gjë që është shumë më e rëndësishme si dhe ata do të ishin shumë më të kënaqur me shëndetin që do të gëzonin.

Të rinj, çfarë do të bëni me jetën tuaj?

"Dua të bëj një jetë sa më të mirë". Kështu u shpreh një adoleshente. "Pa dyshim, edhe ti dëshiron të njëjtën gjë. Por, si arrihet një jetë sa më e mirë? Mjetet e informacionit, bashkëmoshatarët e ndoshta edhe vetë mësuesit e tu mund të thonë se kjo arrihet duke fituar shumë para dhe duke pasur ndonjë karrierë të shquar, pra, duke qenë njeri i suksesshëm. Mirëpo, t'i arrish këto, sytë duhet t'i drejtojmë vetëm nga shkolla.

I pyetur se pse të rinjtë tanë po shkojnë dëm, një i moshuar u shpreh: "Rinia e sotme ka shumë probleme të dukshme, nuk ekziston asnjë kufi, qoftë për mirë apo për keq. Në fjalorin e tyre nuk ekziston fjala "kufi". E mendojnë çdo gjë të lehtë dhe presin nga të tjerët. Nuk kanë parime, nuk njohin moral. Problemi më i madh i rinisë është se janë jashtë realitetit. Nuk e kuptojnë veten, e aq më pak të tjerët. Nuk i kuptojnë rrethanat, kohën apo vendin ku jetojnë. Dhe, gjithçka që bëjnë, duke menduar për të mirë e bëjnë gabim, në të keq të vetes dhe rrethit ku jetojnë."

Krahasuar kohën e tashme me të kaluarën rinia ka ndryshuar shumë sa i përket shprehisë së punës, mësimi dhe respektit.

Edita Bujupaj



FLORIMENT KLINAKU FLET PËR LOJËN "PISHPIRIKU" NË RRJETIN SOCIAL

LOJA E "PISHPIRIKUT" ME MBI 300,000 KLIKIME NË "FACEBOOK"



Floriment Klinaku, student masteri në Distributed Software Systems në Universitetin Teknik të Darsmtadt të Gjermanisë, është ideatori kryesor i lojës më të madhe elektronike me letra të krijuar nga programerët shqiptarë.

Një një bisedë për UBT News ai shpjegon se "Pishpiriku" është krijuar me shumë dashuri nga puna e katër njerëzve. Pishpiriku është nisur nga ai dhe Alket Rexhepi si ide, e për ta vënë në jetë këtë ide u kanë ndihmuar edhe studentët e UBT-së Pëllumb Hasani e Atdhe Konjufca (dizajner grafik), ku puna e tyre ka përfshirë pjesën e ndjeshme të eksperiencës së lojës për përdoruesin e fundit.

UBT News: Çka është «Pishpirik-u»

Klinaku: "Pishpiriku" është një lojë tradicionale me letra, e cila luhet nga e gjithë Evropa Juglindore. Pishpiriku është ndër lojërat më të thjeshta me letra, e cila të sfidon memorien dhe përcjelljen e letrave. Tek ne në Kosovë, Pishpiriku e njohin të gjitha gjeneratat, pra është e panevojshme që të shpjegoj rregullat apo mënyrën se si luhet loja.

UBT News: Si keni arritur deri tek ideja e shndërrimit të «Pishpirik-ut» në një lojë që mund të luhet edhe në facebook?

Klinaku: Ideja për shndërrimin e Pishpirikut të odave në një lojë që mund të luhet edhe në pajisjet elektronike ka qenë që prej shkollës së mesme, ku unë dhe Alketi (Alket Rexhepi) gjithmonë kemi diskutuar dhe kemi ëndërruar për krijimin e ndonjë loje. Qysh atëherë është diskutuar vetëm si ide, pa u thelluar në detaje, edhe loja Pishpirik, në mesin e shumë ideve të tjera.

UBT News: Dihet që në vendin tonë dhe në përgjithësi në Ballkan, kjo lojë është shumë e njohur, a ka pas sukses formati i ri i kësaj loje?

Klinaku: Për mua sukcesi i Pishpirikut mund të trajtohet në shumë dimensione. Disa prej tyre janë të suksesshme e disa prej tyre të pasuksesshme. Sukcesi i parë për mua është paraqitja e Pishpirikut si temë diplome në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore në Universitetin e Prishtinës, ku në një ambient akademik para një publiku kryesisht studentë të Shkencave Kompjuterike është shpalosur kompleksiteti dhe arkitektura e lojës Pishpirik, të cilën e kam dizajnuar nga njohuritë që kam fituar gjatë studimeve. Sukcesi i dytë është plasimi i kësaj loje për publikun, ku brenda 6 muajve të parë Pishpiriku ka pas më shumë se 300,000 lojtarë të regjistruar. Sukses tjetër është që Pishpiriku ka qenë cilësor dhe është vlerësuar lartë nga të gjithë njerëzit e sektorit të informacionit dhe komunikimit por edhe nga njerëzit e pakët që merren me prodhim të lojërave në Kosovë.

UBT News: Përveç atyre që janë pro kësaj loje, a ka edhe nga ata që janë kundër?

Klinaku: Nuk besoj që ka shqiptar që është kundër Pishpirikut! Por ka lojtarë të Pishpirikut që janë të pakënaqur me lojën, të cilët kanë të drejtë, dhe ne marrim shumë mesazhe për problemet teknike që ka loja Pishpirik për Facebook. Një gjë që duhet të kuptohet është që loja Pishpirik nuk ka mundur të gjenerojë mjete të cilat do të krijonin kushtet për përmirësim, mirëmbajtje dhe avancim të lojës. Pishpiriku funksionon sot pa asnjë përfitim personal e ky është njëri prej dështimeve të mia në këtë drejtim.

UBT News: Qëllimi i kësaj loje është përfitimi material apo e keni pasion?

Klinaku: Pishpiriku është nisur dhe realizuar me idenë e pasionit për të bërë lojëra dhe për të mësuar se si krijohet lojërat. Pishpiriku gjatë rrugës i është shtuar edhe qëllimi i përfitimit të cilin nuk e kemi arritur.

UBT News: Dihet që është lojë e klikuar, sa kanë qenë klikimet në muajin e parë që është lansuar në facebook?

Klinaku: Pishpiriku sa i përket industrisë së video-lojërave në Kosovë e Shqipëri ka shënuar shumë rekorde, me të cilat do të duhej të merreshin qoftë revistat e sektorit të ICT, qoftë institutet e ndryshme apo edhe punimet kërkimore në universitetet tona. Mendoj që një rekord është edhe përhapja shumë e shpejtë e lojës, ku brenda muajit të parë lojës i janë qasur afër 40,000 lojtarë, ku mesatarja e lojtarëve aktivë në ditë përgjatë muajit të parë ishte afër 40% e këtij numri. Statistikat e përdorimit të Pishpirikut janë publike edhe mund të qasen nga kushdo. Janë shumë interesante për t'u analizuar dhe mendoj që kushdo tjetër që dëshiron të prodhojë lojëra, duhet t'i di grafet e Pishpirikut. Janë një bazë e mirë për të kuptuar shumë gjera.

UBT News: Procedura e lansimit në facebook, sa ishte e vështirë që loja të vendoset (futet) në facebook?

Klinaku: Një lojë pasi të përfundohet kah aspekti teknik, dizajni dhe funksionimi, atëherë futja e saj në Facebook është e lehtë. Facebook-u është një platformë e cila ofron përparësi të cilat mund të shfrytëzohen. Njëra nga përparësitë është mundësia të shfrytëzosh raportet sociale në Facebook për të përhapur lojën. Një metode konkrete për këtë është kushtëzimi i mundësisë për të luajtur lojën me ftesa (invites) të shokëve për të përhapur lojën, edhe pse kjo metodë është shumë e butë në Pishpirik, por e cila mund të bëhet.

UBT News: Cilët janë ata persona që të kanë ndihmuar apo më mirë të themi bashkëpunëtorët tuaj në këtë projekt? Personat që e kanë ndihmuar Pishpirik-un?

Klinaku: Pishpiriku është krijuar me shumë dashuri nga puna e katër njerëzve. Pishpiriku është nisur nga unë dhe Alketi si ide, e për ta vënë në jetë këtë ide na kanë ndihmuar edhe Pëllumb Hasani, i cili është edhe student i universitetit tuaj, pra Universitetit për Biznes dhe Teknologji dhe Atdhe Konjufca (dizajner grafik), ku puna e tyre ka përfshirë pjesën e ndjeshme të eksperiencës së lojës për përdoruesin e fundit.

UBT News: Mesazhi juaj për ata që luajnë «Pishpirik»?

Klinaku: Pishpiriku si është tani, ka disa mangësi e probleme. Unë dua t'ju them të gjithë lojtarëve që Pishpiriku është nisur me dashuri, është një projekt shumë i madh që është krijuar nga pasioni i disa të rinjve shqiptarë. Pishpiriku është përvoja e parë e imja. Shumë shpesh mendoj se sikur ta dija se ky projekt do të përfshinte mbi 300,000 zemra shqiptare, ndoshta do të stepesha. Unë dua t'ju kërkoj falje të gjithë lojtarëve të pakënaqur të Pishpirikut, por dua t'i falënderoj ata e t'ju them se ndoshta në kurrizin e nervozës dhe pakënaqësisë tuaj për gabime të kësaj loje mund të ndërtohet një industri e video-lojërave në Kosovë e cila mund të përmirësojë jetën tuaj apo fëmijëve tuaj.

Intervistoi: Liridona Bytyçi

ALBAN GËRGURI NGA KOMPANIA "TROKIT" FLET PËR PËRVOJËN ME STUDENTËT E UBT-SË

"TROKIT PËR PUNË, TROKIT PËR ZGJIDHJE, TROKIT PËR AVANCIM, TROKIT PËR PROFESIONALIZËM"

A e shihni UBT-në si ndihmesë në praktikimin e njohurive?

- Po, jemi shumë mirënjohës dhe kemi kënaqësinë që një kolegji i tillë është prezent në Kosovë.

Me çka merreni aktualisht?

- Kompania merret me Branding, Design dhe Technology.

Çka ju kanë ndihmuar studentët e UBT-së për të arriturat tuaja?

- Bashkë me ekipin dhe eksperiencën që kemi ne si kompani, e kemi prezantuar kompaninë në nivel global më të lartë.

E kujt ishte ideja për emrin "TROKIT"?

- Ideja ka qenë qysh në vitet 2005-2006, nga unë dhe Kushtrim Sogojeva.

Çfarë mesazhi përçon ky emër?

- Trokit për punë, Trokit për zgjidhje, Trokit për avancim, Trokit për profesionalizëm.

- Si u bënë studentët e UBT-së pjesë të "Trokitit"?

Duke u interesuar më shumë rreth punëve që i bëjmë ne.

Cilët janë ata?

- Donat Xhemajli, Art Ramadani, Arlind Nushi, Shpat Ajvazi, Ditbardh Uka.

Cilat janë pozitat e tyre?

- Disa kanë filluar nga praktikantë e më pas janë profesionalizuar në këto fusha: Video Designer / Fotograf, Web Designer, Webdeveloper, Graphic Designer.

A keni pasur problem ndonjëherë me ta?

- Asnjëherë.

A do të bashkëpunoni edhe më tej me studentët e këtij kolegji?

- Po do ta vazhdojmë bashkëpunimin edhe me tej. Kishim pasur dëshirë që në të ardhmen të krijojmë një bashkëpunim edhe më të ngushtë sepse ky është një përfitim reciprok kolegji-student-kompani.

DONAT XHEMAJLI, STUDENTI I UBT-SË PUNËTOR NË "TROKIT"

Qe sa vite punoni në "Trokit"?

- Tash janë bërë 4 vite që punoj në Trokit.

Çfarë pozite mban?

- Jam në pozitën e Video Design & Fotograf. Gjithashtu edhe e menaxhoj departamentin e Video Produksionit.

A jeni të kënaqur me këtë punë?

- Sa më pëlqen kjo punë tregon vet fakti që kam filluar të punoj qysh nga mosha 15-vjeçare.

Nëse do kishit pasur mundësi të zgjedhni një drejtim tjetër, cili do ishte ai?

- Pasi që kam një pasion të veçantë për punën që bëj dhe zgjohem çdo mëngjes me vullnet dhe nuk kam menduar për ndonjë opsion tjetër. Ajo çfarë dëshiroj është që ta përsosi punën që bëj tani.

A e mbani mend ditën tuaj të parë të punës, përshkruani eksperiencën tuaj?

- Ditën e parë kur kam filluar në TROKIT, kam qenë pak i emocionuar, por të gjithë ishin aq miqësor dhe mikpritës sa që fillova të ndihem mirë dhe pashë se jam bërë pjesë e një ekipi shumë të mirë. Në ditën e parë kuptohet se ka pasur edhe gabime mirëpo ndihma dhe bashkëpunimi me punëtorët e tjerë më ka ndihmuar që t'i marr hapat e mi të parë në këtë punë.

A ju ka ndihmuar UBT-ja në zhvillimin e njohurive?

- Edhe pse jam në fillim të studimeve, kam parë përparime në lidhje me menaxhimin dhe njohuri të reja në lidhje me punën që bëj.

STUDENTËT E UBT-SË PËRCOLLËN PUNIMET E KUVENDIT KOMUNAL TË FERIZAJT

Një grup studentësh të Departamentit të Shkencave Politike në UBT morën pjesë në seancën e rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajit. Ata përcollën nga afër zhvillimin seancës, gjithnjë në funksion të avancimit të njohurive në fushën e funksionimit të institucioneve komunale.

FLET VLORA ALIU, ASISTENTE NË UBT

UBT, MJEDIS SHKENCE DHE KOLEGIALITETI



"Konsideroj se kolegialiteti, sinjeriteti dhe profesionalizmi brenda stafit të UBT-së janë dukuri shumë pozitive, të cilat i gjen dhe praktikohen në çdo kohë", thotë për "UBT News", Vlorë Aliu

UBT News: A mund të na tregoni pak më shumë për pozitën tuaj në UBT?

Vlorë Aliu: Faleminderit, ju përgëzoj për punën dhe kontributin tuaj në shpërndarjen e informacioneve lidhur me fushën e Arkitekturës. Pozita ime në UBT është e fokusuar në dy çështje: 1. Asistente në lëndët Studio

Dizajn dhe Planifikim Urban dhe 2. Koordinatore për çështje akademike në fakultetin e Arkitekturës në UBT.

UBT News: Cilat janë prioritetet kryesore të punës suaj?

Vlorë Aliu: E para, si prioritet konsideroj ngritjen e cilësisë në ligjërime dhe mësimin nga ana e

studentëve, ndërkaq e dyta sa i përket pozitës së koordinatorës mendoj se është te hartimi dhe shpërndarja në kohë të caktuar e orarit mësimor për ligjërata dhe ushtrime, poashtu edhe menaxhimi i vazhdueshëm i procesit mësimor.

UBT News: Cilat janë arritjet tuaja deri më sot në UBT?

Vlorë Aliu: Më parë kam punuar si arkitekte në byro të ndryshme projektuese, dhe si drejtore ekzekutive në Asociacionin e Arkitekturës të Kosovës etj. Ndërkaq nga viti 2012 e deri më sot si staf i kolegjit UBT kam arritur, në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", t'i mbaroj studimet Master duke fituar gradën Master shkencor i Arkitekturës.

UBT News: Çfarë mendon se ju lidh më shumë me punën që kryeni në UBT?

Vlorë Aliu: Konsideroj se kolegialiteti, sinjeriteti dhe profesionalizmi brenda stafit të UBT-së dhe në veçanti stafit të fakultetit të Arkitekturës janë dukuri shumë pozitive, të cilat

i gjen dhe praktikohen në çdo kohë.

UBT News: Si punoni dhe si i vendosni marrëdhëniet me të tjerët në grup?

Vlorë Aliu: Mendoj se nga dhuntitë e natyrës dhe të edukimit familjar i shfrytëzoj si adutë personale dhe bazohem fort në ndërtimin e klimës pozitive, qoftë me studentë, kolegë apo diçka tjetër që lidhet me kolegjin UBT.

UBT News: Si ndihesh për të punuar me një grup njerëzish që kanë prejardhje, moshë dhe kulturë të ndryshme?

Vlorë Aliu: Të jem e sinqertë me juve, e pranoj faktin se të punosh në një kolektiv ku ka moshë, kulturë apo prejardhje krahinore të ndryshme nuk është e lehtë. Mirëpo, falë nivelit edukativ dhe ngritjes akademike të tyre sikur lehtësohet puna dhe të gjithë së bashku ecim drejt sukseseve të reja. Megjithatë, Kosova nuk është shtet i madh gjeografikisht dhe me popullsi të madhe, do të thotë se elementet e lartcekura fare pak janë të dukshme në kolegjin UBT.

UBT News: Si mendon se mund ta fitosh besimin dhe respektin?

Vlorë Aliu: Besimi dhe respekti fitohen në bazë të performancës individuale, e cila duhet të përmbajë veçoritë si: edukata, profesionalizmi dhe tolerancë në raport me të tjerët. Jam e bindur se mes këtyre elementeve tashmë e kam krijuar dhe fituar besimin dhe respektin e kolegëve dhe studentëve këtu në UBT.

UBT News: A mendon se do t'i motivosh të tjerët dhe si e bën këtë?

Vlorë Aliu: Po, mendoj se ia dal që të rinjtë dhe të rejtat i motivoj duke qenë shumë pranë tyre dhe me ta, qoftë në ligjërata, konsultime etj. Ndërsa, të tjerët më të moshuar se unë besoj se nga sjelljet e mira motivohen për një familje më kreative dhe bashkëkohore.

Flaka Jashari
Media dhe Komunikim, Viti I

INTERVISTË ME FERHAT BEJTULLAHUN – LIGJËRUES NË UBT, NË FAKULTETIN E ARKITEKTURËS

UBT MË KA SJELLË NJË MUNDËSI DHE NJË SFIDË TË RE

E shoh UBT-në si një mundësi për ngritjen profesionale e akademike të mëtutjeshme drejt PHD dhe titujve akademikë

UBT News: Cila është pozita juaj në UBT?

Ferhat Bejtullahu: Asistent Profesor

UBT News: Cilat janë hulumtimet tuaja që i kenë publikuar (ku dhe kur)?

Ferhat Bejtullahu: Lista e publikimeve:

1. "Zbatimi i standardeve në projektim dhe ndërtim - Parandalimi i kaosit,"

Ferhat Bejtullahu dhe Besa Jagxhiu (Konferenca Shkencore

Ndërkombëtare në Arkitekturë dhe Planifikimit Hapësinor: "Eksperiencia ndërkombëtare dhe sfidat në Kosovë", Universiteti i Biznesit dhe Teknologjisë, Prishtinë, Kosovë 26 qershor 2008).

2. "Roli i kodeve në vlerësimin e qëndrueshmërisë së konstruksioneve" - Violeta Nushi dhe Ferhat Bejtullahu; (Konferenca Ndërkombëtare: "Qëndrueshmëria e Konstruksioneve drejt një ambientit të ndërtuar më mirë", Universiteti

i Innsbruck, Austri 03-05 shkurt 2011)

3. "Ndërtimi i Qëndrueshëm - efikasiteti ekologjik i ndërtesave e bashkëkohore

shumëkatëshe nga betonarmeja ndaj ndërtesave nga druri"; Violeta Nushi, Enis Jakupi & Ferhat Bejtullahu (Simpoziumi i 14 i Asociacionit Maqedon të inxhinierëve të ndërtimtarisë "MASE" - në Strugë, Maqedoni më 28 shtator - 1 tetor 2011)

4. "Rëndësia e Sistemit Vlerësues të Ndërtimeve të "Gjelbër"-a për Menaxhimin e qëndrueshëm të Ndërtesave në Kosovë"; Violeta Nushi dhe Ferhat Bejtullahu (Konferencë e 1-re Ndërkombëtare: "Arkitektura dhe Dizajni Urban", Universiteti Epoka, Tiranë, Shqipëri më 19-21 prill 2012)

5. "Krijimi i hapësirave publike të përshtatshme për shfrytëzues në qytete (Prishtinë)"; Ferhat Bejtullahu (Konferencë e 1-re Ndërkombëtare: "Arkitektura dhe Dizajni Urban", Universiteti Epoka, Tiranë, Shqipëri më 19-21 prill 2012)

6. "Ndikimi i ndërtesave kolektive banesore në qëndrueshmërinë e mjedisit të qyteteve në rajon (Prishtinë)"; Ferhat Bejtullahu (Konferenca Ndërkombëtare: Zhvillimi urban i qëndrueshëm, arkitekturë dhe mjedis Universiteti i Biznesit dhe



Teknologjisë, Prishtinë, Kosovë më 02-03 nëntor 2012.

This paper has defined Cloud e-Learning characteristics and justified why CeL goes hand in hand with advances in MAS. This new framework for learning can be used as a gateway to open available courses from different institutions. The proposed layers allow students to learn anything, with or without credits, with or without a degree and be able gain top quality on-line education through choosing the best teachers. Teachers will collectively develop top quality content, and institutions will compete for offering top quality programmes. The big picture of CeL is hard to deploy fully. Every individual aspect of CeL is by itself a research area that can be further developed. The vision for CeL, as described in this paper, provides a number of pedagogical and technological challenges which need to be addressed in the coming decades. The latter are concerned with the deployment of different kinds of agents that are assigned various roles to carry out specific tasks to assist the learners in this complex environment. Future work will include a more in-depth discussion of the role of agents and of the technological challenges of integrating MAS and the cloud.

Shënim: Punimi është publikuar si pjesë e librit Advances in Intelligent Systems and Computing, pas konferencës së mbajtur në Kreta të Greqisë. Fokusi i konferencës ka qenë në Agent Systems dhe kontributi i tyre në fusha të ndryshme. Në temë është dhënë ideja e përfshirjes së Multi Agent Systems në e-learning platformat për të ngritur bashkëpunimin midis shfrytëzuesve të ndryshëm brenda kësaj kornize. Referencat janë hequr për shkak të natyrës së gazetës.

LEXIM

MBI LIBRIN "A GAME OF THRONES" NGA GEORGE R.R. MARTIN

Arbër Syla

Kjo ese bazohet në librin e parë të serisë ende të papërfunduar fantastike të librave "A Song of Ice and Fire" (Kënga mbi Akullin dhe Zjarrin) nga autori Best Seller, George R.R. Martin. Ngjarja e kësaj veprë zhvillohet në një botë imagjinare të cilën e ka krijuar autori i veprës duke u bazuar në botën e njohur gjatë mesjetës së errët feudale. Pra, ekzistojnë 3 kontinente me kultura dhe sisteme pushtetare të ndryshme.

Ngjarja kryesore zhvillohet në kontinentin Westerosku sistemi pushtetar është Monarki Absolute. Qeverisja e 7 Mbretërive të Westerosit kryhet nga një Këshill i përbërë nga Këshilltarë të lëmive të caktuara, si Drejtësi, Informata, Financa etj. Ky këshill kryesohet nga Dora e Mbretit (Ekuivalenti i Kryeministrit). Ndërsa shtatë krahinat që ia dhanë emrin mbretërisë udhëhiqen nga familjet fisnike më të larta, me Lordin në krye. Por ky sistem nuk ka ekzistuar gjithmonë si i tillë.

Në fillim, të gjitha mbretërit ishin të pavarura dhe sovraane, dhe secila kishte mbretin e saj. Kjo ndryshoi rreth 300 vite para fillimit të ngjarjes kryesore, kur Aegon Targaryen me një Ushtri prej 8000 vetash zbarkoi në bregdetin e pjesës Lindore të kontinentit, vend që më vonë do të quhej Kings Landing (Vendzarkimi i Mbretit). Por nuk ishte Ushtria e tij ajo që e bëri mbret Aegonin. Ishin tre Dragonjtë e tij, bisha të stërmëdha të cilat dot'u jepnin armiqve të Aegonit zjarr dhe vdekje.

Lufta për unifikimin e 7 Mbretërive zgjati 2 vite. Shumica e mbretëve kur shihnin Dragonjtë e Aegonit dorëzoheshin, duke dashur të shmangin shkatërrimin e popujve të tyre. Por disa prej tyre donin luftë, dhe Aegoni ua dha. Kulminacioni i kësaj lufte ishte Beteja e quajtur "The Field of Fire" (Fusha e Zjarrit). Për këtë betejë Mbreti i Mbretërisë së Jugut (The Reach, nga gjuha angleze: Vend Pjellor) dhe Mbreti i Mbretërisë së Tokave të Perëndimit (Westerlands: përktim bukfa) mblodhën një ushtri kolosale prej 65 mijë vetash, dhe marshuan drejt bazës Ushtarake të Aegonit.

Kur Aegoni pa fuqinë ushtarake të kundërshtarëve të tij, për të ishte e qartë se çfarë duhet të bënte. Për herë të parë, dhe të vetme, Aegoni sulmoi me fuqinë e tij të plotë, me 3 Dragonjtë e tij, përnjëherësh. Kur Dragonjtë sulmuan ushtrinë e dy mbretëve fatkeq, fusha mbi të cilën ata qëndronin u ndez në zjarr dhe u kthye në ferr për ta. Atë ditë u dogjën të gjallë mbi 12000 ushtarë nga ushtria e kombinuar e Jugut dhe Perëndimit, dhe bashkë me ta mbreti i Mbretërisë së Jugut, së bashku me 3 djemtë e tij, të cilët shkuan në atë fushë duke kërkuar lavdi por gjetën një vdekje të tmerrshme. Kjo e la mbretërinë e Jugut pa trashëgimtar të pushtetit.

Kur mbreti i Mbretërisë Perëndimore e pa situatën e pashpresë u urdhëroi ushtarëve të tij të dorëzoheshin dhe të hidhnin sh-

patat e tyre para Mbretit të tyre të ri. Aegoni si shenjë mëshire vepronte me mbretin e Perëndimit ashtu siç vepronte me Mbretërit e tjerë që dorëzoheshin. Nuk e ekzekutoi por ia falë jetën dhe ia dha detyrën e administrimit të krahinës që deri më tani kishte qenë Mbretëria e tij. Dhe kështu Aegon Targaryen u bë Mbreti Aegon, i pari i emrit Targaryen, Lordi i 7 Mbretërive dhe Protektori i Perandorisë.

Dinastia e Familjes Targaryen mbajti pushtetin për afro 300 vite, duke sjellë paqe dhe prosperitet mbi 7 Mbretëritë e Westerosit. Por kjo do të ndryshonte. Në vitin 279 Pas Pushtimit, i biri dhe trashëgimtari i mbretit aktual Aerys (i quajtur mbreti i çmendur, për shkak të piromanisë së tij), Rheagar, e kidnapoi Lyana Starkun, motrën e Eddard Starkut (i biri i Lordit të Krahinës Veriore) e cila ishte e fejuara dhe dashuria e madhe e Robert Baratheonit (Lordi i Krahinës së tokave të Stuhishme. Ang: Storm Lands). Këta të fundit dërguan një delegacion drejt mbretit Aerys, i cili udhëhoq nga babai dhe vëllai i madh i Eddard Starkut, me kërkesën për kthimin e menjëherëshëm të Lyanas.

Mbreti Aerys, duke i akuzuar për Tradhti të lartë, urdhëroi ekzekutimin e menjëherëshëm të babait dhe të birin. Babain e djeg të gjallë, ndërsa të birin e var. Pastaj thërret për në kryeqytet Xhon Arrynin (Lordin e Krahinës së Maleve të Hënës), i cili kishte nën protektoratin e tij Eddard Starkun dhe Robert Baratheonin, duke ia kërkuar kokat e të dyve. Ky ishte akti final, i cili e mbushi kupën, dhe i ngriti në rebelim katër prej shtatë krahinave. Krahina e Veriut, Krahina e Maleve të Hënës, Krahina e Lumenjve dhe Krahina e tokave të Stuhishme mblodhën një ushtri prej gjithsej 45 mijë vetash. Rebelimi do të zgjaste afër një vit, dhe në fund erdhi konfrontimi vendimtar.

Në Tredhëmbësh vend ku takohen tre lumenjtë më të mëdhenj të perandorisë dhe bashkohen në një, takohen ushtria Mbretërore dhe ajo e Rebelëve. Beteja rezultoi me humbje të mëdha në të dy taborët. Lordi Robert Baratheon vret në dyluftim Princin Rheagar, dhe ushtria Rebele shkatërron ushtrinë Mbretërore duke betonuar fitoren e Rebelëve. Duke qenë se vet ishte i plagosur nga dyluftimi me Rheagarin, Lordi Roberti urdhëroi Eddard Starkun të marrë ushtrinë dhe të marshojë drejt kryeqytetit për të konfrontuar Mbretin Aerys me krimet që i ka bërë. Ky i fundit pas lajmit të marrë, menjëherë transportoi gruan e tij shtatzënë dhe djalin e tij të vogël për në kontinentin Essos (Kontinenti i dytë Imagjinar) për t'i shpëtuar nga sulmi të cilin do ta pësonte kryeqyteti.

Mirëpo kur Ned (Shkurt për Eddard) Starku arriti në kryeqytet, atë po e priste një befasi. Lajmi i fitores së Rebelëve kishte mbërritur Lordin Tywin Lannisterin, të Krahinës Perëndimore. Ai kishte qëndruar neutral gjatë gjithë kohës, por pastaj vendosi të vepronte. Lord Tywin kishte ardhur para portave të kryeqytetit me 15 mijë ushtarë pas tij, duke i premtuar mbretit se do ta

mbronte qytetin kundër rebelëve. Mbreti, duke qenë se i besonte jashtë mase Lord Tywinin, i hapi portat e qytetit. Sapo ndodhi kjo, filloi një maktë i vërtetë.


Lord Tywin Lannisteri urdhëroi plaçkitjen e qytetit dhe vrasjen e atyre që vazhdonin të kishin lojalitet ndaj Mbretit. Kur mbreti merr vesh se çka po ndodh, urdhëroi Xhejmi Lannisterin (i cili është pjesëtar i Gardës Mbretërore) të dëshmojë besnikërinë e tij, duke ia sjellë kokën e babait të vet (Tywin Lannisterit). Xhejmi në atë moment e vret mbretin dhe pjesëtarët e oborrit mbretëror që janë prezentë, akt ky që ia vë epitetin Mbret-Vrasës. Ned Starku hyn në sallën e fronit mbretëror, për ta gjetur mbretin e vranë. Por fundi i luftës nuk ishte aspak i kënaqshëm për fituesit e saj.

Kur Ned Starku kalëron së bashku me 7 shokë të tij drejt vendit ku Princi mbante të "ngujuar" motrën e Nedit, ata gjejnë 3 luftëtarë të Gardës së Mbretit duke e ruajtur kullën. Ky fakt është shumë kontravers, duke qenë se Garda është e përbetuar të mbrojë familjen mbretërore. Beteja që rezultoi, e gjen të mbijetuar vetëm Ned Starkun me njërin prej shokëve të tij. Ai futet në kullë dhe gjen motrën e tij në një shtrat të mbuluar me gjak. Ajo duke luftuar me vdekjen i kërkon vëllait të saj një premtim, përmbajtja e të cilit ende nuk dihet. Kur Nedi ia jep premtimin, ajo "vdes me zemër të qetë".

Robert Baratheoni shpallet mbret duke e përfunduar dinastinë Targaryen dhe duke i ribashkuar mbretëritë nën pushtetin e një personi të vetëm. Për të siguruar paqen e mbretërive, Mbreti Robert martohet me vajzën e Lord Tywinin, Cersei, duke e konfirmuar Lord Tywinin si aleat të fuqishëm. Dorë të Mbretit e shpall John Arryn, Lordin e Krahinës së Maleve të Hënës, duke qenë se ishte i moshuar dhe kishte përvojë të madhe në udhëheqje. Kështu filloi periudha e re e paqes.

19 vite kalojnë nga fundi i rebelimit, dhe një paqe e qëndrueshme mbizotëron mbi 7 mbretëritë. Robert Baratheoni pas triumfit të tij nuk kishte interes në qeverisjen e perandorisë. Këtë detyrë ia kishte lënë Dorës së Mbretit, Xhon Arrynit. Ky ishte shumë i suksesshëm në atë aspekt. Ned Starku kishte refuzuar postet të cilat Mbreti Robert ia kishte ofruar atij, duke këmbëngulur se Winterfell (Kryeqyteti i Krahinës Veriore) ishte vendi i tij. 19 vite pas fundit të luftës Mbreti Robert ishte më pak se hiya e burrit që kishte pushtuar 7 mbretëritë dhe që kishte vranë Princin Rheagar. Ai ishte i dhënë pas pijes dhe kurverisë. Ushqimin gjithashtu kurrë nuk e kishte larg vetes. Ai kishte ndryshuar shumë, dhe nuk ishte më burri që kishte qenë njëherë.

Një ditë të qetë në Winterfell Lord Eddardine lajmërojnë se kishte ardhur një letër përmes një korbi (Mjeti më i zakonshëm i komunikimit në këtë ngjarje). Letra vuntin nga kryeqyteti dhe kishte dy mesazhe. Ishin lajmet se Xhon Arryni, Dora e Mbretit, kishte vdekur. Atë e kishte kapur një sëmundje e shpejtë, e cila e kishte tretur në më pak se dy net. Lajmi i dytë ishte se Mbreti, së bashku me



300 veta nga tabori, ishin nisur për në Winterfell. Ky lajm e gëzoi dhe e shqetësoi njëkohësisht Eddardin. Por tani, obligimi i tij ishte të sigurohej se Mbreti do t'i bëhej pritja të cilën e meriton.

Kur mbreti mbërrin në Winterfell, pritja me bujë të madhe. Së bashku me Mbretin dhe taborin e tij, kishin ardhur dhe dy vëllezërit e mbretëreshës, Jaime dhe Tyrion Lannister. Jaime ishte një luftëtar i përkryer në çdo aspekt. I gjatë, i pashëm, i fuqishëm në trup, i shpejtë e dinak. Kurse Tyrioni ishte krejtësisht e kundërta. Ai ishte një xhuxh. Por, çka i mungonte në gjatësi dhe bukuri, ai e kompensonte denjësisht me mençurinë dhe diturinë e tij. Pas pritjes ceremoniale, Mbreti këmbëngul të qohet menjëherë që Nedi ta shoqërojë tek varri i Lyanas. Aty në privatësi ia bën ofertën për ta bërë Dorë të Mbretit. Nedi, i cili kishte pritur këtë ofertë, i kërkon kohë për të vendosur.

Të nesërmen, Mbreti vendos të dalë në gjueti në pyllin që ishte afër qytetit të Winterfellit. Të gjithë bashkëngjiten, në mënyrë që të bëhet më madhështore. Por Jaime Lannisteri nuk "ndjehet mirë", dhe qëndron në qytet. Në ndërkohë fëmijët po luanin në oborrin e Kështjellës. Djali i dytë i Nedit, Bran, ishte shumë i dhënë pas ngjites nëpër kullat dhe çatitë e Winterfellit. Ai kishte një vend të preferuar ku ngjitej gjithmonë, nga ku mund ta shikonte gjithë qytetin. Por kur ngjitet këtë herë, ai pa diçka që nuk duhej ta shihte. Ishin mbretëresha dhe vëllai i saj Xhejmi, të cilët kishin një marrëdhënie incesti. Brani i zuri në vepër, por Jaime reagoi shpejt dhe e kapë atë për krahu. Jaime shi-

kon motrën e tij dhe thotë: "Gjërat që njerëzit i bëjnë për dashurinë" dhe e hedh Branin nga dritarja.

Në ndërkohë, në Pentos, një qytet në Kontinentin perëndimor Essos, ndodheshin dy fëmijët e mbretit Aerys, tashmë 19 vite i vdekur. Viseris dhe Deneris (origj. Daenerys) të cilët ishin mysafirët e Magjistrit të qytetit (Titulli i Udhëheqësit në atë vend). Ky i fundit është shprehur i gatshëm t'u ndihmojë trashëgimtarëve të Dinastisë së Dragonjve. Ata vazhdonin ta quanin veten dragon, edhe pse bishat e tyre të tmerrshme që u kishin ndihmuar dikur ta pushtonin një kontinent të tërë kishin vdekur më shumë se 100 vite më parë. Gjëja e parë e cila do t'u nevojitej ishte një ushtri, dhe atë dinte se ku do ta gjente. Magjistri kishte shumë shokë, dhe njëri prej tyre, Khal Drogo, ishte mbreti i një fisi nomadësh, të cilit ishin të njohur për aftësinë e tyre në fushën e betejës. Dhe mbreti i tyre ishte ende beqar, por kjo do të ndërronte shpejt. Magjistri, emri i të cilit ishte Illirio, kishte negociuar një pakt i cili thonte se Deneris do të martohej me Khal Drogon, dhe ky i fundit do t'i ndihmonte Viserisit të rimerre fronin e Babait të tij.

Në Winterfell, Nedi bashkë me mbretin dhe bashkudhëtuesit e tij ishin përgatitur për t'u nisur drejt kryeqytetit. Edhe pse situata ishte shumë e rënduar, dhe nuk dihej se çfarë kishte ndodhur me Branin. Ai kishte rënë në komë, dhe kishte 5 ditë që nuk po tregonte asnjë shenjë, përmirësimi apo përkeqësimi. Përplasja pas rënies nga kulla i kishte thyer kurrizin, dhe shëruesi i Winterfellit kishte konfirmuar se

>> Vizion nga faqja 27

ku edhe vdekja do të ndjehej në siklet. Aty ai qëndroi për disa ditë me rresht. Nuk e dinte kur ishte i zgjuar e kur në gjumë. Këmba e tij e thyer ishte ënjtur dhe ndjente dhimbje të papërballueshme. Një ditë (ndoshta ishte edhe natë) Lordi Varys erdhi te Nedi për ta vizituar. I kishte sjellë verë dhe lajme rreth asaj që po ndodhte në botën e të gjallëve. Mbretëresha kishte ofruar që ta lironte Nedin, duke ia mundësuar të shkonte në eksod për të mos u kthyer kurrë, nëse e pranon djalin e saj si Mbret legjitim dhe e pranon tradhtinë e tij ndaj Mbretit. Kur Nedi fillimisht refuzon, Lordi Varys i thotë që nëse nuk donte ta bënte për vete, le ta bëjë për hir të jetës së vajzave të tij, të cilat do ta ndiqnin në varr nëse ai shpallet fajtor ndaj tradhtisë. Ai nuk mundej t'i thoshte fjalët, por pohoi me kokë.

Princesha e përgatit një zjarr funerali për burrin e saj. Ajo e lidh shtrigën në turrën e druve, vendos Veçët e dragonjve mbi trupin e Khal Drogos dhe futet vetë në të. Kur zjarri shuhet, ajo del nga hiri i zjarrit, lëkura e saj e paprekur, rrobat dhe flokët të asgjësuar nga flakët, dhe rreth saj ishin tre dragonjtë që kishin dalë nga vezët e ngurta.

Pasi Khal Drogo kishte vdekur më në fund, shumica e kalorësve kishin ikur. Ata nuk e kishin ndjekur atë pse babai i tij kishte qenë mbret, por sepse ai kishte qenë luftëtar i patrembur dhe udhëheqës i madh. Tani ai kishte vdekur, dhe ata nuk kishin më një udhëheqës. Princeshës i kishte mbetur detyra t'ia bënte nderimet e fundit burrit të saj. Ajo, së bashku me ata pak veta që kishin mbetur besnik ndaj saj, kishte ndërtuar turrën e druve, ku do të digjej kufoma e Mbretit të saj. Ajo i vendosi tri vezët e dragonjve që Magjistri Illirio ia kishte dhuruar për martesë mbi trupin e Drogos, lidhi shtrigën anash turrës, dhe morri një flakadan të ndezur. Ajo u ngjit sipër turrës dhe e ndezi zjarrin. Gjithçka u kap në zjarr. Shtriga ishte betuar se nuk do të bërtiste nga dhimbja, por nuk e mbajti betimin. Gjithçka u tret në zjarr, përpos Princeshës, gjakut të Dragoit. Ajo ishte e paprekur nga zjarri, dhe vezët nuk ishin më vezë, por ishin tre dragonj, dhe ajo ishte nëna e tyre. Nata ishte e gjallë, dhe Dragonjtë po fluturonin nëpër qiell, dhe ata kishin ardhur me një qëllim. Zjarr & gjak.

Pasi Ned Starku kishte pranuar ofertën e Mbretëreshës, ishte organizuar një mbledhje e qytetarëve para tempullit të madh. Aty ishin Mbreti Xhofrei, nëna e tij, Lordët e këshillit mbretëror, dhe e gjithë popullata e Kryeqytetit. Më në fund rojat e kishin sjellë Nedin para turmës së njerëzve. Ai së pari pranoi tradhtinë e tij, pastaj kërkoi mëshirë për të duke pranuar Mbretin Xhofrei si monarkun legjitim dhe Lordin e 7 Mbretërive. Mbreti Xhofrei pastaj i drejtohet turmës. Ai thotë se nëna e tij dëshiron ta mëshirojë Lord Starkun, por ajo ka zemër të butë femre, dhe për aq kohë sa ai do të jetë mbret, tradhtia nuk do të qëndronte e pandëshkuar kurrë, dhe urdhëron menjëherë t'i pritët koka Nedit. Xhelati mbretëror e kryen urdhrin menjëherë, dhe me këtë akt çdo shpresë e paqes vdes bashkë me Nedin. Dhe mijëra të tjerë do ta ndjekin atë shumë shpejt, sepse lufta tashmë ka filluar.

REKTORI HAJRIZI NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË EUROSIM, NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE MATHMOD DHE NË KOMITETIT EDITORIAL TË REVISTËS "SNE"

Asambleja e përgjithshme e Federatës Evropiane të Asociacioneve kombëtare për Modelim dhe Simulim (EUROSIM) mbajti takimin e radhës, në të cilin mori pjesë edhe rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi.

Në takim u diskutua në detaje puna e bërë gjatë vitit të kaluar, specifikat dhe çështjet e shtruara gjatë punës në praktikë, si dhe u shtruan detyrat për të ardhmen.

Sipas raportit të punës, Republika e Kosovës u vlerësua mjaft lart për punën e kryer gjatë vitit të kaluar kalendarik.

Gjithashtu, rektori Hajrizi mori pjesë edhe në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore Vjetore MATHMOD, që u mbajt në Vjenë.

Po kështu, ai mori pjesë në takimin e radhës të Komitetit Editorial të revistës "SNE: Simulation News Europe". Z.Hajrizi është pjesë e këtij këshilli tash disa vite me radhë.

UBT DHE FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE NDËRTIMTARISË NË VJENË ORGANIZOJNË PUNËTORI NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E PLANIFIKIMIT REGJIONAL URBAN

Gjatë qëndrimit në Vjenë të Austrisë, Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi u takua me zëvendësdekanin për çështje studimore në Fakultetin e Arkitekturës dhe Ndërtimtarisë në Universitetin e Vjenës për Teknologji, Prof. ThomasDilinger.

Gjatë takimit, z.Hajrizi dhe z.Dilinger u dakorduan për bashkorganizimin e një punëtorie ndërkombëtare me efekt regjional në fushën e planifikimit regjional urban, në kuadër të së cilës studentët e UBT-së dhe të disa shkollave të tjera do të punojnë një strategji zhvillimi regjional.

Në takim u diskutuan edhe projektet e tjera të bashkëpunimit, si dhe u theksua gatishmëria për të përkrahur stafin e UBT-së në fushën e Doktoratës. Një asistent dhe një asistente e UBT-së kanë gjetur përkrahjen në studimet e doktoratës në këtë institucion arsimor.

STUDENTËT DHE LIGJËRUESI I UBT-së MORËN PJESË NË SHKOLLËN DIMËRORE PËR TË DREJTËN EVROPIANE

Shkolla dimërore u mbajt nga data 19 deri 23 janar 2015 dhe është organizuar nga KosovoYoungCellsAlumni, Universiteti i Prishtinës dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Blertha Nuredini dhe Hermonda Kalludra, studente të vitit të dytë në Fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Varshavës në UBT, kanë marrë pjesë në Universitetin Dimëror me temën "Marrëdhëniet e BE-së dhe Evropianizimi i Shoqërisë Kosovare, Ekonomia dhe Politikat".

Shkolla dimërore u mbajt nga data 19 deri 23 janar 2015 dhe është organizuar nga Kosovo Young Cells Alumni, Universiteti i Prishtinës dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Njëri ndër ligjëruesit në këtë shkollë dimërore ishte z.Veli Hoti, ligjërues në lëndën "E drejta Pronësore Intelektuale" në Fakultetin Juridik në UBT dhe ligjërues i Lëndës "Mbrojtja ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale" në Fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Varshavës në UBT. Z. Hoti në këtë shkollë dimërore ligjëroi në temën "Roli i Pronësisë Intelektuale në kontekstin e përafrimit të Politikave Konkurruese me ato të BE-së – përafrimi i legjislacionit kosovar dhe ndërtimi i institucioneve në Kosovë".

Studentët, Blertha Nuredini dhe Hermonda Kalludra u shprehën se kanë marrë një përvojë shumë të mirë nga kjo shkollë dimërore, meqenëse shumica e ligjëruesve kanë qenë ekspertë nga Unioni Evropian. Përveç njohurive profesionale, kjo shkollë ka shërbyer edhe si mundësi shumë e mirë për të vendosur kontaktet me ligjëruesit dhe pjesëmarrësit e tjerë, që, gjithsesi është ndihmesë e madhe në avancimin profesional.

UBT U HAP MUNDËSI TË MËDHA STUDENTËVE



STUDENTJA ALBINA VUTHI SHKON NË INTERNSHIP NË VJENË

Studentja e UBT-së, Albina Vuthi së shpejti do të udhëtojë për në Vjenë të Austrisë, ku për tre muaj do të bëjë internship në një kompani të njohur, në zyrën projektuese COOP Himmelblau, ku do të merret me projektim dhe modelim të projekteve të ndryshme.

"Ky internship, duke marrë parasysh se kompania COOP Himmelblau është një ndër kompanitë më të mira në Evropë dhe në botë për arkitekturë, është një rast që definitivisht të jepet një herë në jetë dhe mendoj që, përveç që do të më përgatis më mirë profesionalisht, po ashtu do të më hapë shumë dyer për të ardhmen", shprehet Albina.


Ajo edhe në shkollën e mesme ka qenë në drejtimin e arkitekturës, të cilin e ka vazhduar edhe në UBT. "Përvojat në UBT janë shumë unike dhe të veçanta. Po ashtu, përbëjnë një kapitull shumë të rëndësishëm në formimin tim si një arkitekte e ardhshme", theksoi Albina.

Sipas saj, tre vitet e kaluara në UBT e kanë pasur rëndësinë e tyre në zhvillimin e aftësive dhe të menduarit si një arkitekte. Ndërsa, ajo thotë se një ndër përvojat interesante gjatë studimeve "eurotripi" i organizuar nga UBT.

Duke shpalosur planet e shumta për të ardhmen, ajo thotë se aktualisht është shumë e fokusuar në udhëtimin dhe në internshipin që e pret dhe planifikon të regjistrojë jashtë vendit studimet master.

Albina Vuthi ka edhe një porosi për studentët e rinj. Ajo thotë se ata duhet të jenë të vetëdijshëm që çdo rrugë që e marrin nuk është e lehtë, por ata duhet të vazhdojnë të besojnë në ëndrrat e tyre dhe në veten e vet dhe asnjëherë të mos heqin dorë, sepse munda do t'ju shpërblehet.

SYRI



VËSHTRIM

“A ËNDËRROJNË ANDROIDËT PËR DELE ELEKTRIKE?”

Në këtë ese unë do të analizoj librin “A ëndërrojnë androidët për dele elektrike?” (në anglisht “Do androids dream of electric sheep?”) të autorit Philip K. Dick, si dhe adaptimin e tij filmik “Blade Runner” të Ridley Scott, 1982, në pikëpamjet e tyre mbi atë se çfarë e bën dikë të jetë njeri dhe nëse një gjë e tillë (të qenurit njeri) është e veçantë për ata që i përkasin species Homo sapiens

Altin Ukshini

Tema ime kryesore – kush është njeri dhe kush vetëm duket (paraqitet) si njeri?, koment (1976) i Philip K. Dick në “Second Variety”. Siç mund të shihet nga fjalët e tij, çështja dhe gjendja njerëzore ishte një shqetësim i madh për Dick-un jo vetëm në “Androidët” por përgjatë të gjithë jetës dhe punës së tij.

Siç përmendet në veçanti në këtë libër, empatia paraqitet të jetë aftësi e veçantë e njeriut, përmes androidëve shumë të zgjuar, të aftë për të menduar racionalisht përtej nivelit të shumicës së njerëzve dhe atyre të ashtuquajtur “kokë pulë” - njerëz që kanë kapacitetin e tyre mendorë të zvogëluar për shkak të ndikimit ndaj pluhurit radioaktiv.

Në botën post-apokaliptike të androidëve shumica e njerëzve janë vrarë nga pasojat e luftës botërore Terminus dhe mbetjet e shpërthimeve bërthamore, ose ngadalë janë në degjenerim për shkak të saj. Njerëzit e mbetur në tokë janë të bombarduar vazhdimisht me propaganda që i ftojnë ata të largohen nga toka dhe të bëhen pjesë e kolonive jashtë tokës, ku edhe do të merrnin androidë të tyre personalë, botë kjo

në të cilën fillon udhëtimi i policit gjuetar Rick Deckard në kapjen e gjashtë androidëve të arratisur që marrin strehim në Kaliforninë veriore. Qysh në fillim të novelës flitet për kufijtë e njeriut me makinën:

Një valë e hareshme elektrike që doli nga alarmi automatik i organit të humorit pranë shtratisit zgjoi Rick Deckard-in . (...) “Nëse vendosni valën mjaftueshëm lartë, do të jeni të kënaqur që jeni zgjuar; kjo është e gjithë poenta. Në vendosjen C ajo kapërcen pragun që pengon vetëdijen, ashtu siç bën për mua”.

Këtu njerëzit mbështeten në makina të tilla si “organi i humorit” për të menaxhuar në mënyrë aktive dhe artificiale gjendjen e tyre mendore, njëjtë si të ndryshonit temperaturën në një mikrovallë. Vetë empatia moderohet përmes një makine të quajtur “kutia e empatisë”, me të cilën do lidheshe me figurën fetare të Wilbur Mercerit dhe përmes tij më pas me të gjithë ata që lidhen në të dhe ndajnë emocionet me njëri-tjetrin në të njëjtën kohë, qoftë ato të mira apo të këqija. Duket gjithashtu është edhe varësia e tyre në televizionin, jo shu-

me e panatyrshme në shoqërinë moderne, por ende e dukshme, siç mund të shihet nga meraku i Deckard-it për gruan e tij kur ajo thotë se nuk do që ta shohë atë,

(...) Në këtë mënyrë do të doja të hipja mbi çati dhe të shikoja delen time dhe pastaj të nisesha për punë; ndërkohë do të dija nëse ju nuk jeni i ulur këtu pa TV, duke më shikuar me pakënaqësi.”

Megjithatë, delja e tij, siç mund të kuptohet, është formë jete artificiale elektrike, ashtu si puna e androidëve që ai mundohet t'i vrasë. Deckard-i nuk e mban një krijesë të tillë afër vetëm sepse i pëlqen apo ka një lidhje të veçantë me të, e mban për shkak të jetës shoqërore të asaj kohe; të gjithë duhet apo pritët të kenë një kafshë të ndonjë lloji për shkak të Mercerizmit, ku në fakt edhe mësojmë që Deckard-i përçmon delen e tij.

Duke u bërë i ashtuquajtur, në mungesë të një termi më të mirë, një android, nënkupton, siç thashë, t'i lejosh vetes të bëhesh një mjet, apo të goditesh përtokë, i manipuluar, i shndërruar në një mjet pa dijeninë apo pëlqimin tënd - rezultatet janë të njëjta . (...) Androidizimi kërkon bindje. Mbi të gjitha, parashikueshmëri. (Dick, 1995: 191)

Libri përmban udhëtimin e Deckard-it nga kjo gjendje prej androidi në zbulimin e vetes dhe rikthimin e njerëzimit të tij të humbur nga ndeshja e tij me androidët të cilët ai i ka për misioni t'i vrasë, eventualisht të mësojë t'i pranojë të gjitha format e jetës, përfshirë edhe ato artificiale.

Androidët e Deckard-it, siç u përmend më herët, janë të zgjuar. Megjithatë, ata nuk kanë empati (fq 28) ata janë të paafte për të marrë në konsideratë jetën e të tjerëve, madje edhe androidëve të tjerë. Nivelet e tyre intelektuale i bëjnë ata që të heqin dorë shumë shpejt prej jetëve të tyre në raste kur përballen me situata të pashmangshme (fq 151), duke tejkaluar çdo lloj vullneti për të mbijetuar, vullnet të cilin ata e posedojnë deri në një masë të caktuar, përndryshe nuk do të mundoheshin të mbijetojnë në asnjë mënyrë.

Takimi ynë i parë me një nga replikantët ndodh gjatë testimit të tij me të ashtuquajturin testin e empatisë që po i bënte një detektiv (Blade Runner). Kur Leoni, replikanti nga filmi, pyetet nga detektori për nënën, ai përgjigjet duke shtënë dhe duke vrarë detektivin, një reagim dukshëm emocional dhe aspak racional.

Rachel është një personazh tjetër që ndryshon shumë nga androidët e tjerë, ajo bie në dashuri me Deckard-in, në libër ajo flet

me Deckard-in në mënyrë që ta ndalojë atë së ndjekuri androidët e tjerë të mbetur dhe shkon aq larg sa edhe vret njërin prej tyre, Leonin, në mënyrë që të shpëtojë Deckard-in nga rreziku që i kanosej, një veprim shumë iracional duke konsideruar faktin që Deckard-i kishte për detyrë vrasjen e replikantëve si ajo.

Në këtë mënyrë androidët në film paraqiten si emocionalë dhe jo racionalë si në libër. Më vonë në film, pasi që Roy dëgjon për dy replikantët tjerë të vdekur, ai vetëm sa nuk fillon të qajë tek miku i tij Prisi, e më pas shihet duke qarë edhe në momentin kur i vritet gruaja e tij Irmgard-i, pra replikantët në këtë film jo vetëm që janë emocionalë por kanë aftësi edhe të kenë empati për njëri-tjetrin. Megjithatë gjendja e tij shpejt luhetet pas vdekjes së Priss-it – duke treguar një veçori shumë femijërore. Ky aspekt infantil nga replikantët është theksuar me shoqërimin e tyre me J.F Sebastian-in dhe shtëpinë e tij plot me lodra dhe kukulla dhe qëndrimin e Leonit kur ai dhe Roy vizitojnë njeriun që u ka punuar atyre sytë.


Edhe arsyet e tyre për t'u larguar nga kolonitë janë të ndryshme nga ato të paraqitura në novelë. Në novelën e Dick-ut ata arratisen nga marsi në mënyrë që të largohen nga skllavëria e tyre nga pronarët e tyre njerëzorë dhe zgjedhën tokën duke menduar se do të ishte një vend i lehtë për t'u fshehur. Në filmin “Blade Runner” ata duan më shumë jetë dhe kanë ardhur në tokë që t'u kërkojnë krijuesve të tyre, korporatës Tyrell, t'ua zgjasin jetëgjatësinë e tyre shumë të shkurtër katërvjeçare. Jeta e tyre është shumë e çmuar për ta dhe vdekja i frikëson më shumë se çdo gjë, një karakteristikë jashtëzakonisht njerëzore. Prandaj në vend që replikantët të jenë përbindësja jonjerëzorë, në Blade Runner ata janë më të ngjashëm me mbinjerëzorë apo, siç përshkruhen, me termin në anglisht “supra-humans”, njerëz me disa karakteristika emocionale dhe instiktive të çuara

në ekstreme, siç i thotë Tyrell-i replikantit Roy i cili kërkonte më shumë jetë: “Jeta që digjet dy herë më ndritshëm, digjet për gjysmë më shpejt”. Kjo pikëpamje e robotëve, që në njëfarë mënyre duken njerëzorë, bie në konflikt me androidët e ftohtë dhe të pandjeshëm që përshkruhen në novelë, ku prapë një prej tyre fillon të qajë në fund.

Deckard-i gjithashtu ruan disa nga skenat më të habitshme, sipas mendimit tim; i pikturuar me tone religjioze, përshkruhet si figura e Judës, kur ai e puth Tyrell-in para se ta vrasë atë. Por, skena më e rëndë nga të gjitha është ajo e vdekjes së tij. Në këtë skenë ai paraqitet jo vetëm fetar por si shumë i paparashikueshëm dhe njerëzor, edhe pse vetëm për atë moment, duke e kursyer Deckard-in jo vetëm që më në fund ai vlerëson jetën, por ai ka edhe një për ta kujtuar se pas vdekjes së tij. Unë them se kjo ishte dëshirë hamletiane dhe njerëzore. Në filmin “Blade Runner” është Roy dhe jo Deckard-i i cili bën një udhëtim drejt jetës ose më mirë thënë njerëzimit.

Duke krahasuar të dy punimet, mund të vlerësojmë se ndërsa shumë të ndryshme të dy, “A ëndërrojnë androidët për dele elektrike?” dhe “Blade Runner” kanë pikëpamje të ngjashme në atë se çfarë e bën dikë të jetë njeri, në të dy punimet, empatia dhe respekti për jetën e të tjerëve janë pjesë të rëndësishme të faktit që bën dikë të jetë njeri. Në libër është e pamundur për androidët të jenë njerëzorë, ndërsa në film nuk qëndron kjo; megjithatë në të dyja është e mundur të jesh specie Homo sapiens dhe ende të mos jesh plotësisht njerëzor siç mund të shihet nga Phil Resch dhe vetë Deckard-i në “A ëndërrojnë androidët për dele elektrike?”. Ndërsa definitivisht pjesë e asaj që na bën në të jemi njerëz janë emocionet, instinkti dhe empatia. Ne duhet t'i kemi të gjitha nga këto në mënyrë që të jemi të plotësuar si njerëz, përndryshe unë do ta përshkruaj qenien tonë si të qenurit gjysmë kafshë dhe gjysmë makinë.

SYRI



University of Warsaw




Bachelor and Master Degree in International Relations

Apply for Scholarship!

Teaching and Research Areas

- International Politics
- International Political Economy
- Culture and Multiculturalism
- Diplomacy and Foreign Policy
- International Law and Institutions
- Security and Strategic Studies
- European Integration
- International Relations Theory
- Emerging Markets
- International Business



University of Warsaw (UW)
Is known as one of the leading academic and research center in Poland. The high level of scientific research, its connection with the education of students and the diversity and attractiveness of our teaching determines the position of the University in the country and worldwide.

UW Highlights:

- Founded in 1816
- In the top 4% World-Class Universities
- Ranked no.1 in Poland
- Ranked by QS Topuniversities, The times THEWUR,
- Top 500 in Shanghai Group
- One of the most modern library in Central Europe

Institute of International Relations:

- Established in 1976
- Worldwide research cooperation
- Visiting Professors from all over the World
- Active in national and international research
- Bachelor, Master level and PhD degrees in English
- Worldwide student exchange programme

Fees & Financing:
Bachelor: 1300 € / Year
Master: 2000 € / Year
The Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

Come to UBT and get European degree

TOP EDUCATION FOR TOP STUDENTS



Email: warsaw@ubt-uni.net
Email: ismn@uw.edu.pl
Institute of Warsaw
www.ism.uw.edu.pl

Danube University Krems



Master of Business Administration - MBA

Specializations with MBA Program

- Aviation
- Business Performance Management
- Corporate Responsibility & Business Ethics
- E-Mobility Management
- Energy & Carbon Management
- Finance
- International Business
- Marketing & Sales
- Strategic Management & Organizational Change
- Enterprise Project Management

Apply for Scholarship!

Fees & Financing
Tuition fee: Euro 21,900
Please note our **Scholarships** with a subsidized tuition fee: Euro 10,950
The Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

Danube University



Danube University Krems has specialized in postgraduate academic studies and offers exclusive courses in the fields of health and medicine, communication and globalization, business and law, education and media as well as of arts, culture and building. Being a European model project, Danube University Krems combines high quality in education, research and consulting with excellent customer orientation and service. More than 5,000 students from 80 countries are enrolled in over 150 academic courses.

Department for Management and Business
We believe strongly in a long life learning that prepares and enables you to become a responsible business leader in a fast changing world. We place strong emphasis on learning-by-doing approach, and strive for creating an innovative environment that enables you to have a high caliber education and training. As we are well located in Central Europe, you will enjoy a multicultural and international faculty and student body. The Danube Business School provides an environment where East meets West with strong links to the business community and relationships with partners from both Eastern as well as Western European countries.

Top 10 Reasons to Join a Danube MBA

- An integrative and applied approach to learning
- Long expertise in postgraduate education
- Customized high standard programs
- High calibre and international faculty
- Flexibility for both full-time and part-time students
- Campus located in the picturesque Wachau region
- International student body
- International study trips
- Individualized quality service
- More than 2000 alumni


Top University Education for Top Students!

TOP EDUCATION FOR TOP STUDENTS




Email: dukmba@ubt-uni.net
Email: michaela.moser@donau-uni.ac.at
Tel: +43 (0)2732 893 2126
Web: www.donau-uni.ac.at

Vienna University of Technology



CONTINUING EDUCATION CENTER

Msc Engineering Management
Your key to the top engineering league




CONTENTS
Business • Engineering Informatics • Production • Master's Thesis

MODALITIES
3 semesters, part-time, 14 weekend tracks, in English,

FEES & FINANCING
Tuition fee: Euro 22,000
Please note our **KAMM Scholarships** with a subsidized tuition fee: Euro 13,000
The KAMM Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

HIGHLIGHTS


- 17 years experience
- Master of Science Degree of Vienna University of Technology
- Executive program
- International Faculty - Universities and Industry
- International Participants - Worldwide
- Top international faculty from Europe and USA
- Part time - 14 weekend modules (Thursday to Sunday)
- According to the Bologna Convention
- Contents modernized continuously
- Evening lectures of distinguished guest speakers
- Company visits
- Sustainable Learning Environment – with your tablet at the university (included in the price)
- Alumni Club related to IEEE
- Regularly Club meetings for Networking
- From our graduates approximately 2/3 are in (high) management positions, 1/3 founded a company



Top University Education for Top Students!

Our mission is "technology for people". Through our research we "develop scientific excellence", through our teaching we "enhance comprehensive competence".

Vienna University of Technology
Continuing Education Center
Operngasse 11 • A-1040 Vienna
T +43(0)1/58801-41701 • engineering@tuwien.ac.at
Email: engineering@ubt-uni.net
<http://engineering.tuwien.ac.at>



Top University Education for Top Students



- 14 vite Lider i Arsimit të Lartë - I vetmi i certifikuar për ekselencë
- I certifikuar sipas standardit ISO 9001:2008 për cilësi
- Përfitues për herë të katërt nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS
- Përfitues i Programit për bursa AEP, Albach
- Përfaqëson Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore
- Kampion Evropian në Robotikë
- Kampusi i parë për Shkencë dhe Inovacion

Zgjedh më të mirin ...

... që të bëhesh më i miri!

Come to UBT and Go International...

PROGRAMET E AKREDITUARA

- MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI (Baçelor dhe Master)

- Financa, Banka dhe Kontabilitet
- Marketing dhe Shitje
- Manaxhment dhe Ndërmarrësi
- Logjistika dhe Menaxhimi i Prokurimit

- SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI (Baçelor dhe Master)

- Rrjeta dhe Telekomunikacion
- Softuer dhe Sisteme Inxhinierie
- Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
- Dizajn dhe Multimedia
- Mekatronikë dhe Robotikë

- MENAXHMENT I MEKATRONIKËS

(Baçelor dhe Master) (I vetmi i akredituar në vend)

- (Elektroteknika, Elektronika, Teknologjia e Informacionit Prodhimtaria Industriale, Dizajni Industrial Ndërmarrësi dhe Menaxhment)

- SISTEMET E INFORMACIONIT (Baçelor dhe Master)

- Sistemet e Informacionit për Biznes
- Sistemet e Informacionit - GIS (Geo Information Systems)
- Sistemet e Informacionit të Librarive dhe Menaxhimi i Dijes
- Statistika, Përpunimi i të dhënave dhe simulim
- Siguria e Informacionit dhe Privatësia

- ARKITEKTURË

dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR (Baçelor dhe Master)

- (I vetmi privat i akredituar në vend)

- INXHINIERI NDËRTIMTORE (NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURË (Baçelor)

- (I vetmi privat i akredituar në vend)

- SHKENCA POLITIKE (Baçelor)

- Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
- Integrimi Evropiane
- Administratë Publike

- JURIDIK (LLB)

- (Civile, Penale dhe Ndërkombëtare)

- MEDIA DHE KOMUNIKIM (Baçelor)

- POLITIKA PUBLIKE DHE MENAXHIM (Master)

- INXHINIERI E ENERGISË EFIÇENTE (Baçelor)

- (I vetmi i akredituar në vend)

PËR UBT:

“UBT është krijuar si një universitet ndërkombëtar; një universitet modern që i përmbush nevojat e një shoqërie dhe vendi demokratik, që në vazhdimësi është duke zhvilluar kapacitetet ekonomike dhe teknologjike.”

Edmond Hajriçi, Rectori i UBT-së

“Edukimi është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e bizneseve , që sot veprojnë ndërkombëtarisht, jo vetëm në hapësirën e Europës, por globalisht. UBT ju ofron mundësinë për të arritur qëllimet-objektivat ndërkombëtare”

“Profesorët e këtij universiteti janë më të mirët , dhe mund të shtojë që studimet tuaja në UBT janë më të mirat për të ardhmen tuaj si dhe të vendit tuaj, por edhe për një të ardhme më të mirë të Europës.”

Dr. Erhard Busek Special Coordinator for the Stability Pact for SEE

REGJISTRIMI

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

- Diploma, dëftesat e notave, certifikata e lindjes, kopja e letërnjoftimit dhe dy fotografi

Gjuha e studimeve: Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze si dhe mundësia e studimit në gjuhë të tjera

Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjëratat të rregullta dhe me korrespondencë, si dhe ofron mundësinë e studimit në distancë.

Për të punësuarit ofrohen ligjëratat pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës

Që sukcesi juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin studentë:

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe certifikime ndërkombëtare
- Nga një kompjuter gjatë studimeve dhe sistem online
- Liçensa falas për software
- 100% Internship në kompanitë dhe institucionet me prestigjioze vendore dhe ndërkombëtare
- Libraria me numrin më të madh të titujve dhe qasja online në libraritë më të mëdha elektronike
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorët bashkëkohorë.
- Trajnime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, Projekt, etj.
- Certifikime për kontabilist në bashkëpunim me SCAA

Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik Baçelor është **1200 €**, për nivelin Master është **1500 €** me mundësi pagese deri në **12 kështe**.

Për të gjithë **nxënësit e dalluar** UBT ofron përkrahje financiare

UBT ofron zbritje deri në 30% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentët që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik

Lagja Kalabria p.n., Prishtinë, Tel:038 541400 Mob:044 541400 Email:info@ubt-uni.net Koha e regjistrimit çdo ditë prej orës 09:00 deri në 17:30

Apliko online: www.ubt-uni.net/apliko ose në qendrat për Informim dhe Regjistrim në Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Pejë dhe Mitrovicë